

*Pastaj erdhi nata kur, siç ishte paralajmëruar edhe në gazeta, do të shfaqej “kapja e madhe”, “gjëma”. Njerëzit në të gjithë Shqipërinë, të përgatitur më së miri psikologjikisht e me sytë që u digjnin nga kureshtja, u gozhduan përpara ekraneve dhe panë... Ç’panë?!*

[www.ideartlibri.com](http://www.ideartlibri.com)

ISBN 978-99956-29-25-0



9 789995 629250

Çmimi 500 lekë

Ylli Pango / Skandal ! / Ese për moralin shqiptar

botimet  
ideart



# YLLI PANGO Skandali

*Ese për moralin shqiptar*

ylli pango / skandal !  
- ese për moralin shqiptar -



YLLI PANGO

# Skandal !

*- Ese për moralin shqiptar -*

Ylli Pango / Skandal !  
- *Ese për moralin shqiptar* -

copyright © autori

ISBN 978-99956-29-25-0

[www.ideartlibri.com](http://www.ideartlibri.com)

botimet ideart  
botime@ideartlibri.com  
PO BOX 1532, Tiranë (AL)  
Tel./Fax: ++ 355 42 233 205

## Përmbajtja

Ngjarja ..... 7

Një fjalë të fundit kolegëve të mi parlamentarë  
të tashëm e vlefshme edhe për ata të ardhshëm..... 77

### II

Curriculum Vitae e shkurtër e  
Prof. “Kriminel” Dr. Ylli Pangos ..... 93

*Arritjet e Ministrisë së Turizmit  
Kulturës, Rinisë dhe Sporteve* ..... 98

### III

Pas mediave, më folën njerëzit..... 103

Letër e hapur për Ylli Pangon ..... 145



... Kjo ngjarje duhet të ketë ndodhur  
rreth 300 vjet më parë...

### - Ngjarja -

Atë natë, diku rreth orës 22, pak para se të nisesha për në emisionin e *TV Klan*, më merr në telefon ime motër. Pas pak më shfaqet e llahtaritur në derë, për të më thënë se më kishin filmuar dhe të nesërmen do të më nxirrnin në emisionin e famshëm televiziv shqiptar, pa shok në botë, që nën flamurin e ndershmërisë e luftës kundër paudhësive, filmon e nxjerr njerëz në ekran me figurë e me zë, pa pyetur për kurrfarë të drejte të privatësisë a ruajtjes së imazhit të tyre.

Se për çfarë, nuk e dinte, por lajmi i kish ardhur i sigurt dhe nga njerëz të afërt. Pata, natyrisht, shqetësim, por nuk po më kujtohej të kisha bërë ndonjë gjë për t'u filmuar e sulmuar atje. Gjithsesi, jo fort i qetë, u nisa për në emision *Opinion*. Debati do të përqendrohej rreth truallit të Kinostudios, okupuar prej shkollës *Marubi* dhe lirimit të saj, pasi siç qe bërë e ditur, me një vendim qeverie, ky truall do t'i jepej televizionit



*Top Channel* , për t'u shpërngulur kësisoj nga Piramida. Aty ku ndërkohë kishin filluar punimet dhe pritej inaugurimi i Teatrit të ri Kombëtar dhe Muzeut të Artit. Isha paksa nervoz kur hyra në emision, por pastaj, siç më ndodhte gjithmonë, më zunë ethet e debatit dhe pothuaj harrova ç' më ishte thënë më parë. Nga reagimet, mendoj se opinioni, në një pjesë të mirë, u bind se debatuesi kundër, ishte konfuz dhe gabim në tezat që artikulonte. Pas emisionit ai mu shfaq sërish përpara makinës, tek dera, në terr, teksa dilja nga territori i ish Kinostudios, (me sa duket kish dalë pak përpara nga emisioni) . U përkul tek xhami i makinës e më tha të dilja e të shihja rrethimin me tela të shkollës. Më erdhi vërtet keq. Ishte bërë si i handakosur dhe i ngjiste një fantazme. I thashë përsëri, si shumë herë të tjera, se nuk kisha unë në dorë të falja troje publike, i rekomandova me dashamirësi të takonte një herë Kryeministrin dhe u ndamë. Më kujtohej mirë se të njëjtën gjë kisha bërë edhe dy vjet më parë: i kisha thënë se nuk kisha tagër të falja toka, se problemi zgjidhej në Ministri të Ekonomisë, por ai nuk bindej që nuk bindej, më sulmonte vazhdimisht në telefon dhe gjithë fajin e hidhte gjithnjë mbi mua.

Nuk e dija se të nesërmen më priste një hall ku e ku më i madh se ai i tij, që në fund të fundit vazhdonte ta kishte shkollën e tij të paprekur e kërkonte dhe sheshin përrreth

Të nesërmen mobilizova veten dhe gjithë miqtë e të afërmit, për të marrë vesh se cila ishte gjëma që

kisha bërë e që do të transmetohej për mua, por kjo gjë ishte e pamundur. Më thoshin se ishte bllokuar krejtësisht sistemi kompjuterik i televizionit *Top Channel* që e transmetonte atë emision, se së andejmi nuk dilte asnjë lajm, se njerëzit dhe materialet ruheshin me kujdes të madh etj, etj. Ishte fjala për “peshk të madh”. Ekzekutimi tashmë ishte vendosur.

Gjithsesi, nga sa munda të marr vesh unë e të mitë, lajmet për përmbajtjen e sulmit ishin kontradiktore. Flitej për lekë, për femra, për fshatra turistike, por mua nuk më binte kurrë ndërmend të kisha bërë gjë a diçka të ngjashme dhe në një farë mënyre kisha një lloj qetësie, por edhe kurioziteti. Drekuam me disa miq jashtë Tirane dhe aty nga muzgu befas më shkrepri si vetëtimja: “Mos vallë...?” M’u kujtua e njohura ime e hershme, vajza nga fshati që më erdhi para do kohe në shtëpi, një natë të vonë. M’u kujtua edhe fakti se kur makina u parkua në lokalin përballë meje, ajo doli nga krahu i djathtë, e ndonëse e pyeta për këtë, ajo më tha se e ngiste makinën vetë. U kujtova edhe për dyshimin tim, veshjen e sjelljen e saj tejet provokuese, krahasuar me pamjen e saj të thjeshtë të së shkuarës, përdredhjet e saj... “Të ketë qenë kjo?” Me shpejtësinë e saktësinë që ka mendja në raste të tilla fillova të kujtoj çdo detaj të së shkuarës së afërt dhe pothuaj u binda. Kjo duhej të ishte. Kjo se nuk më kujtohej e nuk kishte asgjë tjetër.

Pastajerdhi nata kur, siç ishte paralajmëruar edhe në gazeta, do të shfaqej “kapja e madhe”, “gjëma”.

Njerëzit në të gjithë Shqipërinë, të përgatitur më së miri psikologjikisht edhe nga një njoftim në gazetë, me sytë që u digjnin nga kureshtja, u gozhduan përpara ekraneve dhe panë... Ç'panë?! Gjithsesi panë. Panë një film metrazhshkurtër e me regji të shkëlqyer me pjesën më "horror", realizuar në shtëpinë time. Në privatësinë time. Aty ku nuk lejohet të xhirosh e përgjosh njeri në botë. Panë një montazh të përsosur, film të së shkuarës, muzikë këngëtarësh të mëdhenj përdorur në filma porno, pjesët e bisedave të mia, qethur me mjeshtëri nga konteksti shumë më i gjerë. Panë buzë femrash e montazhe pa të cilat filmimi im do të dukej i thatë e i dyshimtë. Gjithsesi në pjesën e parë ishin pjesë të bisedave të mia me një vajzë provokatore e xhirime me celular të figurës time me kostum e kollaro në ministri. Pa asnjë bazë për akuzë. Pjesa e dytë ishte vetëm një filmim me celular i figurës time duke ngjitur shkallët e shtëpisë dhe pjesa tjetër, dialogu im me provokatoren e dytë, mysafiren e pabesë. Zëri i saj i dubluar, paranteza e shtojca nga autorët e filmit për veprime të miat që nuk dukeshin gjëkund etj. Shkurt, ishte sajuar, hequr çdo gjë që do të më lehtësonte e do të bënte që truku të kuptohej më mirë nga publiku e ishte shtuar çdo gjë që do ta bënte ngjarjen tmerruese, të ndyrë, impresionuese për njerëzit.

Njerëzit më shumë ndjenë, patën impresionin se panë diçka të tmerrshme, lakuriqe, të pisët, indinjuese. Më llahtar se një film porno me aktorë

realë, më keq se një horror i vërtetë. As ish parë e as dëgjuar prej kohësh një hipnozë e tillë kolektive, një sugjestionim masiv i përmasave të atilla. Ishte vërtet një realizim regjisorial djallëzor dhe me një efekt të paparashikuar për nga përmasat e syerrjes kolektive. Ndofta edhe për autorët ishte i tillë. Por kjo u kuptua më vonë, kur ngjarja precipitoi në logjikën e tyre dhe rezultoi një stisje e kurth i organizuar e asgjë tjetër. As vepër e keqe, as viktimë.

...Siç ka dalë por siç do dalë, shpresoj, më qartë edhe më vonë, e gjitha kjo nuk ishte veçse ekstrakt, pjesë e vogël e një skenari të gjatë, provokimesh, filluar e më pas të realizuar, montuar e të ndërtuar me mjeshtëri për të më rrënuar krejt, e nëpërmjet meje, për të goditur edhe më gjerë politikisht, për të shtuar kështu kapitalin politik për zgjedhje, duke impresionuar publikun përmes një imazhi vërtet të stisur mirë, qëndisur me kujdes e imtësi. E gjitha nuk mu bë se kisha bërë keq, as dëm, se kishte "indicie", siç u pretendua e të tjera si këto. E gjitha kjo ndodhi sepse ishte paravendosur të goditesha, të shkatërrohesha, me çdo mjet, me çdo kusht, muaj më parë, edhe me mjete të tjera. Isha një kokë që ishte vendosur: duhej prerë. Arësyet dhe njerëzit që e bënë këtë, ata që i mbështetën, që u dhanë viston për të transmetuar, qoftë në media, qoftë në politikë duhen hetuar. Janë shumë mendoj, politike për nxitësit, konflikt interesi i autorëve e realizuesve, ambicje e mërira të vogla personale për ca të tjerë që mbështetën.

Në këtë aspekt të fundit personal mund të them me bindje se mua nuk më hëngrën haqet që duhet të laja. Mua më hëngrën ambicjet e xhelozitë e panumërta

Skenari si fillim kishte Ministrinë e Kulturës dhe ardhjen me rekomandim e me lutje të autorëve të skenarit, të një vajze provokatore, veshur më së miri në mënyrë transparente për realizimin e skenarit. Ajo kërkoi punë, por mënyra e sjelljes së saj, veshja, që në çastin e parë, më vuri në dyshim. E thirra më telefon në Ministri rekomanduesin e njëherazi, skenaristin Filip, për të më sqaruar dyshimet. E kisha të njohur të vjetër Filipin dhe veç kësaj vajza vinte e rekomanduar prej tij, madje dhe me makinën e tij. Disa herë kish ardhur me makinën e tij. Filipi më tha se nuk ka ndonjë shqetësim, veçse atë vajzë duhet t'ia punësoja patjetër.

Gjithsesi me dyshime, por u binda disi dhe vajzës diskutohej t'i ofrohej një punë sipas rregullave, madje dhe një tjetër private, pa iu kërkuar asgjë, pa asnjë kusht. Por çuditërisht, ndonëse ndërhyrësi ngulte këmbë për ta punësuar, kur vinte puna për të filluar procedurat e punësimit, vajza zhdukej. Pastaj sërish dukej, nëpërmjet telefonave a shfaqjeve të saj në Ministri, duke u lutur t'ia jepja pa tjetër atë vend pune, se i duhej. Ishte diçka e habitshme dhe me këtë shpjegohen edhe telefonatat e mia drejtuar asaj, ndërkohë që vajza, duke parë se kjo lojë nuk po jepte rezultat, por ndofta edhe e ndërgjegjshme që ky rol ishte tepër i shëmtuar për të, u tërhoq.

Pas këtij dështimi në lojë hyri vajza e dytë, që siç u pa më vonë, ishte e një niveli më të ulët. Ajo, siç u vendos nga skenaristët, si fillim më merrte në telefon e fliste në rolin e vajzës së parë, pasi kjo ishte tërhequr e loja kishte ngecur. Më pas kur edhe ky rol nuk dha gjë ajo u porosit të shfaqej në ministri. Më pas të futej e të përgjonte deri në shtëpinë time, në shtëpinë e njeriut me imunitet (akt ky i paprecedent në botë edhe për një njeri të thjeshtë). Kjo vajzë e dytë provokatore, veç të tjerash, ishte e njohur prej vitesh prej meje. Ajo kish qenë dikur në një *Kafaz të Artë*, nga këta që u përhapën më vonë rëndom tek ne, si imitacion i *Big Brother*. E kisha përkrahur atje, duke e parë si një vajzë të varfër, ardhur nga provinca, kisha pasur për këtë përkrahje edhe falënderimet e nënës së saj. Më vonë më kish ardhur edhe në Fakultet për të kërkuar të drejtë studimi, gjatë kohës kur unë isha dekan.

Kur e pashë tek hyrja e ministrisë nuk e njoha. Qe veshur tebdil, me dekolte e varëse e xhingla të shumta. Më vonë në takimin e dytë, më ra ndër mend cila ishte. Kishte rënë nja 20 kile në peshë dhe ishte transformuar nga një vajzë e thjeshtë provinciale, në një gocë qyteti, me veshje ekzibicioniste të ekzagjeruar, që të shtynte të mendoje për jetën e saj edhe për më tej.

U rinjohëm si të thuash, rikujtuam periudhën e *Kafazit*, takimet e tjera dhe e lamë të më sillte dokumentet e saj. E lamë të m'i sillte një ditë pasdite, në Ministri. Nuk u duk siç i thashë, rreth

orës 6 pasdite, por mesa më kujtohet më mori në telefon kur sapo ishte kthyer në shtëpi, diku rreth orës 8.30, dhe teksa i thosha se isha i lodhur dhe se fajin e kishte vetë se nuk kish ardhur në zyrë, më shfaqti gatishmërinë të vinte të m'i sillte. Të tjerat u shfaqën në ekran. Erdhi, sërish gjysmë e zhveshur, provokoi. Më pas pasi nuk mori asnjë iniciativë të ikte se nuk i mbushej as asaj mendja që e kish realizuar detyrën siç duhej, sipas instruksioneve të ustallarëve. (I thashë vetë se mund të shkonte). Kishte të drejtë. Në të vërtetë nuk ndodhi asgjë. Doli siç hyri. E qetë, madje këmbëngulëse për të biseduar më shumë. Por për ustallarët kaq mjaftonte. Të tjerat i rregullonte regjia.

Njërës pra, të parës, iu tha se mund të fillonte punë, kuptohet sipas të gjithë rregullave të rekrutimit. Duke parë qëndrimin korrekt ajo nuk pranoi ta luajë a ta vazhdojë ta luajë më atë rol, ndonëse me të nuk u fol veçse për punë. Nga ndërhyrësi këmbëngulej, premtohej, kërkohet, ndoshta ngaqë nuk pati asnjë shenjë që vajza po provokohet. Në të kundërt asaj i thuhej se si të provokonte, si të joshte, dhe i kërkohet raport për reagimet e mia për të vazhduar pastaj më tej. Vajza e dytë, vajza provokatore, ishte e njohur, të linte të mendoje se provokonte, por ndërkohë njohja e hershme të bënte të ndërtoje edhe një raport tjetër, atë të viteve më parë kur për hir të këtij fakti kishte njohje dhe intimitet dhe, njëlloj si atëherë, meqë vinte nga fshati, duhej ndihmuar.

Kështu pra u arrit të provokohej e më pas të transmetohej një skenë ku nuk kishte as seks, as skandal seksual, por veç një bisedë të provokuar, që u krye me një vajzë të njohur më parë. As asaj dhe asnjërës prej vajzave nuk iu kërkua e as nuk iu premtua kurrë ndonjë gjë në këmbim të seksit, siç u mundua të paraqitej në pamjet e paraqitura e në mediat e shkruara që gjëmuan me fyerje e sajesa.

Tani që rixhiroj filmin e kësaj pjese të tmerrshme të jetës time mbrapsht, kujtohem se ka pasur dhe një femër tjetër ardhur pothuaj në të njëjtën kohë, përsëri dërguar nga Filipi, për të aplikuar gjoja për një projekt artistik. Gjithashtu veshur në mënyrë provokative. Një femër që e dërgova tek sektori i projekteve pasi më erdhi dy-tri herë me disa letra gjoja projekte dhe me lutjen e Filipit nga pas për ta ndihmuar. Ndoshta para saj ka pasur dhe një femër të katërt. Historia ka filluar hershëm, është ndjekur me këmbëngulje që kur një deputet demokristian më tha 8 muaj para ngjarjes: " Duan të ta fusin me femra, i kanë paguar mirë. Edhe 20000-30000 euro mund t'i paguajnë". Shikoni ç'skenar i ndyrë dhe ç'këmbëngulje për ta realizuar me çdo kusht atë. Pa dyshim që prapa ralizuesit dhe poshtërsisë së tij ka patur duar të fuqishme që prej kohësh kërkonin të më rrënonin edhe me mjete të tjera. Një hetues i zoti do të nxirrte "perla" nga kjo histori. Ja pse them se kjo histori ka filluar shumë më herët, sepse gjithnjë më vinin sinjale që "nuk e kisha të gjatë", që "do të më hiqnin" "që "isha vetëm e pa klan" etj.



Por ky skenar kishte në bazë e ishte ndoshta edhe finalja e një historie të filluar kohë më parë, pas konflikteve të vazhdueshme me televizionin *Top Channel* për lirimin e Piramidës e për ta kthyer atë në teatrin më të madh e më të bukur që kishin pasur ndonjëherë shqiptarët, që nga koha e formimit të shtetit të tyre të parë. Pas mbi 60 vjetësh, me një teatër që ngrihej mbi një godinë të amortizuar. Edhe kjo duhet hetuar.

Kishte mbi dy vjet që kjo perandori mediatike ishte në konflikt interesi me mua, pra me një ministër por edhe me një qeveri të tërë, për të penguar investimin më të madh të kulturës në Shqipëri, investimin me një vlerë prej 5 milion eurosh: teatrin e madh nacional. Por dihet se media në fjalë ishte një perandori e madhe, me miq e sponsorë të fuqishëm , me para të madhe, që e pengonte këtë investim. Nuk ishte kollaj të tërhiqej ajo nga qendra e Tiranës. Veç të tjerash edhe për provokim, sfidë shtetit.

Kur dikush i del kundër, kjo perandori e shkatërron. Dhe nuk ka pasur kurrë e nuk ka deri më sot asnjë protestë a shpirt proteste ndaj saj për sa e sa raste të tjera. Edhe shteti është tërhequr përpara saj. Edhe avokatët kanë frikë të meren me të. Viktimat po ashtu.

Sa e sa viktima të shantazheve, diskreditimeve e gjobave të medias së tmerrshme e kanë pësuar. Janë shkatërruar jetë njerëzish dhe askush prej tyre nuk ka në folur një fjalë. Kanë ulur kokën e kanë ikur, janë izoluar, sëmurrur e deri vetëvrarë,

vrarë, por askush nuk ka protestuar. U vra e u bë copë vajza vlonjate që shërbeu si kavje për të kapur oficerët e policisë, u shkatërrua profesori A.S, i provokuar poshtërsisht me seks po nga këta njerëz. (A e dini, thjesht për kuriozitet se edhe CIA, nuk e lejon përdorimin e provokimit seksual madje as edhe për raste sekrete shqiptare?) Sa e sa të tjerë janë goditur, gjobuar, sa e sa viktimat më kanë shkruar në e-mailin tim. Unë mendoj se ky nënshtrim i njerëzve është ende reminiscencë e dhunës së 45 vjetëve që kur shfaqet e fortë e mizore, vazhdon sërish të trembë njerëz. Unë mendoj se ka ardhur koha që kjo të marrë fund.

Një nga gjërat më të çuditshme në këtë vend është se as shoqëria civile e as ata që shkruajnë, as analistë e as intelektualë nuk kuptojnë a nuk duan të kuptojnë se këtu janë shkelur e po shkelen me të dyja këmbët të drejtat e njeriut. Këtu po dënohen a paradënohen njerëz nga media me një dënim të llahtarshëm, që mund të quhet damkosje publike, e përafërt me vdekjen. Këtu disa media e sidomos njera syresh kanë marrë të drejtën e vrasjes së jetës së njeriut, e helmimit të saj, e traumatizimit e shkatërrimit të familjes e imazhit të njeriut. Le të jetë në dashtë edhe me imunitet a personalitet. Mbi ç'bazë? Të dhënies së drejtësisë? Moralit? Kush u a dha këtë atribut? Kush i lejoi të përgjojnë në mënyrë të paligjshme dhe ç'është më e ulta brenda në banesë, në jetën private, kur këtë të drejtë e jep vetëm prokuroria, me autorizim të veçantë, madje për mjedise jashtë shtëpie.

Mbi ç'bazë pra? Mbi bazën e së drejtës së informimit e të shitjes së lajmit, gazetës, fitimit të televizionit? E paparë, e padëgjuar. "Duhet të kemi frikë nga media edhe në shtratin bashkëshortor" më tha pas ngjarjes një miku im, shkrimtar i njohur. Madje më tej. Media kësisoj pse të mos dërgojë dikë të vrasë edhe njerëz që të bëjë lajm. Pastaj të shesë gazetën a lajmin në TV dhe ka fituar para. Kjo pak a shumë është bërë dhe me mua e ca të tjerë. Ata kanë marrë frerin ndër dhëmbë dhe nuk ju del dot njeri para.

E pra kjo është një media "humane", që punon për të mirën publike, për moralin, për shoqërinë. Kjo është media që lufton kundër së keqes në emër të moralit e drejtësisë duke tejkuluar edhe kompetencat e prokurorisë. E pra kjo është po ajo media që nuk thotë një fjalë, një sekuencë për vajzën e vranë aksidentalisht me ish pronarin e saj. Familja e vajzës e viktimizuar, familja e vajzës-viktimë, qan e më thotë kur e vizitoj për ta ngushëlluar si deputetet i zonës: "Si nuk erdhi njeri të na ngushëllonte nga ky televizion". Kjo është media që pas sa e sa bëdash mendoj se me mua arriti kulmin duke realizuar në të njëjtën kohë kurthin, provokimin, dhunimin e banesës, cenimin e imunitetit, përgjimin e paligjshëm, linçimin politik të organizuar, deri goditjen individuale për arsye konflikti interesi e urrejtje personale e njëkohësisht edhe politike duke vjedhur, transmetuar e shkatërruar imazhin e një njeriu.

Kjo medie dhe ata që ishin pas saj vranë tek unë më të çmuarën gjë për të cilën jeton një njeri,

personalitetin e vlerat e tij, imazhin e krijuar me mund, opinionin e shëndoshë të njerëzve për to, raportet e mia shoqërore, vlerësimin e tyre për punën time kolosale për gati gjysëm shekulli.

Me këtë pikë kulmore unë mund të them me plot gojën se ky TV është në krye të një sistemi mediatik që përfshin disa medie që ushtrojnë mbi njerëzit, sidomos ata me emër, një diktaturë e terrorizëm mediatik të paparë.

Ngjarja ime erdhi gjithashtu pasi në lajme e emisione televizive unë isha sulmuar dhjetëra herë në cilësinë e ministrit, pasi kjo perandori mediatike nuk donte të lëvizte vendit me gjithë shkresat e panumërta të dërguara institucionalisht nga unë. Duke më parë si shkak kryesor të lëvizjes së tyre unë pa dyshim isha bërë prej kohësh i urryer për këtë media. A ka lidhje kjo me atë që mu bë?. Duhet hetuar. Dihet vetëm që pas gjithë këtyre përplasjeve erdhi ngjarja. U sajua një skenar i ulët dhe një situatë e tërë artificiale, u provokua pabesisht duke përdorur tërë arsenalin teknik e diabolik njerëzor, për të arritur një qëllim që nuk u realizua kurrë e u dështoi në situatë reale në zyrat e shtetit. Një sulm barbar, të paramenduare të organizuar që provokoi pabesisht kë? Një bandit? Një armik të njerëzve e shtetit? Një personalitet politik e akademik.

Për ta realizuar sa më mirë sulmin, me urdhër të perandorisë u vu në lëvizje një staf i tërë. Por kjo nuk është një fjalë goje. Po të shikohen kasetat filmike origjinale të gjithë punës së bërë nga një

staf i tërë televiziv, njerëzit do të ngjethen, do të tmerrohen. Është vërtet një realizim i tërë tekniko-regjisorial, një arsenal i tërë i vënë në veprim, një film për të cilin nuk është kursyer asgjë. Aty do të shihni vajzat se si instruktohen si të flasin, çfarë të thonë, si të joshin, të qeshin. Është gjithshka aty. Përgjimi, mashtrimi, kurthi, gracka. Është menduar për çdo detaj. Vajzat janë aktoret. Regjia është djalli. Më i shëmtuar e më i keq se djalli. Ditë të tëra për ta realizuar e për ta diskutuar. Prandaj edhe "suksesi" ishte "i plotë".

Tani pas kaq kohe kur munda të gjej kasetat origjinale, ju lutem, sado me vonesë ndiqeni më tej historinë. Ndiqeni ju lutem se brenda është jeta e një njeriu, shkatërrimi i saj dhe vetë ligësia e poshtërsia njerëzore që e bëri këtë. Dhe kjo mund t'i ndodhë kujtdo.

Ndiqeni dhe shihni se si një tjetër vajzë vinte e më takonte, një tjetër, më fliste në telefon. Si në një roman me dedektivë. Shihni që të kuptoni se kjo është fund e krye historia e një provokimi e më pas e një mashtrimi. Ju patë atë natë "filmin artistik" në Top Channel. Patë se si është montuar me skena seksi e muzikë e buzë femrash një ngjarje e stisur. Patë edhe ç'ndodhi më pas. Tani, pas disa muajsh, shihni si në transmetimet Pas Cak, si u përgatit filmi, shihni regjisorin, aktorët, zërat e ndryshuara të vajzave. Se si vajza e dytë provokatore flet në rolin e së parës. Kjo pasi vajza e parë duke parë sjelljen time korrekte është tërhequr nga loja. Më vonë ajo ka deponuar për poshtërsinë që po kryhej kundër meje, për sjelljen time korrekte dhe se si e mësonin të më provokonte. Shihni se si vajza e dytë shfrytëzon faktin që më njihte për të patur akses tek unë, ndërkohë që pohon

vetë “se ishte shumë zorr të më takonte”. Shihni se si merrte në telefon në rolin e së parës. Shihni në youtube të përmbledhura rreth 20 orë kaseta, a thua se po kapej banditi a skandali i shekullit. Shihni se si vajza provokatore hutohet e i kërkon ndihmë regjisorit kur provokimet e para karshi meje i dështojnë. Kur kërkon të më takojë natën e i them se nuk kam kohë. Shihni e kuptoni se ajo çka u transmetua ishte stisje, montazh, kurse e vërteta se si mund t’i qepesh një njeriu duke i kërkuar deri “të bëjë Krishtin në shtëpinë e tij” është thelbi i kësaj historie të ndyrë. Në kasetën origjinale të *TopChanelit* që tani mund të shihet e dëgjohet në youtub, dëgjoheh bisedat ne makinat që kanë rrethuar shtëpinë time në kulmin e aksionit të madh provokues. Një nga pjestarët e grupit komplotues i thotë tjetrit: “A ja ka hyp ai tani?”. Dhe tjetri: “Po ajo për atë punë ka shkuar”. Mendoni tani sa bukur vihet në provë morali. E paparë, e pa dëgjuar.

Shihni në you tube në adresën Video 1: <http://www.youtube.com/watch?v=bPnyURQZW-U>

Video 2: <http://www.youtube.com/watch?v=WA9X0uwdFBY>

Lexoni dhe komentet e njerëzve dhe indinjatën e tyre për këtë vepër të rëndë kriminale mediatike.

Po si e “hëngrën” mjaft njerëz të gjithë këtë xhanëm? Disa e hëngrën se stisja ishte bërë djallëzisht dhe nën efektin e goditjes së parë që më trulloste dhe mua. Të tjerë, ata që donin të më shihnin të vdekur prej kohësh, e “hëngrën” se donin ta hanin, se ju leverdiste, se një pjesë syresh kishte edhe gisht në këtë gjëmë. Ndërkohë ustallarët sërish kishin frikë se mund të ishte qepur jo dhe aq mirë. Prandaj edhe bombarduan me media që të nesërmen e paskëtaj, me opinione njerëzish, me fushatë linçimi sa më trulllosën.

I kam thënë që natën e parë kryeministrit që është montaturë. Ndonëse i trulllosur nga befasia dhe nga gjithë ai rrebesh nuk dija ku isha. Dhe ja ku doli. Shihni pra në youtube kasetën origjinale të përmbledhur. Shihni si është intriguar, sa është ngulur këmbë, si është dështuar dhe përsëri është ngulur këmbë, si e si ta varrosim profesorin. Se kështu ishte vendosur.

Dhe e gjitha kjo u finalizua me një pëfundim vërtet të lumtur. Happy end: shkatërimi i jetës së një njeriu, një profesori, një njeriu me vepër. Për arsye kapitali politik, konflikti interesi por pse jo edhe mërije e urrejtjeje individuale, ambicjeje e inferioriteti. Nuk është shkatërruar thjesht një personalitet njeriu si ky imi, por edhe ai i një ministri e deputeti zgjedhur nga populli në zonën elektorale më të madhe të Tiranës. Urrejtja e ambicja vinte edhe këndeje. Kujtoni kënaqësinë e urrejtjen e mediatikëve e një pjese të politikës pas ngjarjes. Ç'indinjatë? Por për shkak të cilit dëm, cilës viktimë? Nuk ka viktimë. Kurrë nuk ka patur për shkak tim. Nuk kish asnjë viktimë veç meje. Pra një viktimë, një shkatërrim të vetëm, atë të personalitetit tim, shkatërim që u dha kënaqësi mjaft njerëzve.

Kam pasur, më kujtohet, me mijra telefonata urimi natën e fitores së madhe elektorale të 2005. Me qindra të tilla sharjesh e fyerjesh natën e gjëmës së madhe. Nën efektin e një manipulimi të ndyrë mediatik. (më vonë mjaft më kanë telefonuar e dërguar sms duke më kërkuar falje e duke

shprehur keqardhjen për reagimin e parë). Por disa të tjerë jo. As nuk kërkuan falje por as heshtën të paktën. Vazhduan me sharje e fyerje në media e kudo. Po çfarë shohin tek unë këta njerëz? Ashtu si deri më dje profesorin, doktorin, ministrin, polemistin, autorin e librave e shkrimeve? Jo. Çfarë absurdi! Ata shohin, shajnë e sulmojnë atë që bëri Filipin, produktin e intrigës së tij. Një episod. Të montuar e sajuar djallëzisht. Gjithshka tjetër e imja u harrua për ta. U bë pluhur e hi.

Zoti të ka dhënë shumë, më ka thënë dikush, pamje, inteligjencë, energji, sukses. Ndoshta. Zoti mi dha. Zotit i falem. Njerëzit, disa syresh, mi mohuan. I falënderoj: më dhanë ekzekutim politik e social. Madje me dëshirë mund të më çonin edhe në vdekje fizike. Në fakt pas të parave rëndom tek njerëz të tjerë ka ardhur edhe kjo. Disa donin edhe burg, madje të përjetshëm. Por sidomos ishte i dëshiruar ekzekutimi i emrit, që të ai përdhosej ndër breza. Pra duke dënuar kësisoj edhe tim bir e të tjerë... O zot ç'egërsi.

Shkatërrimi i personalitetit të ngritur me kaq mund i ngjet shkatërrimit të një ngrehine të madhe me një bombë. Me një bombë si ajo që desh më mori jetën në mars 2003, 6 vjet më parë. Atëhere nuk ma morën dot jetën. Edhe atëhere si në një kor hienash media të njëjta ulërinë e shanë. Përfytyroni në një televizion u anketuan njerëzit madje nëse e meritoja bombën apo jo? E kuptoni, a meritoja të ekzekutohesha me atentat apo jo?! Por mbijetova. U ringrita. 6 vjet më vonë, 4 mars



2009, më goditën me një bombë akoma më të tmerrshme. Më helmuan jetën, më shkatërruan reputacionin, personalitetin.

Shumë interesa e urrejtje personale janë bashkuar kundër meje në këtë rast. Mjaft armiq. Politikë, mediatikë, personalë, biznese të mëdha. Prandaj kam thënë se me atë që ndodhi fituan të gjithë. Me mua fituan “të gjithë” (ata që mund të fitonin në politikë e media, jo njerëzit e thjeshtë). Fitoi opozita e disa nga pozita, fitoi media e bosët e saj, gazetarët që në disa raste u paguan shtrenjtë si Blendi atë natë kur u shfaqta unë në TV Klan i dërrmuar (më thanë se mori 15 milion), fitoi Top Chanel e fiksi që e shpalli këtë kulmin e lavdisë së vet, fituan armiqtë e mi personalë që e ngritën një doli lumturie, fitoi vajza që mori dy milion (nëse i mori). Humba vetëm unë. Viktima e vetme isha unë e familja ime që u shkatëruam, u traumatizua, u sakatuam e u vramë jo si të ishim njerëz por qen të egër.

Akoma më e tmerrshme: me dy regjisorët kryesorë të kësaj farse të ndyrë, kam ngrënë drekë dhe dy herë të tjera pasi gjella e shtrigave ishte gatuar. I kam sajdisur pa ditur ç’më kishin kurdisur. E njeri syresh, më skuthi, ditën përpara transmetimit më betohej që nuk dinte gjë. Një tmerr të tillë të paimagjinueshëm e kam lexuar vetëm në libra.

E për të stisur gjithë këtë skenar duhej gjetur edhe një sebep, një pretext. Autorët e moralshëm na ishin të shqetësuar shumë për moralin publik.

Por edhe timin në veçanti dhe atë të qeverisë që duhej të godisnin në çdo lloj forme, në përgjithësi. Kishin gjoja dhe “indicie”. O zot përse nuk i shfrytëzuan ato? Përse nuk pyetën sa e sa gra e vajza në ministri si janë pranuar në punë. Natyrisht që nuk mund ta bënë se gjithshka do të dilte e rreme. Indicia ishin thjesht thashethemet. Ishte dhe kjo në vazhden e gjithë manipulimeve e sajeseve me origjinë injorancën, poshtërsinë, hakmarrjen. Por mbi të gjitha me mbështetje edhe nga qarqe politike të egra nga ku dhe u mor bekimi.

U morën për bazë gjoja indiciet, informacionet se unë u afroja punë për seks femrave. Kaq duhej, thashetheme e ligësi dhe filloi loja. Ndërkohë nuk kishte pasur asnjë kërkesë për seks, asnjë ofrim vendi pune në këmbim të tij, asnjë raport jokorrekt me punonjëset femra të Ministrisë së Kulturës, me të cilat ishte punuar e ishin kryer me sukses sa e sa punë të mëdha të këtij dikasteri. E njëjta gjë edhe në të kaluarën. Vetëm punë e bashkëpunim i frytshëm me vajza e gra në Fakultet, në Ministri të Arsimit, Institut e kudo gjetkë. Kurrë nuk i ishte hyrë në sinor ndokujt. Por gjithsesi duhej stisur pra, pasi u pa se në zyrë e publik nuk ishte arritur kurrë asnjë gjë, (kudo, prej mbi 30 vjetësh në pozicion publik nuk më kish ndodhur as edhe një incident). Por gjithsesi thuhej, “ka pasur lidhje me femra”. O zot. Po ç’lidhje kishte kjo me “abuzimin” që përgatitej të provokohej. E kush nuk ka pasur lidhje me femra? E kujt nuk i pëlqejnë femrat? Por këtu ngatërrohej me dashje raporti normal, njerëzor

me to, me abuzimin e supozuar në marrëdhëniet zyrtare. Ky ishte dhe preteksti i ndërtimit të skenarit. Asnjë lidhje nuk kishte kjo me detyrën në Ministri, ku qëndrimi ishte më se zyrtar. Por duhej bërë. Tashmë ishte vendosur, ndaj dhe u ndërtua me aq zell skenari.

Skenari me pjesën e paturp e mizore, arrogante, me aktin e paprecedent, me hyrjen në shtëpinë time bashkë me një arsenal të tërë regjisorial, përgatitur që më parë. Ndryshe nuk mund të arrihej qëllimi.

Skenari i mbrritjes së vajzës çuditërisht me një interval pak minutash pas telefonit të saj. Kushedi sa pranë kishin qenë e prisnin makinat, stafi që bëri mrekullinë. Skenari i natës me vajzën me veshje tejet provokuese. I vajzës që provokoi, luajti rolin e caktuar e më pas bëri edhe të ndershmen përpara aparatit të vet regjistruës. Dhe për publikun u krijua imazhi i një vajze hallexheshë që vjen të kërkojë punë. E çuditshme si e përfytyruan njerëzit të tillë dhe si e lidhën në imagjinatën e tyre atë me atë të dhjetra vajzave që kërkojnë punë e u kërkohet seks. Si e përgjithësuan e analizuan pastaj analistët e politikanët, mediat. Si e përfytyruan se ky ishte realiteti i ndodhur e jo më një sajësë e provokim i ndyrë. Pa dyshim skenari ishte ndërtuar me mjeshtëri për të krijuar këtë imazh. Shkrimet që vijuan më pas, sulmet individuale e të organizuara çoroditën gjithë njerëzinë.

Ndërkohë, e ardhura nuk paraqiste asgjë të ngjashme në raport me një vajzë korrekte, me një vajzë që kërkon normalisht punë, si mjaft të tilla

që kanë ardhur e janë punësuar ose jo, në raport me aftësinë e CV e tyre. Përkundrazi. Vajza vinte e veshur nga ustallarët e saj dhe e instruktuar të sillej në mënyrë që të nxiste reagimin mashkullor. Ajo ishte e njohur prej meje që prej disa vitesh, ndaj dhe ardhja natën, në shtëpi, ndaj dhe veshja, sjellja e gjithçka të linte shkas të mendoje se ishte e aftë t'i bënte të gjitha. Kurrë nuk mund të reagohet karshi cilësdo femër, kur ajo mban qëndrim korrekt, sidomos kur nuk sillet e vishet si prostitutë. E megjithatë edhe karshi kësaj vajze u ruajt respekti, distanca e ajo doli e qetë dhe e patrazuar nga shtëpia. Unë nuk ju dorëzoja provokimit në atë formë që do ta kishin dashur hartuesit e skenarit.

Pa dyshim, nga pjesët më të shëmtuara të skenarit është roli që iu la vajzës të luajë si dhe pranimi nga ana e saj i këtij roli, të cilin, siç thuhet, ajo e ka kryer dhe herë të tjera, madje në rrethana akoma më të shëmtuara.

Më pas erdhi goditja mizore masive mediatike, e sa e sa medieve, pa iu dhënë paraprakisht as mundësia më e vogël për shpjegime një njeriu me një karrierë e personalitet të njohur. Madje as lidhur me transmetimin e cunguar. Ky njeri u dënua nga analistë, nga media dhe një pjesë e politikës. Përmes cinizmit kolektiv e mediatik të paparë, u arrit deri në kërkesën për vetëvrasje që iu bë haptazi nga disa “vrasës mediatikë”.

Dhe kjo kur nuk ishte shfaqur veçse ajo pjesë e kasetave që kishin stisur autorët! Duke e paraqitur

ngjarjen kësisoj, të gjymtuar, janë manipuluar edhe fakte duke luajtur me imazhet dhe me impresionet e njerëzve. Më pas vërshoi një inondate analizash mediatike fyese e shpifëse, një furi artikujsh, nxitjesh e nxirjesh. Jam i sigurt që njerëzit që në fillim, po t'i njihnin të gjitha faktet, do të gjykonin shumë më ndryshe e do të bindeshin për shkallën e madhe të manipulimit, provokimit e poshtërsisë që është përdorur. Por edhe kështu, pak ditë më vonë një pjesë e mirë e njerëzve u ffilluan dhe e dënuan provokimin e ndyrë. Gjithsesi ka ende të impresionuar. Prandaj po i shkruaj këto radhë. Por edhe për arsye të tjera.

**Të nderuar shqiptarë.** Tani që gjakrat e nxehur të moralit të prekur u ftohën e kam radhën të shprehem unë, gjakprishuri.

Kam 40 e kusur vjet, që kur mashkulli fillon të ndjehet mashkull, që as nuk më ka shkuar kurrë mendja as të dhunoj a të zhvesh njeri nudo, as të rrah një femër e as të dal nudo, e jo më t'i bëj vetë veprime të tilla. As në zyrë të shtetit e as të privatit.

Në rreth 10 ditë skëterre mbi mua u hodhën tonelata lumenjërëzor, sharjesheshpifjeshpafund. Llumi i moralit fals shpërtheu nga qindra kanale e mijëra vrima ujërash të zeza a qoshesh të errëta të nënvetëdijes njerëzore. Goditja ishte politike, mediatiko-politike, por edhe personale, e lidhur me ambicie, zilira e urrejtje a shpagime mediokre

personale. njerëzish hakmarrës, mediokër, të korruptuar, të paaftë të pushuar nga puna, njerëz që më urrenin thjesht për suksesin, por edhe thjesht për pamjen, ecjen, mbajtjen e kokës lart a çdo lloj antipatie tjetër absurde njerëzore. Analistë të paguar a të inspiruar, politikanë të degraduar me bëma, media mishngrënëse, u hodhën mbi mua me një egërsi të paparë. Me mijëra tonelata letër higjienike u nxinë më bojë e mellan të zi dhe m'u ngarkuan mbi kurriz. Sharje pa fund kam duruar këta muaj, përdhosje, shkelje, vrer e pisllek. Unë e di ç'kam mbajtur në kurriz për këtë "skandal seksual" pa seks. (dikush më quajti pas gjithë këtyre në facebook, kërma Pango". Kishte të drejtë. Nga gjithë këto goditje veç në kërmë mund të kthehesh).

Në këto javë të tmerrshme kam pësuar një konsumim moral e fizik të paparë. Të tilla jo vetëm për mua e jetën time, por edhe si për rrallë kënd tjetër në këto 20 vjet demokraci. I trullosur nga gjithë ajo goditje, nuk dija ç'të thoja e të bëja. Më vonë kur më ranë në dorë kasetat origjinale, kur analizova, kuptova sa e poshtër ishte goditja që më ishte bërë.

Ndërkohë gati jam shembur përfundimisht nga pesha e madhe e vrerit. (Doli dhe vetë Vreri në emision me ca burra e gra të moralshme e më derdhën vrer me okë). Shembja ime përdhe nga bomba, po në marsin e 6 vjetëve më parë, vuajtjet e ferrit në spital dhe operacioni, ishin asgjë në krahasim me këtë. Shpifja e disa politikanëve

e mediave atëhere, për gjoja vënien e bombës nga unë vetë, të nesërmen e plasjes së saj, ishte e krahasueshme. Edhe atëherë kishte patur një lumë skëterre në gazeta, shoqëruar me shpifje të panumërta e sharje. Njerëzve të mi, atyre që mendonin a do shpëtoja a jo gjallë, u duhej të mbanin edhe një turp a një goditje që u konsiderua nga disa si atentati i dytë ndaj meje. Në vend të përqendroheshin te njeriu në rrezik, atyre u duhej të mbanin mbi supe edhe barrën e shpifjeve. Në të dy rastet mbi mua hidhej llum. Dhe çuditërisht, ishin po ato gazeta. Në një pjesë të madhe po ata gazetarë.

Dhe ja përsëri. Brenda pak ditësh u mbuluan me llum të gjithë ç'kisha bërë në këtë jetë. U fundosën 10 librat e mi, qindra a mijëra faqe shkrime e artikuj, u zhvleftësuan botimet dhe projektet e institutit tim, (ky u shpall gati një herezi dhe iu nënshtrua hetimit) me USAID-in, Komunitetin Evropian etj. (Po ç'të thuash kur veç të tjerash ti profesor, doktor e punonjës shkencor, bëhesh pre e komenteve e analizave deri edhe të gazetarëve a mediave që në vend të *infarkt* thonë *infrakt*, në vend të *maternitet* shkruajnë *martenitet*, në vend të *recesion* shkruajnë *recension*. Këtu jemi ende larg kulturës e demokracisë. Është kjo nga arësyet kryesore që këtu ende nuk ka hierarki vlerash dhe mund të shembësh këdo).

U mohua amfiteatri 300 vendsh që krijova në Fakultet, po ashtu edhe hapja e degës së re të shkencave politike, rruga e Saukut e

rrugë te reja ne zonën elektorale, ndërtimi i ministrisë së re, i Bibliotekës së Librit të Huaj në Tiranë, restaurimi i dhjetëra shtëpive në Berat dhe pranimi i tij në UNESCO, restaurimi i sa e sa shtëpive në Gjirokastër dhe e gjithë Qafa e Pazarit në rikonstruksion, rruga e re me kalldrëm 'Kol Idromeno' në Shkodër, u harrua edhe bumi i turizmit shqiptar, Agjencia e Shërbimit Arkeologjik, ekspozita e madhe për të përndjekurit, fondi i madh spanjoll për restaurimin e Muzeut Kombëtar, projekti i madh me Fondin e Komunitetit Evropian për restaurimin e kalave të Shqipërisë e sa e sa gjëra të tjera. Të gjitha befas u harruan, u mbuluan. Madje, për të mbuluar çdo gjurmë të punëve të mia u shkua edhe më tej. Dikush tentoi e ia doli ta hiqte natën nga muret e një konvikti në Q. Studenti tabelën përkujtimore për rrugën dhe lulishten e bërë nga unë, si deputet për komunitetin. Një nëpunës i lartë e i zellshëm i ministrisë, deri dje besnik i imi, propozoi, bëri gati shkresën e madje u turr me ngulm dhe hoqi edhe tabelën me emrin e kryeministrit dhe emrin tim nga dera e Ministrisë së Kulturës. Tabelën që tregonte se si ishte restauruar e transformuar kjo ndërtesë në shembje dhe e kthyer ne mejhane, në godinën më të bukur ministrore. Njëherazi me këto u propozua edhe heqja e titullit të pedagogut a profesorit, si dhe djegia e librave. Askujt nuk i shkoi mendja të kujtohej se ish ndalur një makinë pune që i kish bërë të gjitha këto. Figura ime si zv.ministër, si dekan, ministër, librat e mi, jeta



akademike, gjithçka u shemb me një goditje të vetme, me një filmim të stisur e absurd. Një jetë njerëzore ngritur me mundim, punë e luftë, u rrëzua sa çel e mbyll sytë. Askujt nuk i shkoi ndërmend të shihte qoftë edhe për një moment raportin dobi shoqërore-dëm shoqëror, që sillte goditja e figurës së këtij njeriu. Kush humbte e kush fitonte? Çfarë humbeje e çfarë fitohej? Ç'bilanc, ç'absurd? Sa e sa shkolla, sa e sa punë të mira, 1000 punë të mira dhe një "e keqe" e madhe që i mbyste të gjitha këto? Një ngjarje e provokuar, femrat...

Por kishte edhe një raport tjetër, raporti qëndrim politikanësh e mediash-qëndrim njerëzish të thjeshtë, për të cilin do të flas më poshtë, raport ky që më bindi se njerëzit, në një masë të madhe nuk e kishin pranuar këtë ngjarje. Madje e kishin konsideruar poshtërsi. Fillimisht kjo, i shokuar siç isha, më habiti edhe mua. I mbuluar nga të gjitha anët me një llum të trashë e të zi, katran të zi, gati për t'u shkrumbuar së bashku me librat e mi, mendoja se gjithë bota u përmbys mbi mua dhe gjithçka ishte kundër meje. Vetëm turra e druve mungonte. Njerëzit lexonin çdo ditë me etje gazetat me bëmat e mia. Çdo ditë dilnin të reja. Rezultonte se kisha qenë i llahtarshëm. Do të hetohet edhe për këtë... Do dënohet edhe për atë... Të nesërmen e çdo dite nuk më habiste më të dilja edhe hajdut, vrasës, grabitës bankash. (Historia herë- herë vazhdon edhe sot në ndonjë gazetë) Gazetat hapeshin e mbylleshin me mua. Një vajzë

nga Fieri më shkruante pas kësaj, kur orteku i llumit mediatik pushoi, se “tani e merrte malli të më shihte në gazetë” e se u mësua me portretin tim të kryqëzuar në të.

Nëpër redaksi gazetash, kryeredaktorë e redaktorë të ndërkryer, ca syresh edhe të pirë, lëshonin, sidomos atë natën e parë, rrëke pështymësh e gëlbazash mbi letër. Gati-gati seksonin me artikujt e gazetës natën para daljes së tyre. (Disa gazetarë të thjeshtë të këtyre gazetave të ndyra më morën të tmerruar nga ajo që shihnin e dëgjonin në redaksi e më shprehën solidaritetin. “Mos kujto se nuk e kuptojmë se ç’po ndodh, por nuk kemi fuqi të të ndihmojmë” më shkruante njeri syresh ).

“Monstër, përbindësh, shkërdhatë...!” ulërinte më i zellshmi i mediabërësve. Kishin të drejtë. Nuk kisha bërë pak. Kisha “prekur” një jelek, jelekun e nderit, çerekjelekun, jelekun e vockël të moralit shqiptar. “Mbërtheckat, mbërtheckat!”, këlthisterioshi shqiptar me pretendime në politikë, Erion Lejfeni. (Pse jo, në mendje i shkonte, hapja e një biznesi të ri e të suksesshëm mbërtheckash). Politikani flokëbardhë Pa-Boshti dhe politikani tashmë plak Dhelpra, atë natë nuk fjetën gjumë, duke çuar nëpër mend rininë. I pari e shihte të konsumuar, të çuar dëm. Të dytit i fanepseshin sërish ndër mend rendjet e tij pa fund pas vajzave të zarzavateve.

Si në një manifestim të madh popullor (m’u kujtua sulmi kundër Pasternakut për Zhivagon,

nuk di se pse) menjëherë pas Fiksit, emisionit të famshëm jetëshkatërrues, filluan të çohen me radhë, mbrojtësit e shumtë e më të pastër të moralit shqiptar:

“**Gazetat** nesër nxijnë të tëra, je në të gjitha faqet e para”, më thotë nipi im. Dhe kështu, madje edhe më shumë, me faqe të dyta, të treta, pa fund. Një garë titujsh skandalozë, të zinj, foto e shprehje të montuara, histori ngjethëse, dëshmitare me tituj dëshmonjës të mëdhenj, por pa kurrfarë dëshmie brenda.

Pastaj, menjëherë, si me një komandë, filluan të ngrihen përfaqësues të lartë të universiteteve, të organizatave të grave, të organizatave rinore. Parulla të mëdha të shkruara me fjalët “Turp! Turp!”, pushtuan oborrin e Ministrisë. Ishin të rinjtë e partizës së majtë. Rikthehej kështu lavdishëm koha e dacibaove. Prisja, pa asnjë surprizë, të dëgjoja se qenë ngritur në protestë edhe shoqata të tjera, si ajo e teneqepunuesve, e brekëbërësve, shoqata të jeleqeve me mbërthecka që ndofta do të ishte e vetmja që do të më falënderonte për rritjen e xhiros. (“Pak art, pak art në këtë gjëmë moraliste!”, do të thoshte miku im). U hodh ideja që problemi të diskutohej edhe nëpër shkolla. Deri në ciklin e ulët, ku fëmijët do të dënonin rastin për të mësuar se si të mos gabonin në të ardhmen në raste të tilla. (Si vallë? Duke ju treguar me gisht derën tetave që do ku shkonin natën gjysëm të xhveshura te dera? “Përrjashta!”) Në spitalin më të madh të kryeqytetit një mjek moralist flokëbardhë e nisi mbledhjen

e mëngjesit me propozimin për diskutimin e dënimit të gjestit tim. (U ngrit një mjeke e i tha “le nam, na kujtove Enverin” dhe mbledhja u shty). Shoqëria po përjetonte një rikthim të bujshëm në të kaluarën e lavdishme. Indinjata nuk njihte më kufi. *Fiksi*, emisioni triumfator e televizioni i tij mëmë, ngazëllehej. Në emisionet në vijim, lexonin sulmet e gazetave, të organizatave të masave, personaliteteve. Falënderoheshin njerëzit për solidaritetin. Një unitet i tillë *Fiks Fare* – Popull, nuk ishte parë prej dekadash.

Morali i medias perandorake, kishte triumfuar. Media e moralit “të pastër” që merr vajzat hallexhesha nga provinca, i dërgon natën drejt së panjohurës, rreziqeve pra i shet, i paguan, nganjëherë edhe nuk i paguan, i bën të përfundojnë të vrara nga duar kriminale, si vajza vlonjate, i mohon, i harron, i injoron, media më e shikuar, dhe ky është paradoksi, kishte mbrojtur “moralin” e pastër, të kulluar, moralin brenda në shtëpinë e qytetarit, deputetit, ministrit, nëpërmjet një provokacioni të ndyrë. Dhe gjindja ngazëllente. Media “morale”, mbrojtëse e moralit mbitokësor, realizoi një provokim-kastigim shembullor, gati vrasës, që u kurorëzua deri në kërkesë për vetëvrasje.

Unë, i provokuari, gjoja kisha prekur kopsat a mbërtheckat e një jeleku, e një fije jeleku, një natë vonë, në shtëpinë time. Kurse ata prekën e i hoqën koren një m.. që binte erë, një moçali, një morali fals që kutërboi ditë të tëra hipokrizi, falsitet, hakmarrje

e poshtërsi. Me një burracakëri të pashoqe, pas gazetave të ditës së dytë, filluan të ngrihen valë të reja hakmarrëse. Me dhjetëra pseudointelektualë u ngritën të godasin njeriun që kish rënë përtokë nga barra e pambajtshme e një orteku pisllëku pa fund. Ishpresidentë, xhufër e apollonër hakmarrës, me mllefin e konflikteve të shkuara në gji, më mohonin deri ekzistencën, jetën time. ("Përse duhet të ekzistojë një qenie e tillë, ç'i duhet demokracisë?!", shkruante plot duf xhuf-studiuësi i historisë. Ai mohonte familjen time, nënën, djalin, motrën, rrethin familjar. Identitetin. Shkurt, unë isha një njeri pa njeri, pa miq, monstër që duhej dëbuar, terratisur, zhdukur. (Ndofta prandaj më qe kujtuar Pasternaku).

Më shante në shkrimin e tij një ishpresident, më sfidonte një kryetar nderi partie, një ishdrejtor instituti i pushuar për korrupsion. Një ishpunonjëse e paaftë e ministrisë, pushuar prej kohësh, bridhte nëpër Tiranë, pinte kafe me armiq të mi dhe përpiqeshin së bashku, zellshëm të gjenin shkelje të tjera të miat, tendera, etj.

Avokati i konsumatorëve, i lumtur, ofronte qerasje, pije e ushqim falas, sepse e konsideronte festë të madhe të tijën, ngjarje-gjëmën time. "Nuk mund të mos shpreh hapur gëzimin tim për këtë njeri!", ngazëllehej ai.

Vite më parë, kur isha dekan, nuk e kisha pranuar të regjistrohej në shkollën për master, thjesht për shkak të mesatares së ulët, diku midis 5 e 6. Sa e shtrenjtë është hakmarrja e shqiptarit.

I diplomuari për miniera, por specialist për gjithshka, Ham Lame gjithashtu e shprehte këtë

gëzim hapur në gazetë. Ftonte lexuesit për një gëzim mbarëpopullor mediatik.

Gëzimi i të ligjve ishte i pamatë.

Nuk kam njohur kurrë një mllef të tillë të pamatë njerëzor. Femra të shitura, që godisnin në festë një kufomë në kallje. Burracakë. Njerëz, jo njerëz por burracakë, për të cilët kam folur e shkruar apo kritikuar kur kanë qenë në majë të fronit e jo kur kanë rënë. Në vend tim ata do të kishin vdekur.

“T’i digjen librat!” u hodh një tjetër. “Pllaka ku është shkruar emri i tij si përkujtimore për ndërtimin e godinës së Ministrisë të copëtohet! T’i shkulet emri! Nuk ish çudi të dëgjohej e thuhej edhe: “Të zhbëhet biblioteka e librit të huaj në rrugë të Elbasanit! Edhe shtëpitë e restauruara në Gjirokastër e në Berat. Rruga në Shkodër të mos quhet e Ministrisë”, “Turizmi të dalë në vend të fundit në Ballkan!” , e të tjera si këto. Pas dërrmimit fizik e psikologjik po ndodhte shkujla e simboleve. Po shuhej nga defterët emri i një njeriu dhe gjithë ç’lidhej me të. Natën vonë, siç e thashë, në Qytetin Studenti, hajna të panjohur, arritën ta shkulin tabelën me emrin tim, ku shkruhej se i kisha dhënë elektoratit të zonës, një rrugë dhe një lulishte. U zhduk nga webside zyrtar i Ministrisë emri im dhe çdo gjë e mirë që kisha bërë si ministër.

Më në fund po kuptoja qartë: po ndodhte një *mrekulli shqiptare*, po **linçohesha**.

Një falangë e tërë e shoqërisë së pseudo emancipuar, por edhe asaj shpirtvogël së bashku me të, po godiste në mënyrë shtazarake.

“Ta vrasim këtë qen, që veç të tjerash mban edhe kokën lart!”. “Ta zhdukim fare, ta varrosim!” Ndërkohë, në celularin tim vazhdonin të vinin telefonata të pandërprera me numër privat. Nuk mund të komunikoja me askënd, as edhe me një mik, për të gjetur ndopak kurajë a mbështetje. As nuk mund të konsultohesha a nuk di se çfarë. Asnjë lidhje me botën, me miqtë, me njerëzit. Çdo gjë u bë asfiksuese. Çdo gjë e organizuar në mënyrë të përsosur.

Mungonte vetëm makina e ngarkimit të plaçkave për në internim për ta bërë gjithçka një kuadër perfekt të së kaluarës.

Shoqëria shqiptare po pastrohej me shpejtësi. Pas një periudhe të gjatë, rreth 20 vjeçare, morali të dyshimtë, jashtë çdo besimi e feje, pas një trandje të gjatë 50 vjeçare shqiptarët (apo një pjesë e tyre) po dilnin për herë të parë në shesh me pallën e moralit zhveshur. Me këtë luzmë urrejtjeje e reagim të fuqishëm popullor, ne rezultojmë kështu e pa dyshim vendi më i moralshëm në botë. Shoqëria e moralit të kulluar! Si kështu vallë? Të parët në botë?

Fare e thjeshtë. Në një vend të madh të botës së madhe, një president kërkoi dhe seks oral me nëpunësen e vet, në një situatë reale, në zyrë dhe u la i lirë të shprehej u hetua, u investigua, opinionioni publik ndoqi me qetësi deri në fund hetimin dhe përfundimin duke e lejuar presidentin të ndiqte jetën e tij normale familjare e politike madje duke e mbështetur në vijimësi edhe më pas.

Një karrierë që vazhdoi e suksesshme. Në një vend tjetër të madh në Angli u krye seks në parlament, u filmua, u dual nudo. Guxoi ta jepte ngjarjen, vetëm një gazetë dhe sërish asgjë. Në vendin fqinjë kryeministri u filmua me femrat nudo dhe akuzoi me të drejtë për ndërhyrje në jetën private. Sa e sa raste të tjera në botë.

Kurse tek ne, pa i dhënë njeriut as mundësinë më të vogël për shpjegime, me disa sekuenca dialogu e, pa lidhje pune dhe me njohje personale të hershme me vajzën, në një situatë artificiale, të sajuar e provuar pa sukses disa herë më parë (shpresohej në zyrë, ku edhe u kapa për krahu në mënyrë provokative), një ministër u zhbë vetëm me ca pamje filmike normale dhe një dialog, duke i folur për vendin e punës së një modeleje një vizitoreje gjysëm të xhveshur të natës. As seks, as gjë të tillë si në skandale të mirëfillta seksuale. (Natyrisht, edhe i shfajësoj disi njerëzit për këtë moment të parë. Si psikolog e mirëkuptoj se ç'ka ndodhur në mendjen e secilit, përderisa edhe në mendjen time, në ato momente, goditja ishte shokuese. Imazhi e presioni mediatik, mjeshtëria regjisoriale e montimit e shfaqjes së asaj nate, më bënë dhe mua ato momente, të ndjehem kriminel i madh).

Ndërkohë, në shtëpinë tonë, e ashtuquajtura "Vila Pango", me katër familje brenda saj, nëna ime, motra me familjen, nipi e mbesa me familjet e tyre, kishte rënë murtaja dhe njerëzit lëviznin si hije. Im bir, në Itali, ende student i vitit të parë, ende



me stresin e homesickness, sëmundjes së shtëpisë (e para herë që ndahej nga familja), mori dhe këtë goditje tjetër, të papërbalueshme për moshën dhe gjendjen e tij shpirtërore. Ijati po shaheje denigrohej në media, në facebook, madje përmendej dhe në mediat italiane, franceze, gjermane, turke, deri kineze, ku skenari kish parashikuar, si në shumë medie të tjera ndërkombëtare përcimin e lajmit për “skandalin” seksual Pango. Një emër i nderuar që fëlliqej pa reshtur. Një jetë e tërë, vite pune që plaseshin për tokë. Një baba që ndiqej prej tij si model dhe sa çel e mbyll trajtohej si kriminel. Im bir u mbyll në vetvete dhe mezi fliste. Shpesh herë nuk i hapte telefonin as së ëmës e as gjyshes së vet. Komunikonte vetëm me mua dhe më thoshte se donte të vinte në Shqipëri, të më ishte krah, më premtonte se kurrë nuk do më ndahej. Im bir më kish ndjekur gjithnjë si idealin e tij. Ndërkohë personazhi kryesor, “kriminelin” Pango, mbi bazën e rekomandimeve mediatike e kaloi ashtu një herë si rastësisht nëpërmend edhe vetvrasjen.

Por nuk u vetëvra, siç prisnin disa. Ndoshta disave u mbetej veç të më vrisnin vetë, pa dyshim nëse dyshonin se dikur do mund t’ia hiqja krejt koren kësaj fëlliqësie.

Një studiues, një publicist e pas tij ca të tjerë, diku aty nga fundi i rrebeshit u kujtuan. “A mos e tepruam ca? Mos e vdiqëm fare!” (O zot ç’humanizëm! Sa shpejt u kujtuan!). Pra, pasi ndërsyen e lëshuan të kafshojnë gjithë hienat

e çakejtë, u tha: Mjaft! Por tani e kishin radhën qentë e rrugës. Nuk kish qen rruge, sidomos ata të tërbuarit e politikës, që nuk lëshohet të kafshonte. Le më pleshtat e mizat që nuk të linin rehat. Njerëzit që kthenin kokat, që pëshpëritnin, flisnin. Natyrisht kishte dhe shumë njerëz që kuptonin ç'poshtërsi ishte bërë dhe më rrinin afër e më qetësonin, por e keqja gjithnjë është më e madhe në këtë vend. Ther në kockë.

Me një shpejtësi të habitshme pra, sa çel e mbyll sytë, pas 10 ditësh reprezalje e mizorie, rrufesh e bubullimash, masakre mediatike, koha "u hap" disi. Shkrimet befas pushuan. Pati madje edhe shkrime mbështetëse. U shfaq e u rishfaq në disa shkrime parabola e Krishtit me Madalenën. Le ta godasin vetëm jomëkatarët. Pra, përsëri pjesa e dytë e ngjarjes, linçimi dhe një lloj ndjese për të. Për pjesën e parë të tij, "mëkatin im", ai quhej i mirëqenë, për atë mirë e kisha pësuar, mirë isha dënuar. (Askujt nuk i shkante mendja të shkruante se e gjitha ishte rezultat provokimi dhe kjo e bënte çështjen nul në bazë të çdo konvente ndërkombëtare evropiane, por edhe të çdo morali minimal njerëzor, apo edhe gjenetik, sipas të cilit mashkulli është mashkull dhe po u provokua edhe gabon (unë as edhe kisha gabuar). As që ishte shkelur privatësia, ishte përgjuar në mënyrë të paligjshme. Paçka se isha në shtëpi, natën e i provokuar nga një e njohur e vjetër. Asgjë nga këto. Ishin të gjithë të ndikuar nga ajo që ishte transmetuar mjeshtërisht.

Vetëm pjesa e goditjes pas ngjarjes filloi të kritikohej në mënyrë moralizuese, duke u rikujtuar njerëzve se të gjithë ishin mëkatarë, ashtu si gurëhedhësit e Madalenës. Po të tjerëve, më të egërve? U erdhi turp? E kuptuan që e kishin tepruar? U kujtuan që ishin dhe njerëz? Nuk e besoj. Kam njohur mizorinë pa kufi tek ta. Me një llogari të thjeshtë e kuptuan që masa u kalua, që çdo gjë e tepruar e që kalon masën humbet vlerën, nuk ka më kuptim. Në fund të fundit më kishin dërrmuar, asgjësuar. Kuptuan gjithashtu se gazetatat nuk mund të shiteshin më me këtë dhe që veç të tjerash duhet t'i riktheheshin sërish politikës dhe ngjarjeve të mëdha të saj. (A thua do të vijë ndonjëherë koha, kur t'ju vijë turp a t'i vrasë ndopak ndëgjegja për atë që bënë. Bah! Edhe kujt!)

Por gjithësesi kaq. Kryetari i madh kish dhënë urdhër. Stop me kaq. Komanda supreme e kishte mbaruar operacionin. (Vazhdoi edhe ca vetëm një gazetë e varur nga një krah më i vogël i opozitës dhe një gazetë me një pronar biznesmen, që më urrente e më sulmonte në faqet e saj prej vitesh, s' di se pse, ndoshta thjesht se "sikur i haja bukën").

Pati veç këtyre tek-tuk, si përjashtim nga rregulli, edhe të pangopur në mizori. Një gazetare nga përtej oqeanit, e papunësuar atje, në mungesë, por me mendje e zemër në bëmat e atdheut u trondit: "Çështë kjo mbojtje për Pangon. Të vazhdojë linçimi!", tha. Brenda emrit të saj Mimoza Dervishi, çuditërisht përfshiheshin të gjitha gërmat e fjalës "mizori". Është thjesht një koincidencë.

Dhe finalja. Nuk u mjaftua vetëm me këtë shkatërrim të krejt jetës time, por filloi edhe mbledhja e provave, për një akt kriminal, në të vërtetë mosakt, mosveprim të një njeriu me imunitet në shtëpi të vet. Për një provokim të papranueshëm në çdo vend në botë. U gjet dhe neni. Korrupsion aktiv?! Për ta ligjëruar u kërkuan edhe precedentë. Një jurist opozitar i saktësoi këto në media. Zotëri "jurist"! E gjithë jeta e jonë fillon nga një joshje, nga një akt provokativ, nga një mëkat i provokuar. Kjo është historia e njerëzimit. Prandaj, ligjet, juristët më të mënçur se ty në Strasburg, në Europë e kudo në botën e qytetëruar, madje edhe në atë më të egrën në ca raste, nuk llogarisin provokimin si provë, as provokatorin si dëshmitar, e as atë çka rrjedh nga vepra e tyre e poshtër si krim. Përkundrazi krimi janë vetë ata, ata që gatuajnë provokimin e përgjimin e paligjshëm ,aq më shumë në rastin e njeriut me imunitet. Por etja për ta fundosur varrosur, një njeri përfundimisht nuk ka të shuar tek ju. Ky po që është akt i paprecedent në botë. Historik.

Nuk mjaftonte dënimi më i madh e i padrejtë që mund t'i jepej një njeriu. Linçimi më i paparë në demokraci. A kishte dënim më të madh se ky? Dënim që nuk ishte parë kërkund në Evropë në kohërat moderne. Madje edhe në raste shkeljesh të vërteta, në Itali në një emision të cilin imitojnë mediatikët tanë, p.sh edhe fytyra e njeriut të thjeshtë në ekran, mbulohej për t'i ruajtur

dinjitetin personalitetin, zëri i ndryshohej. Kurse këtu, barbarisht, egërsisht, gjithçka jo vetëm e zbuluar, por e stërmadhuar, e destinuar për pushkatim moral, publik. Ku kishte ku të shkonte më tepër se kaq?! Më tepër se kjo damkosje, se sa ky ekzekutim publik?

Sa kohë kishte që ishte organizuar ky krim mediatiko-politik. Prej kohësh. Madje më thuhej, dhjetra herë, që do të më hiqnin nga posti i ministrit (pse vallë kur puna ecte mirë?!). Shumë të tjerë më thoshin që nuk e mbaroj mandatin. Disa media po ashtu. Ato media që 10 ditë e më shumë pas ngjarjes nuk lejuan pothuaj asnjë mendim alternativ pro meje, veç sharje e sulme e shpifje pa fund. E rastit ishte kjo? Çdo gjë si me sustë?!

Madje edhe botës, mediave e agjensive të lajmeve të huaja menjëherë ju dërgua lajmi “se u kap në flagrancë ministri i kulturës duke kërkuar seks në këmbim të punës” Po ç’seks është kërkuar? Dhe ku vallë? Në zyrë? Në një mjedis zyrtar? Apo i provokuar? Duke i dërguar një vajzë të xhveshur në shtëpi natën. E paparë në botë. Kjo nuk ju tha askujt.

E megjithatë kjo ishte një “fitore e madhe” e medias, e politikës, e analistëve, e moralistëve, e politikës. Duhet tu thosha: Urime. Në emër të të gjithë viktimave.. T’ju uroja të gjithëve fitoren e madhe.

Urime për krimin më të madh mediatik në këta 20 vjet.. Për këtë barbari të paparë, për këtë raprezalje të pamëshirshme kundër një njeriu, për

këtë mungesë civilizimi e primitivizëm ekstrem. Të gjithë ne, sidomos njerëzit e politikës e të medias, kemi polemizuar, debatuar, sulmuar njeri tjetrin në media e në foltore.. Por kurrë kështu, të gjithë kundër një njeriu, pa prerë, ditë rrjesht, me një trysni e urrejtje të paparë. Kjo nuk ndodhi se kisha shumë armiq. Çdokush ka të tillë. Ata, “armiqtë”, ishin kryesisht analistë, media të përbindshme komanduar nga njerëz pa skrupull, politikanë. Njerëz me urrejtje personale. Gjithsesi ata nuk përfaqësonin njerëzit në masën e tyre të madhe që më shkruan e më mbështetën më vonë, sidomos në momentet e mia më të vështira.(kjo më ka ngushëlluar e mbajtur deri diku)

Këta “armiqtë” ishin ata që më treguan se sa burracakë janë, që pritën këtë ditë për të sulmuar bashkë, për të shitur moralin e tyre fals, për të goditur një njeri të shkatërruar nga dhimbja.

Ky është një dënim mizor që nuk e njeh asnjë kod penal, asnjë prokurori a gjykatë në botë sot. Ky është ekzekutimi, rrënimi, vrasja e personalitetit, imazhit, familjes, psikologjisë, gjithë punës e jetës së ngritur me mund të njeriut, një dënim mesjetar i tipit damkosje me hekur të skuqur. Ky është një dënim që e kthen vendin tënd, rrugën, lagjen ku banon, çdo vend që shkon në një burg të madh për të dënuarin kësisoj. Por burgu më i rëndë është brenda shpirtit, vetes tënde. Dhe së këtejmi deri në vdekje ka veç një prag, të vogël fare. Sa e sa miq më kanë thënë se

do të kishin vdekur të kishin qenë në vendin tim. Dhe kanë të drejtë. Pasoja të tilla nga shembujt e ngjashëm dihen, i përmenda më sipër: Është vrarë vajza vlonjate që u përdor si kavje për të denigruar oficerët e policisë, ka vdekur profesori i provokuar nga një tjetër vajzë provokatore, është vetvlarë një pedagog tjetër. Të gjithë këta janë provokuar, pastaj janë publikuar në media me fytyrëzbuluar dhe pas kësaj janë zhdukur. Janë vrarë ose kanë vdekur. E si mund të jetonin më. Pra ky është dënimi me vdekje. Duke kujtuar gjithshka u ka ndodhur më pas parardhësve të mi që kanë pësuar të njëjtin fat, ky dënimi pra, kjo damkosje e përdhunim i njeriut para syve të të gjithë njerëzve, është e barabartë me dënimin me vdekje..E paligjërues në asnjë kod penal në botë. Por këtu në Shqipëri është reale. Ka ndodhur e vazhdon të ndodhë. Kjo është makabre.

Po unë si po jetoj? Duhet të ishit brenda meje. Uroj mos ta provoni kurrë dhe unë të jem i fundit që pësoj këtë dënimi të tmerrshëm mesjetar.

Ky është çnderimi i emrit të një intelektualit, i jetës së tij, i familjes së tij, ky është ekzekutimi e shkuar ekzekutimit, pa u prononcuar asnjë gjykatë a organ drejtësie më parë.

Ky është një krim që desh çoi në vdekje nënën time(do më kish mbetur peng edhe kjo). Ky është një dënimi që më traumatizoi djalin. Ky është një shkatërrim që më ka marrë kushedi sa vite jetë, traumë e llahtarshme që nuk ka zot ta shlyejë. Kjo është vrasja e jetës. Helmimi i saj. Pas kësaj është

vetëm vdekja, madje kjo ja kalon vdekjes që të shpëton në sekondë. Kush i shlyen të gjitha këto? Kush ma shpagan dënimin e pamërituar që më dhatë, paradënimin, që vazhdon e do të vazhdojë nuk e di deri kur?

A e dini ç' plagë kini hapur? A e dini ç' gropë në zemër kini çarë? Kjo është një plagë që nuk zë dot kore kurrë. Kjo është një plagë që edhe njeriu më i fortë nuk e përthan dot. A e dini pse? Jo vetëm se është e madhe e nuk ka zot e melhem ta përthajë. Por edhe sikur të kishte: *Kjo është një plagë që i hiqet korja çdo ditë.* Ky është një kancer që më grryen çdo ditë. Çdo ditë ajo gërryhet, çirret, rrjedh përsëri gjak nga njerëzit, për shkak të njerëzve. Njerëzit kthejnë kokën e të shohin, njerëzit flasin, disa kënaqen. Kjo varet nga niveli. Ka mjaft që të përshëndesin e të takojnë, të ngushëllojnë. Ka që flasin të indinjuar kundër kësaj poshtërsie. Po ç' rëndësi ka se ka edhe të mirë e se të ligjtë janë o nivel i ulët o hakmarrës. Plaga kullon. Ajo nuk ngushëllohet se dora që e gërryen është e injorantit e të ligut. Ajo gërryhet, i hiqet korja. Sa e sa herë në ditë, në javë, në muaj ndodh kjo. Shembujt janë pa fund. Ja, djalit të kushëririt tim në klasë të tretë fillore, mësuesja i thotë të heqë bluzën sportive ku në kurriz ka shkruar mbiemri Pango. Është turp ky mbiemër. Paçka se ai që e "turpëroi" ka shkruar sa e libra e ka bërë sa e sa vepra të mira për shqiptarët. Një nëpunëse i thotë një farefisi me mbiemrin tim, "aha ju Pangot, kështu jini". Edhe fëmijët e panë e e komentuan



“superngjarjen” sipas mendjes së tyre. Natyrisht. Emisioni është dhënë madje në orën 8 dhe e kanë parë edhe ata. E si mund të mendojnë fëmijët me aq sa kuptojnë. Emision me seks gjoja. Ç’faj kanë ata që të shohin e të të quajnë mostër, kur TV më i famshëm në vend të quan kështu e të dënon me vdekje publike? E ka thënë televizori. Kështu u është servitur.

Asnjë kod etike. Vetëm dhunë, dhunë mediatike e paparë, goditje mizore, e pamëshirshme. Kjo është e përbindshme. A e kuptoni ç’është bërë? Nuk kanë ndodhur as në diktaturë të tilla ngjarje. Ndofta për afërsisht në diktaturë, kur të dënonte gazeta e partisë, ZP. Atëherë e lexonin të gjithë dhe pas kësaj kishe marrë fund. Po edhe atëherë ishte disi më mirë. Së paku në mjaft raste nuk të njihnin fytyrën. Shkoje në djall e harroheshe.

Megjithatë kur të dal përpara jush unë nuk do ju drejtohem më juve o media, dhe atyre që fshihen pas jush, se ju më vratë. Nëpërmjet filtrit tuaj të bërë pis unë do u drejtohem njerëzve: “O njerëz duhet të shpëtojmë nga kjo. Sa më shpejt. A e përfytyroni po t’ju ndodhte juve kjo? U sakrifikova unë, por kurrë nuk duhet të ndodhin më makabritete të tilla”. Shoqëria jonë vazhdon të ecë mbi male të tilla viktimash .

Thuhet se ata janë trembur disi pasi e bënë gjëmën. Janë konsultuar dhe me juristë. Disa u thanë pas kësaj atyre, se e kanë shkelur, me të dyja këmbët. “Mu në zemër, me të dyja shkelmat mu në zemër”, do tu thosha unë. Sikur të kisha bërë

krimin më të përbindshëm,(që nuk bëra asgjë) së paku do të kisha të drejtën të prisja hetimin, gjykimin, deri *ekzekutimin* nga drejtësia, pa më ngarë njeri tjetër, pa më treguar me gisht, pa më paradënuar. Ekzekutim me bujë, me urrejtje, me ligësi. Por sërish disa juristë i qetësojnë e u thonë se janë “në rregull”. Dhe ata vazhdojnë pinë, qeshin, gëzojnë, dekorohen. Ndërkohë kanë shkatërruar një njeri, një familje. Sa e sa të tjera. A e kuptoni sa prapa jemi akoma me njerëz të tillë në mizorinë e primitivizmin më të egër. Mos harroni: jemi një shoqëri që pretendon të bëhet europiane.

Por nuk mund të veprohej ndryshe. Media lubi, dora politike që e drejton, kërkonte mish njeriu. Mish të zgjedhur. A nuk e keni dëgjuar këto katër vjet sa shpesh e kërkon këtë? Si pyesin:

“Po ministra keni dënuar? Po deputetë? Ku janë dënimet? Burgimet?”

Dhe me median nuk bëhet shaka.

Kështu pra, për t’u kthyer pas tek ai moment, kur fillova të marr disa veten; teksa ndjeja që po mbulohesha nga të katër anët me shpejtësi me llum, i trullosur e i shokuar, pa dyshim pata momente kur edhe mendova se jeta kaq ishte...

Derisa zoti më dha forcë që të nesërmen, natën që pasoi dola në emisionin e TV Klan. Njerëzit filluan të kuptojnë. Pata mjaft telefonata, SMS, një pjesë ishin të prekur jashtë mase. Pastaj dola sërish në News 24 dhe pati sërish mjaft ndryshim në qëndrime. Shumë njerëz nga zona elektorale më telefonuan,

me të tjerë u ula e piva kafe. Në shtëpi më vjen me tufë me lule, një vajzë e mrekullueshme, studente kryeqytetase, nga një familje e njohur intelektuale. Edhe ajo dikur në *Kafazin e Artë*, me provokatoren, por ndryshe nga ajo, më vjen pa asnjë interes të më shprehë simpatinë e mbështetjen dhe keqardhjen, por dhe neverinë për baltën e gatuar. Nuk ja harroj dot. Asaj e shumë të tjerëve. Ndërkohë që përballë tyre më shfaqet shoqja e saj, vajzë e thjeshtë e naive dikur, nga një fshat i Burrelit, e përkrahur dhe e ndihmuar nga unë vite më parë. Më shfaqet nëna e saj fshatare, që më përqafton. Dhe pikërisht kjo më bën pabesinë. Nuk di si ta quaj. Zoti e faltë! Tirana është e bukur. Vajza do ta jetojë jetën dhe shitet. Zoti e faltë!

Më vonë miq të tjerë. Tufë me lule për ditëlindje nga grup nëpunësish të ministrisë. Një letër e mrekullueshme dhe lule nga mjekja qytetare e humane, nëna e asistentes sime të mrekullueshme me të cilën punuam si gjermanë dy vjet. Hektori e Ardiani, at' e bir artistë, më dërgojnë në shenjë simpatie e mbështetje, një pikturë që paraqiste gjendjen time shpirtërore, sulmin barbar, mizorinë. Nga Berati kryetari i shoqatës Amantia më dërgon përshëndetjet e mbështetjen e miqve që më janë mirënjohës për atë që kam bërë për Beratin. Sa e sa të tjerë, të indinjuar nga kjo farsë e ndyrë më telefonojnë, më dërgojnë SMS, më shprehin simpatinë.

Çuditërisht, në disa nga ato net të para flija dhe shihja ëndrra jo të këqija. Ëndrra me një jetë normale.

Organizmi mesa duket reagonte. Gjumi vepronte si antidot i helmeve të panumërta të ditës.

Por herë-herë edhe çohesha netëve dhe shkruaja. Pas asaj periudhe skëterre, kur më dukej se gjithë bota shqiptare ishte vënë kundër meje, veç daljeve në media ndjeva nevojën e një tjetër bisede me njerëzit, e një thirrje të shpirtit, e një sqarimi, e një mirëkuptimi me ta. Shkruaja natën. Shkruaja në mëngjes, shkruaja gjatë ditës. Gjithçka që vinte ishte llavë e nxehtë, pjellë e frustrimit. Por ky nuk ishte art. Kjo ishte dhimbje, vuajtje, e një peshe të jashtëzakonshme që nuk mund ta mbante një qenie njerëzore. Shkruaja sepse pena, fjala nuk më kishin tradhtuar kurrë. Shkruaja dhe vazhdoj të shkruaj:

**Të nderuar shqiptarë!** Më lejoni të qetësoj opinionin publik dhe moralin e trazuar prej kësaj ngjarjeje. Më lejoni t'ju kujtoj këtu se as kam dalë kurrë nudo, madje as në shtëpi e jo më në mjedise publike ( i kujtoj një gazete që më kish ekspozuar me rrobabanjo në faqe të parë për të më nxjerrë sa më porno, se ajo pozë është e marrë në Himarë, në plazh, në kulmin e sezonit më të mirë që kish pasur deri atëherë Shqipëria) e se unë as jam zhveshur e as kam zhveshur ndonjë femër nudo në publik, në zyrë a kudo tjetër, si ca e ca. Nuk kam kërkuar, madje as menduar kërkesë për seks, në këmbim të një vendi pune. Tek unë nuk ka ardhur ndonjë vajzë e gjorë për të kërkuar punë e i është kërkuar diçka në këmbim siç mundohen ta paraqesin. E kundërta

një provokatore e kurdisur ka luajtur rolin e punë kërkueses pasi ka provokuar përpara.

Më lejoni t'ju kujtoj se nuk keni parë nudo e as seks, si me ndonjë president a kryeministër të huaj, kryetar partie a parlamentar europian e sa e sa të tjerë që nuk kanë pësuar kurgjë. Nuk keni parë asgjë veç një burrë me kostum në zyrë e me tuta sportive në shtëpi (sa turp!). E pastaj veç keni dëgjuar a lexuar disa pjesë dialogjesh pa zarar, ku pjesa e tmerrit kanë qenë prekja e supozuar e disa kopsave a mbërtheckave. Dhe kaq.

Megjithatë: Të nderuar vëllezër e motra të ndershëm politikanë, analistë, bosë mediesh apo në rastin më të mirë një pjesë e tyrja! Ju kërkoi me më të madhen përgjëratë falje për atë moment rezervimi, politese e ruajtje qetsie, natën, në shtëpinë time, në intimitetin tim me një vajzë të njohur vite të shkuara, e cila për hir të moralit të tronditur diku tjetër më parë, nuk shkoi dot më tej, siç ndoshta thuhet kishte shkuar në raste të tjera! Të kërkoi falje, Filip që mbeti me aq dhe ti nuk nxore nudo as vajzën as mua, siç dikush që sot më sulmon, nxori padronin tënd!

Ju kërkoi falje dhe ju, o qindra mijëra djem të rinj e meshkuj të fortë, që me SMS tuaja e bisedat e lira shprehnit indinjatën që nuk vazhdova e nuk konsumova aktin karshi provokatores gjysmë të zhveshur, duke fyer kështu në gen cipën mashkullore shqiptare. Ju kuptoj miqtë e mi. Sa e sa ma kanë thënë këtë gjë, por unë e thashë edhe në xhirimin e fshehtë: "Nuk jam nga ata!".

Ju betohem, siç e thashë dhe në fillim se që kur jam ndjerë për herë të parë mashkull e deri më sot nuk kam menduar e jo më mundur kurrë të bëj gjëra të tilla me forcë a dhunë, siç edhe e dëshmova në rastin në fjalë (pa e ditur natyrisht që po përgjohesha), dhe gjithçka të këtij lloji, të atij lloji që e bën çdo mashkull që ia ka dhënë zoti mundësinë fizike, e kam bërë kurdoherë me ëmbëlsi e në mirëkuptim të plotë me partneren. U kërkoi falje regjisorëve të talentuar të medias më të shquar në vend dhe kësaj arritje gjigante, për t'u pasur zili të tyre, siç u shpreh një gazetar fort serioz, që as në zyrë e as në mjedisin më intim nuk kreu as dhe një molestim të vogël të denjë për sytë e etur të atyre teleshikuesve që i joshin skena të tilla. Skena do të kishte qenë tejet më e plotë. Ndonjë copë mish lakuriq, për publikun do t'i nxehte më shumë gjakrat. U kërkoi falje. Nuk munda e nuk do të mund kurrë ta bëj.

U kërkoi falje, të gjithëve ju, o të sipërpërmendur, që ashtu si në gjithë botën demokratike deshëm dhe ne të kishim një skandal seksual, të vërtetë, me seks, me zyrë, me tryezë, me nudo, me rënkim, po nuk na doli gjë. Na doli skandal seksual pa seks. Madje as skandal (ku është?) as seks. Sado që regjia ishte e shkëlqyer, titujt e gazetave më pas të mëdhenj e të zinj dhe reagimi publik i denjë për një ngjarje të madhe seksuale, për një gjëmë seksi, përdhunim e lakuriqësi të paparë, nuk u pa gjë. Të gjithë u tronditën. Patën ndjesinë si në tablotë me fruta të Gogenit, se kishin parë

diçka mjaft të turpshme. Se në ato fruta fshihej një joshje seksuale e pamatë. Se diçka e këtij lloji, tmerrësisht e turpshme, kish ndodhur. Dhe në fund nuk u pa gjë. Apo jo? Sa keq. Ç'zhgënjim. Edhe këtu nuk e kapëm dot botën. Dikush më tha se sikur cilido të xhirohej në shtëpi të tij duke i thënë fjalë dashurie gruas a të dashurës, pa le më shumë, e të transmetohej në dhjetëra medie mijëra herë, do të ishte po ajo ndjesi për teleshikuesin e për viktimën, të filmuarin. Diçka personale, e kapur pabesisht, fshehurazi, turpërisht. Gjithsesi turp. Aq turp sa ç' do kishte çdo njeri që do ta xhironin lakuriq në shtëpi të tij, në banjë a diku tjetër dhe pastaj t'ja transmetonin ta shihnin të gjithë.

U kërkoi falje njerëz të dashur, kuriozë a dashamirës të seksit, që gjithsa munda të bëja ishte të shihja një çerek jelek, që nuk u hoq, që pa u hequr, e bënte vajzën të dukej më nudo se nudo, siç do të shkruante miku im, një çerek jelek që mbeti aty ku ishte dhe u përcoll me nderime së bashku me vajzën provokatore. Një çerek jelek i famshëm, tashmë që do të shitej në ankand me miliona e do ta kish rritur fuqishëm biznesin e jeleqeve me mbërthecka, nëse ngjarja do të kish ndodhur në Amerikë. Çerek jeleku i moralit shqiptar. Vetëm kaq pra, i nderuar publik, vetëm kaq munda të bëj dhe disa fjalë që sipas sajuesve të skenarit, nënkuptonin diçka, ah diçka.

Pak mish, pak seks? Vaj medet. Jo. Kaq. Vetëm kaq.

Të kërkoi falje edhe ty, o ish kolegu im katundar-profesor a titullar më i lartë akademik, që prej

vitesh sa herë sheh një femër lëngëzon e vuan, që s'e ngope që s'e ngope një herë nënbarkun me... Oh, sa u indinjove dhe ti! "As profesor të mos jetë më", the. Si ka mundësi miku im!? Edhe ti nuk pe gjë. As edhe një copë mish? As edhe një çikëz.. E kjo pa tjetër të zhgënjeu. Të kërkoj falje edhe ty, o ish kolegu im profesor masturbator, që gjithë jetën re erë, atë erë që nuk lahet dot, atë erë të njeriut që vazhdimisht vuan për atë punë, atë erë që jot shoqe me aq përkushtim ta mbulon me parfum të lirë.

Ju kërkoj falje dhe juve, ishkollegë! Asaj pjese që në rastin më të mirë nuk u vu e nuk do të ketë fatin të vihet kurrë përpara kësaj sprove, se jeni familjarë të ndershëm e të devotshëm e me njerëz në shtëpi. Edhe ty, kolegu im që me nëpunësen brendh rrugët e botës të kërkoj falje. Kurrë nuk do të arrij të bëj atë që bën ti.

Falje u kërkoj edhe atyre që do e kenë nxjerrë ndonjë copë mish, nga ai që tha Armë Miri, (pjesëtari modest i ekipit të lavdishëm të skenarit të madh antiPango), por sigurisht hoteleve e moteleve të Shqipërisë, a të botës. Por veç kujdes. Se dhe aty hyn topi. Ku nuk hyn topi miq. Ku hyn topi , nuk hyn as ShIK-u, as prokuroria. Ai brendh botën. Ai është pushteti sot. Kamera e topit dhe pabesia e "mikut". Ruajuni dinakërisë e mizorisë së tyre!

Të kërkoj falje edhe ty, o gjysh politikan, që aq shumë i doje femrat derisa u plake dhe së fundmi nuk e blije dot mishin as në dyqanin tënd më e jo më në atë të komshiut a të zarzavateve.



Sa u mërzite dhe ti, o gjysh! Sa më shave. Edhe mandatin the, të ma hiqnin. Të kish marrë malli, të kuptoj. Malli për rininë, burrërinë tënde të shkuar. Andaj godite rëndë miku im i vjetër. Vetëm sot e kuptuan shqiptarët sa i moralshëm paskërke qenë në 70 e kusur vjet. Nuk di a do kishe bërë diçka me këmbë e duar të dridhura, po të të kish hyrë dikush si ajo brenda në shtëpi. Natyrisht të ishe dhe vetëm. Të kishe dhe fuqi, kuptohet.

Edhe ty, o paraardhës i lavdishëm, që aq shpesh shtroje e gatuaje mish në orgji ministrore, të kërkoj falje. Të kërkoj falje që nuk munda kurrë të bëja ato që bëje ti. Ti ishe aq i hapur, të shihnin të gjithë, nuk kish nevojë për kamera. Sa u mërzit ishmikja jote kur nuk i kërkoja gjë. As edhe një gjë. U indinjua e doli në gazetë e shkroi, d.m.th. shau. E si mund të mos shante kur kalonte aq mirë dikur e tani askush nuk kujtohej për të. Analisti i përkorë Endrju, në 1990, mbrojtës i bustit të Enverit, e i shndrruar tebdil në prift të të majtës në demokraci, ndonëse nuk gjeti asnjë fakt molestimi a provokimi në atë shkrim, e argumentoi si provë të fortë në një dalje publike. “Derisa diçka shkruhet në gazetë”, tha ai, “nuk ka si të mos jetë e vërtetë. Ajo shkoi jashtë shtetit, dhe pastaj pas një muaji...u pushua nga puna. A ka fakt më të madh se ky?”.

Së fundmi kjo vajzë, i nderuar analist, ka botuar dhe një libër ku unë shfaqem nevrrik, i egër, nuk e shoh në sy e të tjera si këto. Pastaj del një lidhje e çuditshme që pas një udhëtimiti në Londër, për një

panair turizmi , ku vajzës, siç pohon vetë, nuk i doli gjumi për të ardhur në panair, disa kohë më vonë u pushua nga puna. Vajza nuk përmend vetëm një gjë të vogël, që kishte rezultuar me shkelje të rëndë nga kontrolli i shtetit, që nuk bënte asnjë punë në ministri dhe që edhe mundësia për të punuar që ju dha në Londër u kthye në dëshmi të neglizhencës së saj. Nuk rezulton në librin e vajzës t'i ketë rënë njeri në qafë. Atëhere përse duhej shkruar? Bjeri t'i biem. Edhe kot. U rrëzua ministri, jep dhe ti një dorë vajzë e mirë. Bëhu pjesë e linçimit. Ndonëse kërkush nuk të pa as me sy. Por ndofta ky ishte gabimi? Më raftë pika që nuk të vlerësova moj mikja e paraardhësit. Së paku të të kisha bërë një kompliment. As në pub nuk të ftova se nuk kam shkuar kurrë e siç e pohon edhe vetë, të ftuan të tjerët, por unë u thashë ikni flini gjumë. Meqë ra fjala: Po si nuk shkova një herë në një party me kolektivin e Ministrisë, xhanëm?! Sa e sa herë më ftuan. Në asnjë dëfrim a aheng. Pyetini. Mendoja, “Nuk vete kjo, ministri duhet të mbajë distancë”.

Të kërkoj falje edhe ty, o gazetar i ndritur që me aq admirim vlerësove performancën e kolegëve të tu gazetarë topistë. Si nuk ua dhashë juve atë shans?! Sa inat ju erdhi! Ishit gazeta e parë në treg për “lëvdata” karshi meje. Edhe metrat katrore të shtëpisë sime e të njerëzve të mi i dhatë në dritë të diellit. Edhe krevatin, kuzhinën, WC...!

Por dhe ju i dhatë vetes një zotim. Ne do ta fusim kamerën me gjithë gazetare atje ku nuk e

ka futur njeri. Mu atje ku,... mu atje ku...ku nuk thuhet.

Oh, të kërkoj falje edhe ty i përndershmi flokëbardhi Dogsboru, koleg i nderuar që aq “miqësisht” më shave në emision. Të kërkoj falje e më vjen turp përpara flokëve të tu të bardhë, që kurrë nuk u nxinë nga turpi, as nga mosha. A të kujtohet në vendin balltik miku im, tek i pyesje prostitutat rrugës: “How much? How much?” (Sa?). Ishte pak shtrenjtë apo lirë? Si të dukej ty, se ne që të shihnim tu afroheshe, nuk pamë ç’bëre më vonë. Koleg, mik, deputet e kryetar që aq me ledhatim më fërkoje kurrizin kur të plotësoja dëshirat kulturore.

Falje. Falje të kërkoj edhe ty, ish kolegu im që ia more gruan tjetrit e ty ishkollegja ime që i merr burrin tjetrës, e ty, o i madh i gazetarisë që shkon me ishkollegen në zyrë të saj. Të gjithëve u kërkoj falje. Hë njerëz? A i gjeni dot kush janë? Jini kuriozë? Do të zhbiriloni. Do të zhbiriloni, siç bënë ata duke pyetur tek televizioni i Fiksit “kush, kush do dalë sonte?”, ditën kur gjëma e madhe “seksuale” pritej të ndodhte. Jo, mos u mendoj kot. Kurrë nuk kini për t’i gjetur. Dhe e dini pse. Se janë shumë. Se do i ngatërronit me njeri-tjetrin.

Falje dhe ty zonjë vulgare që të vjen turp të më takosh, siç thua. Unë them se ju vjen turp nga vetja jo nga unë. U vjen turp nga pislleku juaj, nga diçka që seicili prej jush fsheh. Këtë e tha tamam Mesila, në një emision. “Të gjithë kini

diçka për të fshehur.” Ndërkohë mua më nxorrët në shesh një hiç, një budallallëk, një mosveprim pas një provokimi e përgjimi ilegjitim. Një foto e një dialog për të qeshur. Megjithatë kjo quhet “kapje”. Duhet të “kapej “dikush, qoftë edhe kot, që të “pastroheshit” ju, që të ulërinut, të nxirnit të fshehtë e frustruar. Uroj të jini çliruar disi. Veç ruajuni mos ju kapin në adulter në të ardhmen. Kujdes. Imoral a imorale është ai a ajo që kapet, qoftë edhe kot, jo ata që bëjnë a zhyten në imoralitet çdo ditë.

Lavdi adulterit, seksit të pakapur!

Falje ju kërkoj dhe juve, o të lëngëzuar që, sa herë më vinit në fakultet, vite më parë, a në ministri më vonë, mahnitëshit e më thoshit. “Ah, sa i madh je! Si bën ti këtu me gjithë këto femra”?! Nuk e di se përse një staf me 80% femra që ka bërë nën drejtimin tim sa e sa punë të mëdha e të dukshme për të mirën publike, ngatërrohej me diçka tjetër? Puna juaj. Koncepti juaj. Puna ime me to ishte puna e shtetit. Se vetëm nuk do t’i kisha bërë gjithë ato punë të mëdha, investime, ligje, projekte që bëra. Dhe unë që përpiquesha t’u sqaroja se unë punës i them punë e unë kurrë nuk e ngatërroja atë, me “atë punë”. Sa habitesha kur më thoshit: “Leri, leri këto po hidhna ndonjë ne kur të të mërzhiten!”. A thua se ishin skllavet e mia! A thua kaq keq ishit në zyrat tuaja? Të shkretët nëpunës të lartë a të mesëm a të vegjël! Nuk e harroj njërin syresh, një gjoja njeri të problemeve sociale, tek dilte në ekrane e më akuzonte si

kriminel. Pasi më vodhe votat në 2005, ç'pate më tej o zotëri komunist Fytyrë-vrima?

Askush nuk të ngau. Askush nuk të hoqi nga puna ty e tët bir pas 2005. Ndonëse villje e shaje në gazeta. Të kuptoj dhe ty. Flet vetë portreti yt i frustruar miku im, flet vetë... Edhe ti doje të shihje diçka në atë skenë "seksi". Prisje më shumë. Ke vuajtur dhe ti o i gjorë. Ke vuajtur shumë..

Ah, të kisha qenë i martuar të shkretën Do të kisha bërë gjithë ato gjëra e nuk do më kapte kamera e Filipit! Ah, po, të kisha qenë kryetar si ai tjetri, djallin, e të kisha rrahur femra e t'i kisha lënë jashtë si qeni, e pa të isha zhveshur vetë bashkë me të, a pa të kisha dalë nudo në publik! Atëherë po, do të meritoja gjithë atë vrer e rrebesh e do i thosha vetes me gjithë shpirt: "Tani shko në djall, vetë e bëre!" Por jo. Nuk i bëra këto e u godita sikur t'i kisha bërë të gjitha. Ah, ja që nuk isha e nuk i bëra e nuk i bëj dot të gjitha këto për kënaqësinë e zhgënjimin tuaj miqtë e mi.

Ju kërktoj falje edhe ju, zonja X, zonja Y, zonja Z, (nuk po ju përmend me numra se mos lindë ndonjë keqkuptim). Edhe ty o prof. Katundari (Qelibari), ty o Erion-Lej Fen i ri, ty o i forti i Politikës, e shumë të tjerëve. Por veçanërisht ty e ekipit Filip. Sidomos juve se ju jini tani motivi i jetës sime.

Oh, miqtë e mi! Unë nuk jam asgjë para jush! Unë nuk jam as sa çereku i çerekut të bëmës suaj! Unë jam shumë-shumë i lidhur me një histori çerek jeleku. Besomëni! Bash për këtë do i kisha

kërkuar Kryeministrit të më kish vënë përsëri aty ku isha pranë jush, qoftë edhe për pak ditë për eksperiment, tu tregoja ca gjëra, të mbuloja pak nga mishi juaj, nga mishi i mishit tuaj. Se me sa u duk nga kamera e fshehtë e Filipit, unë dola më i aftë të mos lejoj lakuriqësinë, se sa ta zbuloj atë krejt si sa e sa nga ju.

*“Eh, lëri ato!”, do më thotë dikush. “E dimë që tërë jetën je marrë me femra!” “Plastë ai që nuk i do femrat!” Por varet se për çfarë. I kam dashur dhe do t’i dua. Jo si ju, me hile miq. I kam dashur e respektuar si bashkëpunëtore. I kam dashur e do t’i dua për bukurinë që i japin jetës. Kur më kanë dashur e i kam dashur si femra, jashtë çdo lloj abuzimi, pa dyshim që më kanë zbukuruar jetën. Dhe kjo kurrë nuk ka pasur të bëjë me kamera tinëzare e provokime, as me sajime. As me zyra e skandale seksi në to. Por kurrë nuk i kam shfrytëzuar, as kam abuzuar, as i kam keqtrajtuar. Këtë kini dashur të ngatërroni ju?!*

**Të nderuar bashkëkombës!** Pas dy javësh të tmerrshme linçimi, opinionioni filloi të kthejë. Natyrisht, jo krejt. Por në një pjesë të mirë të tij, po. Pas gjëmës së madhe mediatike, gjellës së servirur me mjeshtëri, me muzikë e me përqsasje, me intrigë e prelude, pasi u shokuan e u tronditën disa ditë e net rresht, mediatikisht, artistikisht, njerëzit filluan të mendojnë: “Po sikur? Po të më vinin edhe mua në shtëpi ç’do të bëja?”

Natën e dytë të skëterrës mediatike, në një emision televiziv, e theksoj ishte vetëm nata e dytë,

kur terrori ishte ende në kulm, sondazhi nxori 40% të teleshikuesve, në favor tim. Analistët në emision nuk donin ta besonin. E gjykuan si përgjigje politike. Ç'po ndodhte? A nuk duhej dënuar ky qen nga të gjithë dhe masivisht? A nuk ishte bërë gjithçka perfekt? Harruan një gjë. Njerëzit, në një masë të madhe, janë së pari njerëz. Nuk janë as analistë, as politikanë, as pronarë mediesh. Nuk janë të lidhur me interesa dhe as të detyruar të flasin sipas urdhrave. As sipas shpërblimit a partisë politike. Njerëzit pra, së fundmi, pas gjithë asaj stuhie filluan të mendojnë, me drejtësi, në mënyrë të pavarur. Dhe kjo pas gjithë atij skenari e asaj trysnie mediatike. Dhe njerëzit s'e hanë sapunin për djathë. Pyetini. Dhe akoma më shumë pas daljeve të mia mediatike ku unë sqarova shumë gjëra. Në fund të fundit arsyetimi ishte ky: A do të ndodhte kjo po të mos ishte provokuar, natën, nga një femër gjysmë e zhveshur, kur kjo mund t'i ndodhte kujt do? Përse nuk ndodhi kurrë më parë në zyrë, pas mbi 30 vjet shërbim në administratën publike? Dhe ka edhe një përgjigje ligjore që flet për këtë. Provokatori, situata e provokuar, siç e tha dhe Lubonja, nuk llogaritej si provë as në kohën e diktaturës më të egër, jo më në demokraci!

Po nëse do të shihnit të gjithë kasetat..? Po nëse do të hetohej ndryshe..? Hetim atyre që e bënë, e inskenuan? Se ka, jo vetëm cenim të privatësisë e dhunim banese, të një njeriu të thjeshtë të themi (ndodh çdo ditë me emisioni në fjalë), provokim, përgjim të paligjshëm e vjedhje imazhi por ca

më shumë të një njeriu me imunitet. Tha dikush “u provokua”, por ajo që u bë, u bë “për hir të së mirës publike”, të mirës së përgjithshme?! Të Moralit tonë? O perëndi! Sipas kësaj le të provokojmë çdo njeri e të shohim sa i fortë është. Çelikfare, të jetë, çeliki partisë. Pos’ qeletë zhduket. Eh, ç’ më kujtuat ato kohëra, miqtë e mi! Ndonëse, siç e thashë edhe atëherë nuk shkohej deri këtu.

Në një tregim të humoristit turk Aziz Nesin, dy femra gjysmë të zhveshura, me profesion police sekrete, provokojnë burrat në mjedise publike dhe kur këta reagojnë, i arrestojnë menjëherë për prishje të moralit. Të kuptohemi. Tregimi është humoristik dhe tallet me ca metoda të qëmotshme në Turqi. Po situata humoristike është njëlloj si imja. Veç kjo imja u mor shumë seriozisht. Këtë Nesini e ka shkruar më se 60 vjet më parë në Turqi. Shihni ku jemi ne sot.

**Të dashur bashkëkombës!** Këtu kemi, siç e thashë, një njeri që ka “prekur” një cipë “moral”, që e ka lënë siç ishte menjëherë më pas dhe nga ana tjetër as ka vrrarë, as ka prerë, as ka tradhtuar grua se nuk ka, as është zhveshur nudo e as ka zhveshur nudo, as në plazh e as përpara kamerës së fshehtë. Kaq kam bërë unë. Por ndërkohë ka ndodhur diçka e madhe. Është hequr cipa, korja e një morali hipokrit, fals, servitur nga politika e media imorale, të mbrojtur nga njerëz pa moral a me moral të dyshimtë, korja e cenimit të paparë të jetës private të njeriut, e ndërhyrjes brutale



në të dhe e shkatërrimit të saj. Deri në vdekje. (Të shohim si do të vazhdojë kjo). Jemi kthyer kështu prej kohësh pa e kuptuar në një regjim mediatik mizor, në një sistem pushteti mediatik, perandorie mediatike, deri terrori diktature mediatike? Media dhe dora politike kriminale që e drejton të bën puçin, ajo të bën gjyqin, ajo të merr edhe jetën a të dënon me vdekje. Ajo merr edhe pushtetin. Ajo është kthyer si media unike e një sistemi unipartiak dalja në të cilën në vitet e diktaturës ishte ekzekutim politik. Të shohim deri ku do të vejë kjo media. Gjithçka të kujton kohën e sigurimit e të përgjimeve, provokimeve, arrestimeve për një fjalë goje. Njeriu me të drejtë duhet të ketë frikë edhe në shtëpinë e vet.

Një gazetë shkruante pas ngjarjes time se kishte rënë seksi në Bllok. Qesharake. Por e vërtetë dhe njëkohësisht tmerruese. Njerëzit janë trembur deri në frenim të prirjes së tyre natyrale. Në një tjetër gazetë, thuhej se njerëzit kishin frikë tani t'i afroreshin femrave duke kontrolluar me sy se mos kishin ndonjë kamera të fshehur. Të tjerë shkonin atë ditë tek media nënë, media perandorake, media e lirë, media e madhe, dhe pyesin: "Kush është, kush është, kush do goditet sonte në fiks? ("Inshallah s'jam unë!"). Dhe pas kësaj një gëzim i egër, lehtësues: " O zot, shyqyr që nuk isha unë! E hëngri filani! Por unë jo ama. Ja *hudha* edhe kësaj radhe." A e kuptoni ç'po ndodh? Është skllavëruar njeriu. Është llahtaritur nga një media, nga një emision. Është terrorizuar. Nga një

terror mediatik. Nga një njeri e nga ca njerëz që “mbrojnë” moralin, por nuk njohin moralin.

**Të dashur miq!** Pas dy javë skëterre, pas asaj nate të parë, kur vetëm më shanin e më varrosnin të gjallë, pas një dite tjetër të tmerrshme, kur nuk mund të shihja gazetën, se ngjethesha, pata papritur një ndriçim. Në atë trullasje të parë ku, i shokuar siç isha, nuk po arrija të kuptoja se ku ishte e vërteta e ku sajesa, ku po ndjehesha si një kriminel i vërtetë, gjeta vetëm pak logjikë e direkt pas emisionit t’i thosha Kryeministrit që më mori në telefon, se filmimi kishte montaturë dhe heqje. Pastaj, si në një shirit filmi të kthyer mbrapsht, kam rikujtuar mjaft gjëra dhe zoti më dha forcë të dal përpara njerëzve për t’u shpjeguar, për të folur, për t’u mbrojtur, një e drejtë kjo elementare demokratike që m’u mohua nga një goditje e pabesë e goditje të tjera të panumërta mizore që më fajësonin pa më fajësuar ende drejtësia, që më penalizonin pa vepër penale, duke kryer ata vetë vepër penale.

Menjëherë pas kësaj kam pasur me mijëra SMS nga ju, të dashur miq, që flisnit ndryshe nga analistët, nga disa politikanë të përkorë, a mediet tona të lira. Nga ju që më mbështesnit. SMS që e quanin gjithçka kurth të ndyrë. Në fillim habitesha, si i kishin shkruar ata këto? Pas gjithë atij rrebeshi, ku ishte morali këtu? “Ore, vërtet si shkruajnë këta kështu?”, pyesja në fillim, pas tërë asaj stuhie mediatike, pas gjithë atij linçimi?

E kishte një shpjegim. Gjithçka fillimisht veproi si në një hipnozë mediatike kolektive: njerëzit mund të vinin dorën në zjarr se kishin parë një film porno. Një film të tmerrshëm porno me një zyrtar të lartë. Psikologjia e njeh këtë fenomen, kur arti i mashtrimit është aq i madh sa imponon idenë e regjisë tek çdo teleshikues. Sugjestionim kolektiv i paparë. Në fakt nuk kishte pasur as seks, as kërkesë për seks në këmbim të një vendi pune, as nudizëm, por vetëm turp për ato që panë. Po ç'panë? Pe gjë ti? Po ti? Po unë, në fund të fundit? Dëgjuam, vetëm dëgjuam dhe nënkuptuam. Një dialog. Thjesht një test. Të tjerat i tha Saimiri dhe Doktor i vogël. Muzika, kënga e Cocker-it, regjia, Ndrek Luca i ndjerë, ca buzë, këngë vulgare ...

Të gjitha janë ngjarje të interpretuara. Të gjitha ç'kini parë a më shumë dëgjuar, janë mbresëlënëse. Po të shihni të gjithë kasetat do të shihet që jemi përpara një montazhi të madh mediatik-artistik. Diabolik, njëherazi.

Pastaj erdhi histeria kolektive që e rëndoi më shumë gjindjen e gjendjen. Njerëzit u çoroditën. "Në turmë, savanti merr trutë e zuzarit", thotë Gustave Lebon. Dhe pa dyshim erdhi edhe rekomandimi për vetëvrasje. Happy end! Kjo do t'i vinte kapakun. Më kujtohet shpesh se pas bombës që më vunë në 2003, miqtë më thoshin: "Tani do të ishe harruar!". Kështu do të kish ndodhur edhe kësaj radhe. Do më kishin varrosur me pak njerëz, pastaj do "u vinte keq" edhe disave prej atyre që

më bënë keq(?) e do të harrohesha. Në fund të fundit, bëri pa e hëngri. Zoti e faltë. I ndjeri!

Në të vërtetë, miqtë e mi, filmi është shumë më interesant. Krejt i paparë në Shqipëri. As në botë. Një vajzë hyn natën gjysmë e zhveshur në një shtëpi ku jeton një njeri beqar. Me imunitet. Ministër. "Dhe kjo e rëndon gjendjen shumë!", mund të thotë dikush. Sigurisht, ministrat nuk janë prej mishi e gjaku, por prej çeliku e zhive. Në dejtë e tyre rrjedh çelik i shkrirë, çelik partie. Hyn pra, vajza me një çerek jeleku të markës "më nudo se nudo" dhe madje as e heq atë. Dhe pamja, besomëni, nuk do të qe hiç më nudo se me jelek. Pastaj e mban atë siç ishte dhe duket sërish më nudo se nudo. Ikën e qetë me detyrë të realizuar. Viktimë? Femër e viktimizuar? Viktima mbeti pas. Jam unë.

**Të nderuara nëna, motra, gra, vajza!** Askush nga ju nuk do të bëhej një viktimë e tillë. Viktima në fjalë u pagua, siç thonë, dy milion lekë të vjetra(ca thone nuk i mori as ato), mori një makinë dhe jeton ...E qetë? Këtë nuk e di. Viktima mbeti pas. Quhet Ylli Pango. Por nuk mund të pranohet lehtë që mashkulli është një viktimë e këtij lloji. Mashkulli mund të jetë vetëm viktimë e kamxhikut, brutalizmit, etj, jo e femrës së butë provokative.

Të nderura nëna, motra, gra, vajza. A e dini kush është pra, pasoja e rëndë morale në dëm të femrës shqiptare, pas këtij akti të pashembullt provokativ? Një femër e dyshimtë në moral (jo si ju), ka marrë 2 milion lekë shpërblim për provokimin

dhe shkatërrimin e jetës së një njeriu. Thuhet se ka blerë një makinë e bredh nëpër Tiranë a diku. Nuk ja dhashë unë. Ia dha media e madhe, mbrojtësja e moralit.

Ah, po sikur, do të thoshte dikush, po sikur të qe e ndershme, po sikur të... Historia nuk zhvillohet me *sikure* e megjithatë asgjë nuk do të kishte ndodhur sigurisht, ashtu sikurse nuk ka ndodhur me dhjetëra vajza e gra të tjera korrekte, që kanë hyrë e kanë dalë në MTKRS, kanë hyrë ose jo në punë sipas aftësive e CV të tyre, por kurrë nuk u është kërkuar gjë. Edhe drejtësia nuk vendos e nuk duhet të vendosë mbi bazë provokacionesh e sikuresh. Në të kundërt, duhet të dënojë provokatorët e jo viktimën e tyre.

Kaluan disa javë. Tani më shkruajnë nga çdo anë e Shqipërisë. Më shkruajnë shqiptarë nga Greqia e Franca, Italia e Anglia, nga Amerika e Gjermania. Lexojini në vijim, i kini. “Kurth komunist!”, shkruan njeri. “Duhej të mos e kishe lënë, ajo ishte imorale!” thotë tjetri. “Mbaje kokën lart, nuk ke bërë asgjë!”, shkruan dikush. “Mbetesh profesori ynë i nderuar!” më shkruajnë disa ish studentë. “Mbetesh ministri që ndryshoi Gjirokastrën!”, thotë drejtori i DRMK Gjirokastrë. “Je i nderuar, ke ba për Shkodrën!”, shkruan tjetri nga Shkodra. “Ata bënë, ata provokuan!”.

Ky është opiniononi i vërtetë publik që më dha zemër. Pas vulgut, hakmarrjes, shpirtvogëlsisë, prononcimeve të një pjese të politikës, filloi të flasë

qytetaria. Mesa duket ky është opinioni i vërtetë publik, nuk janë ata; veçse ca analistë e politikanë, por mendimet e sa njerëzve të thjeshtë të painteres që ndjehen të fyer nga sulmi në shtëpi i një medie prepotente. Medie që vret. *Deri tani foli imazhi i përpunuar i medieeve të paskrupulla, tani filloi të flasë qytetaria dhe, kur të zbardhet e gjithë ngjarja do të kuptohet nga të gjithë: More, çfarë bëri!?* Ku është viktima? Ajo që mori paratë? Ah, jo. Qenka morali publik! Cili? Që na u kërkua seks për t'u futur në punë? Me kë ndodhi? Në cilën situatë? Asnjëherë. Në situatën në fjalë u provokua ngacmimi seksual me pretekst kërkesën për punë. Kjo është e para. Ngasja e provokuar. Puna vjen pas. Po të kërkohej thjesht puna normalisht nuk do të ndodhte asgjë. Siç nuk ka ndodhur. Ah, por jo puna duhej kërkuar zhveshur, me përdredhje që të ndodhte patjetër diçka, që të futej njeriu në grackë. Kjo bëhet sikur nuk kuptohet.

Nëpër lokale, në kafene, në shtëpira, në qytet e fshat, pas ditës së dytë plasi debati: Kishte a s'kishte faj ministri? Po Filipi? Po vajza? U ndanë njerëzit në dy ekipe. Të thjeshtët nga njeri krah dhe skuadra analitiko-politiko-mediatike nga tjetra. Kjo e para më merrte në tel e më çonte SMS. E dyta i nxiu mediet. Anatema, gëlbazë, llum të zi. Vetëm e nxitur? Apo edhe nga vetja? Unë mendoj se ishte një veprim jo vetëm koshient, politik e hakmarrës individual në disa raste. Por edhe një akt subkoshience për të nxjerrë nga vetja llumin, dhimbjen, pisllekun. Ishin një grup i tërë i tillë. Një grup që i njoh mirë.

Që edhe u tremb se mos ju nxirrja të palarat. Por që ju premtova se nuk do e bëj kurrë se kurrë nuk më kanë interesuar punët e të tjerëve e nuk jam marrë me to.

Jo nuk do merrem me bëmat tuaja, edhe sepse ndryshe nga disa prej jush, unë “u kapa”, “u dënova” jo se bëra gjë (ca thonë pse nuk bëre). Në fakt u kapa e u dënova duke mos bërë gjë. Një grup që nëpërmjet meje po kërkonte të pastrohej. A thua po vetëpastrohej?

**Hej, bashkëkombës të nderuar!** A bëjmë një sondazh që Blendi nuk e bëri? Natyrisht, sondazh anonim e sipas të gjitha rregullave. Natyrisht, për meshkuj, meshkuj që janë meshkuj apo ende meshkuj. Dhe për femra. Për femra që, siç dihet, në shumicën e tyre janë femra. Duke përjashtuar gjithashtu dhe homot dhe flokëbardhët e vjetër. (Në daç bëjeni dhe për deputetë, analistë, politikanë, veçmas, me grupe, a marrë së bashku, dy nga dy, tre nga tre, me çifte, me lule.)

Një sondazh me tre opsione.

1-Sa vetë do të kishin bëtë sa ç’bëri Ylli (Monstra) dhe asgjë më shumë në atë situatë.

2-Sa do të kishin bërë më shumë?

3-Sa më pak?

Tani që u qetësua gjaku i trazuar, gjaku moral, bëni dhe një sondazh tjetër, Kush ka faj Ylli apo Top Kanali? (Unë di diçka nga kjo, ma kanë treguar disa SMS meshkujsh... Lexojini më poshtë)

Unë mendoj se ky sondazh ka mjaft vlerë për të kuptuar moralin shqiptar. Nuk kam shkruar kot që në krye “ një ese për moralin shqiptar” .

Po unë mendoj se kur të më kujtojnë më vonë për ndonjë punë të mirë, por edhe për këtë “ të keqen” do të thonë.(madje po e thonë që tani) “More, po a u zhvesh ai atëherë apo jo? Po ajo? Jo?!! Po ç’bënë? Asgjë. Ai i tha asaj, nuk jam nga ata, ( nga ata që të bëjnë diçka me zor). Po ku qenka skandali këtu?! Ndofta më shumë se një mësim morali, morali i kësaj fabule do të ishte: “Vajza, ju mund të shkoni natën zhveshur në shtëpinë e një mashkulli dhe të dilni pa lagur. Të paktën për shtëpinë e Ylli Pangos ju japim garanci. U provua në kushte ideale. Po për ndonjë aksion tjetër organizuar nga *Fiksi* nuk japim garanci” .

Kush është më i rrezikshëm pra, *media* që mund të të shpjerë vajzat, larg qoftë, edhe në kthetrat e ndonjë maniaku a tipi të fortë, apo Ylli që të pret e përcjell duke u bërë shkas që të fitosh edhe dy milion lekë. Kush është viktima? Gjykoni!

“Imoralitet, gërthasin kritikët me zëra të friktë” (Kadare). “Krim i pastër” thotë në ekranet e TV Gëzimi me fytyrë të papastër, me konflikt të pastër interesi (djali i është pushuar nga puna).

*Shshshtt, moralist!*

*E di që po ulërin me të madhe “nuk ka rëndësi seksi, mishi, por gjesti, gjesti, ishe ministër”.*

*“Shsht,” të thashë. “Pa pyete veten: Çfarë do të bëje ti në një natë të ftohtë dimri, në një dhomë të ngrohtë beqari me një vajzë të njohur më parë, me rroba*



*veshur-zhveshur që të fanepset dërguar s'dihet që ku? Nga ku? Nga qoftëlargu. Duke qenë jo ministër por njëshi i superfuqisë së botës madje. Pa dyshim jo atë që bëra unë. Kurrën e kurrës. Kurrë nuk do të ishte aq i aftë. "Si? S'do e bëje kurrë?"*

*"E pra, u morëm vesh. Ramë dakord. Ti nuk do të bëje dot kurrë aq. Ti do të bëje më shumë!"*

*(Në të vërtetë në një masë dërrmuese, ndër ata që ulëritën më shumë, më "të moralshmit", ishin të pamoralshmit, ata që do të bënin ku e ku më shumë)*

Zotërinj moralistë, armiq mediokër, hakmarrës, të vegjël! Krimi është kryer ndaj meje. Unë jam viktima. Koha dhe unë do ua provojmë këtë.

**Hej, analistë e politikanë të nderuar.** A e kini harruar se në skandalin e madh të seksual të përtejdetit ka pasur edhe seks oral dhe nuk është quajtur seks? E keni harruar se ka pasur dhe zyrë dhe nëpunëse dhe konflikt interesi dhe vepër të turpshme dhe nuk është llogaritur si e tillë? Në Angli ngjarja ka pasur Parlament. Në një vend tjetër zyrë kryeministore. Ndërkohë, një gazetë e nderuar mbush prej dy javësh faqet e para me titullin e madh: Skandal seksual! Skandal seksual! Natyrisht seksual, por pa seks. Madje pa skandal. (Skandali është kjo që më bënë mua). E paparë, e padëgjuar në botë. Siç e thashë mesa duket disa më urrejnë më shumë ngaqë mungoi seksi. Mesa duket thellë në subkoshiencën e botuesit, kryeredaktorit, nuk shqitet që nuk shqitet seksi, seksi që nuk e panë, seksi që nuk e kanë parë. Ah, që nuk e panë. Ah, subkoshienca... deficiencia.

Pata, siç thashë, rekomandime nga dy botues të pastër, të ndershëm, e them pa ndroje më të pastërtit e më të ndershmit, më të bukurit e mediatikës shqiptare, që “ të vras veten”. Nga dikush u tha që kjo do të mbetet e paharruar (në mendje e në zemër, do të shtoja unë), ndaj dhe këta të dy kanë të drejtë kur më thanë. “Zhduku më mirë!”

Dikush më tha “çudia më e madhe zgjat, tre ditë” Jo. Unë besoj se kjo do zgjasë e duhet të zgjasë më shumë. Ka ndodhur me një njeri me imunitet, një deputet, një ministër. Pa le më ç’ka ndodhur e ç’mund të ndodhë në raste të tilla me njerëz të thjeshtë.

Kjo duhet pa tjetër të zgjasë e të analizohet. Pastaj të veprohet. Jo më për mua se dëmi im është I pariparueshëm. Për të tjerët. Që të shpëtojnë të tjerët. A e kuptoni më mirë tani se ç’ka bërë kjo media? Ka hyrë me kamera në shtëpinë e një ministri, ka dhënë sekuenca nga kasetat të tëra. Nesër kjo nuk stepet para asgjëje. Po ç’nesër? Ajo nuk stepet as sot. Kjo çudi duhet të zgjasë që ta marrë vesh dhe bota. Ta marrë vesh bota ç’ndodhi këtu.(se asaj ju tha ministri bëri skandal, provokoi etj. Kështu u është servirur mediave e gazetave të huaja). Ta marrë vesh bota ç’bëhet me të drejtat e njeriut. Nuk po përmend ato të njeriut të zgjedhur, të parlamentarit. Në një vend që aspiron për demokraci e liri evropiane. Ta marrë vesh si u viktimizua e u sakatua një njeri, një personalitet.

Po përse ta ketë bërë vallë Filipi? Si fillim mund të jetë historia e Piramidës. I bezdisa

shumë me kërkesat e mia për të ikur që andej. Dikush thotë se edhe turizmi e rritja e tij nuk u pa me indiferencë në Jug të Shqipërisë, përtej kufirit. Në Korfuz thuhej 'Shqipëria po na merr turistët!'.

Një arsye tjetër mund të jenë zgjedhjet që vinin, listat e kandidatëve. Ambicja e urrejtja e mediokërve për pozicionin tim e suksesin si ministër po se po. Inatet personale gjithashtu. Shikoni pra se sa të interesuar ka pasur.

Po më pas nga data e mbarimit të poshtërsisë e deri në transmetim, rreth 2-3 javë, çfarë ka ndodhur? Përse u mbajt kaq gjatë? Dikush tha se është paguar shumë që të jepet pa tjetër. Opozita po e po, se kapitali politik do që i madh. Gjithësesi koha do të zbulojë shumë gjëra.

Por ndonëse ata arritën të ngrenë peshë një histori të tërë historia po ndryshon. Dhe duhet të ndryshojë. Ndryshe, unë jam i vdekur, i mposhtur si shumë të tjerë, viktimat të medias vrastare.

Tani stuhia e medieve ka rënë dhe njerëzit kanë filluar të ftillohen, të kthjellohen. Tani jam unë që duhet të shpëtoj veten time, të tjerët që mund ta pësojnë njëloj. Ndryshe kjo media do të vazhdojë të vrasë të tjerë.

Një gazetare më pyeti se ç'do bëj pas kësaj. Nuk do jesh më në Parlament, nuk do jesh më pedagog. Një jetë e tërë, një karrierë e tërë shkatërruar nga media, nga njerëz të ulët. Në të vërtetë më është rikthyer një periudhë e kohës së diktaturës kur mbeta dy vjet pa punë. Ishte shkak dhe biografia. Në këto 20 vjet demokraci e kujtoja

shpesh atë periudhë dhe thoja me vete: “O zot shyqyr. Së paku ajo periudhë e tmershme nuk kthehet më”. A e dini që mu kthye. E ndjej veten me biografi të keqe. Pa punë. E paparashikueshme.

Megjithatë së paku me këtë që më bënë duhet të merrem. Ky është një qëllim i jetës sime, ndonëse jo i vetmi. Të zgjidh atë që pyeti gazetari në një emision televiziv. Kush ka faj? Unë apo ata që e bënë këtë gjëmë e ata që fshihen pas tyre, ata që më shkatërruan jetën...

Postterapi: Kur jeta të godet kaq rëndë, befas, të trullos, fillimisht nuk mendon veçsë vdekjen. Humbet gjithshka, njerëzit, dashurinë e tyre, punën, prestigjin. Kjo duhet kaluar. Kjo periudhë qoftë dhe e gjatë. Pastaj duhet rifilluar duke kapur qoftë edhe tek një dimension të jetës: dashurinë e njerëzve, dashurinë për njerëzit. Të tjerat vinë pas. Po a do arrijë kjo ditë? Nuk di ta them. Duhet pritur.

Gjithsesi, në një aspekt, në një hapësirë të gjerë kohore jete, edhe kjo është pjesë e jetës sime të larmishme, gjithë ngjitje e zbritje, plot vuajtje e humbje por edhe arritje. Duhet shpresuar se përsëri do ta kaloj. Besoj tek Zoti.

**Të dashur bashkatdhetarë!** U prek një jelek? Më saktë ca kopsa a mbërthecka që u bënë të famshme? Një cipë jeleku? Jo. U prek gjoja morali. Moralit iu hoq cipa. Kudo mbi dheun tonë kutërboi era e keqe. Një histeri kolektive shpërtheu. Një indinjatë e paparë. Sa shumë u shkrua e u fol. Njerëzit harruan punët e hallet e punët e përditshme e u morën aq gjatë me mua.

Në thelb ç'ndodhi: Një njeri ishte në jetën e tij, përpiqej, punonte. Një ditë të bukur iu stis një intrigë e ndyrë -U provokua -U linçua. U shkatërrua.

O perëndi! U kërkoi sërish falje të gjithëve që u dhashë tërë atë frymëzim. Nuk do ta kisha bërë kurrë. Por në fakt nuk bëra gjë, ma bënë. Tani është radha ime.

## Një fjalë të fundit kolegëve të mi parlamentarë të tashëm e vlefshme edhe për ata të ardhshëm

### **Të nderuar zotërinj deputetë!**

Kemi kaluar rreth katër vjet bashkë dhe natyrisht ju takonte juve t'ju adresohesha të parëve. Por ju takonte edhe juve të më adresoheshit disi ndryshe e të gjykonit me drejtësi si ligjvënës për atë që mu bë. Për atë që ju bë kolegut tuaj e që mund t'u ndodhte dhe juve.

Por e vonova ca edhe se prisja veç të tjerash edhe prononcimin e qëndrimin tuaj ndaj ligjit e drejtësisë. Siç e dini çështja u fillua nga prokuroria *kryesisht*. Pa padi, pa ankesa, pa viktima. Kryesisht, d.m.th jo veçanërisht, pa padi. Në përgjigje të kasetave filmike marrë nga media jashtë ligjit, të ulërimës mediatike, shpërthimit të opinionit publik, të tronditjes së tij morale, të ngjirrjes së tij, por aspak të dhunimit të banesës, të cenimit të privatësisë, të cenimit të imunitetit, filmimit të paligjshëm, shkatërrimit të imazhit, të provokimit të deputetit, ministrit qoftë edhe njeriut të thjeshtë Ylli Pango etj. Asgjë nga këto veçanërisht. Thjesht kryesisht, se na u cenua morali i përkorë publik, sidomos ai mediatik, ai analitik (i analistëve) apo

ai politik (i një pjese) apo i ca të tjerëve me mërira individuale. Media shkon çdo ditë në prokurori, pyet, investigon, sulmon. Media vendos, media vulos, media gjykon, media dënon. Përpara ligjit. Media pyet edhe pse s'e vratë. Media të dënon edhe me vdekje. Por mos harroni. Me një nen që e kemi bërë ne vetë, a kolegët paraardhës: "Media është e lirë". Vetëm kaq. Askush nuk e ka këtë privilegj, as presidenti, as qeveritari, as i zgjedhuri nga populli. Pa le më të tjerët. Gjithsesi na rroftë media e lirë dhe e pavarur.

Veç kësaj e vonova këtë adresim, jo se më vjen turp, por se kam neveri, nuk i shoh dot disa, për fat të mirë vetëm disa, që u çorrën e shanë si të ishin të moralshmit e botës, pa e fshehur që i gjithë qejfi ishte që e hëngra unë, paçka se si.

Dhe veç këtyre ju duhej lënë kohë dhe juve, si gjithë njerëzve të reflektoni. Kjo pasi analistët, mediet shkruan e folën sa e si s'kishin folur për kërkënd, kaq zi, sterrëzi. Dhe tani që gjakrat e nxehur të moralit të prekur u ftohën mendoj se e kam radhën unë gjakprishuri të dëgjohem me kujdes e gjakftohtësi.

Besoj se e kam këtë të drejtë më në fund dhe unë të flas e të dëgjohem. Të flas për të drejtën time. Për të vërtetën.

Zotërinj! Këtu nuk po ju drejtohem juve për të bërë, as të kryqëzuarin, as viktimën, a të mëshiruarin, ndonëse në shumë aspekte jam jo thjesht viktimizuar, por **linçuar**. Do të përpiqem të bëj së pari ligjvënësin, si ju dhe pastaj krijesën prej mishi e gjaku si tuaja, që u sakatua, siç rrallë

është sakatuar ndonjë njeri në këto 18 vjet në këtë vend. Që u sakatua siç mund të ishte sakatuar secili nga ju. U sakatua siç mund të sakatohej fizikisht e shpirtërisht secili prej jush, nga një media makabre dhe medie të tjera në shërbim, nga analistë dhe në një masë më të vogël, nga deputetë të cilët në shumicën e tyre, i falënderoj për qëndrimin kryesisht të ekuilibruar. Gjithsesi, më lejoni të brohoras leitmotivin e kësaj fjale adresuar juve, atë që thashë edhe më sipër: Në vendin tonë media është e lirë. Kaq. Vetëm një nen. Rroftë media e lirë dhe e gjithëfuqishme.

Po vazhdoj me një pyetje. Zotërinj! Thuhet se ka ndodhur një krim apo së paku një veprim jo i moralshëm. E kanë servirur të tillë sërish analistë e gazetarë në media. Po vallë ku është viktimi? Ajo që e ka bërë këtë edhe në raste të tjera për pagesë? Ajo që në kushte normale nuk do të pësonte asgjë, ashtu siç nuk pësoi as në këtë rast? Unë e tregova këtë me sjelljen time. Kjo është pra një histori pa viktimi, pa pasoja për të tjerët. Përkundrazi një histori me shpërblim për femrën dhe me një viktimë, mashkullin, d.m.th mua. Me një autor të vërtetë, krimi. Një media dhe dorën politike që e drejton. Por, media është e lirë. Ajo nuk preket. Rroftë, pra media e lirë dhe e pavarur!

Zotërinj! Nuk do të justifikoj këtu atë moment të provokimit që sërish e kapërceva, siç nuk do ta kishin kapërcyer shumë të tjerë. (të paktën siç më shkruajnë me SMS apo deklarojnë publikisht shumë meshkuj). Nuk do të bëj apologjinë e tij.



Ndokush mund të thotë siç edhe më shkroi në SMS: “Ne s’do na kapnin siç të kapën ty”. Ndoshta jo ty, miku im. As atë. Por dikë tjetër, po. Një nga ju. Nga ata. Ndofta jo sot. Nesër. Ndofta jo me çimka. Me diçka më të sofistikuar. Historia vazhdon. Gjithsesi kjo nuk është një kapje. Ky është një provokim dhe aq më shumë unik në llojin e vet, i paparë në botë dhe të cilit nuk mund t’i shpëtojë askush në kushtet e shtëpisë së vet. Gjithsesi rroftë media e lirë të bëjë gjithçka deri në shtëpinë e tjetrit, në jetën private të tjetrit. Nesër pse jo dhe në krevatin bashkëshortor të tjetrit.

Të nderuar zotërinj! Të biesh dakord me këtë që ka ndodhur do të thotë të biesh dakord që nesër ky TV, kjo kamera, ky Filip të hyjë edhe në shtëpitë tuaja.

Të biesh dakord me këtë është të biesh dakord të të përgjojnë në kafe, në rrugë, kudo dhe kushdo.

Të biesh dakord e të duartrokasësh këtë që ndodhi do të thotë të rikthesh kohën e frikës, mungesës së lirisë, terrorit.

Të pranosh këtë do të thotë të pranosh provokimin, poshtërimin, dënimin, shkatërrimin e jetës së kolegut tuaj, mbi bazën e një skenari të gatuar që më parë, d.m.th që ta pranosh këtë për veten tuaj nesër.

Të pranosh këtë d.m.th të pranosh të poshtërohesh publikisht, pabesisht, pa asnjë paralajmërim, ndonëse me imunitet. Të pranosh këtë nuk është të mbrosh lirinë e medias. Kjo është t’i japësh asaj një fuqi diabolike, dhe për më keq kur prapa saj

fshihen segmente të pista politike, biznesi i ndyrë, mafia, do të thotë t'i mohosh vetes lirinë e ta lësh atë në duar të së keqes, të zuzarëve. Këtu pastaj liria e medias, mbetet sllogan, maskë që mbulon të keqen, mashë në duart e kësaj. Në rastin më të mirë një media e njerëz të tillë që e përfaqësojnë atë mbeten gjobëvënës.

Gjithsesi media është e lirë. Rroftë media e lirë dhe e pavarur!

Dhe pas kësaj zotërinj, e paparë dhe e padëgjuar në një vend demokratik, të dënohesh menjëherë pas kësaj nga gjoja opinionioni publik, analistët, disa organizata të masave, media, politikanë. Dhe e gjitha kjo me dy sekuenca filmike e ca dialogje?! Pa pritje të tërën, vazhdimin, mbrojtjen e këtij njeriu që i takon si çdo krijese tjetër njerëzore në një shoqëri demokratike. Ju e dini, të nderuar ligjvënës që gjithçka thuhet kundër një personi ende të prezumuar të pafajshëm, përbën krim dhe dënohet, sepse shkon në dëm të të prezumuarit. Tani kujtoni sa është thënë e vjellë në gjithë këtë periudhë për mua.

Ju lutem, më thoni, në cilin vend të botës i është futur kamera e fshehtë një ministri, një deputeti, një njeriu me imunitet në shtëpi? Madje as edhe një njeriu të thjeshtë për t'i nxjerrë qoftë edhe një sekuenca të jetës private, aq më shumë që atë vajzë e njihja prej kohësh. Askurrë, as sot, as mot, nuk ka ndodhur kjo. Kur bota ka mjaft raste xhirimesh në zyra e marrëdhëniesh seksi në vende publike a zyrtare. Gjithsesi, media është e lirë. Rroftë media e lirë, "e

pavarur" dhe e gjithëfuqishme, e kudondodhur deri në vrimë të ...miut!

Të nderuar deputetë! Deri para pak kohësh ka folur në mendjen tuaj e të mjaft njerëzve imazhi i krijuar e i përpunuar i një medie të pamëshirshme, imazhi i një ngjarjeje të kurdisur e të stisur, të cunguar e të montuar. Tani filloi të flasë ndërgjegjja e logjika e qytetaria, dhe kur të zbardhet e gjithë ngjarja do të flasin ndryshe të gjithë. Ajo që ka ndodhur do të kuptohet nga të gjithë, ndonëse një gjë është kuptuar që në fillim nga të gjithë: Ky ishte një Kurth, madje i ndyrë, i denjë për kohërat më të errëta të historisë së shoqërisë njerëzore.

Kur kaloi pak kohë, unë e di se kam takuar shumë nga ju, ju si të tjerët pyetët: "More, çfarë bëri? Kush u dëmtua? Ajo që mori paratë? Atëherë cili? Morali publik? Cili moral? Morali brenda në shtëpinë tënde. Bah. Atëhere pse ja futën Yllit? Diçka tjetër fshihet pas kësaj". Mjaft nga ju janë përpjekur t'ja gjejnë përgjigjen kësaj. Kanë hedhur edhe hipoteza. Mi kanë treguar. Unë kam heshtur. Gjithsesi ju as që e vini në dyshim që jo për arsye morali ndodhi ajo që ndodhi, që gjoja na qenka kërkuar seks për tu futur në punë e që na u cënua morali nga një minisër? Sepse kur ndodhi. Me kë ndodhi? Në cilën situatë reale? Asnjëherë. Kanë ardhur e kanë hyrë në punë me dhjetëra vajza e gra që punojnë shumë mirë e me cv të pasur dhe nuk janë pranuar e pushuar ato që nuk kanë qenë të afta. Vetëm kjo ka ndodhur kudo që ky njeri

ka punuar në administratën publike. Atëhere problemi këtu mbetet që kujtdo edhe me imunitet, në momente të caktuara e për interesa të caktuara mund t'i luash rengje e kurthe të tilla. Ku vemi kështu?

Zotërinj deputetë. Në situatën në fjalë nuk u kërkua punë në këmbim të seksit. Nuk ka as edhe një sekuencë që të dëshmojë një gjë të tillë. Ndodhi e anasjelltë. Si fillim u provokua ngacmimi seksual me pretekst kërkesën për punë. Kërkesa për punë ishte preteksti për të kapur ministrin. Skenari: i parë ishte provokimi te dera e ministrisë, me të gjitha format, veshjen, joshjen, pastaj me ardhjen në shtëpi natën. (Ndonëse i ishte kërkuar më parë të vinte në ministri) Kjo është e para. Puna vinte pas. Pse të mos kërkohet puna normalisht, në zyrë, me veshje normale, me sjellje korrekte, si shumë të tjera dhe nuk do të ndodhte asgjë, siç nuk ka ndodhur qindra herë!? Ah, por jo puna duhej kërkuar zhveshur, me përdredhje që të ndodhte patjetër diçka, që të futej njeriu në grackë. Me çdo kusht. Kjo bëhet sikur nuk kuptohet.

**Mos harroni: Femra në fjalë ka ardhur me veshje provokative dhe kjo është e para. Femra në fjalë ka qenë e njohur me mua prej kohësh dhe kjo është e dyta. Femra ka ardhur në shtëpi dhe jo me ftesën time dhe kjo është e treta dhe madje natën vonë dhe kjo është e katërta.** *Mos harroni: Ajo vajzë e pandërgjegjshme për atë që bënte, ishte e njohura ime, prandaj erdhi aq lehtë, prandaj provokacioni dukej i pabesueshëm Ndërkohë e gjitha ishte situatë provokative.*

*Tani si ligjvënës gjykoni ligjërisht: Në bazë të Konventës evropiane të të Drejtave të Njeriut, ekstremi i sipërm i së drejtës sonë sot, konventë që e kemi nënshkruar dhe ne, ngjarja provokative nuk merret për bazë për penalizim (çfarë neni donin të gjejnë ca nga analistët tanë: korrupsion aktiv?!). Por edhe në bazë të së drejtës më antinjerëzore, ekstremi i poshtëm i të drejtave të njeriut, sipas ligjeve të diktaturës që lamë pas, ngjarja që rrjedh nga provokimi nuk merret për provë dhe as të penalizonte. Atëherë për çfarë po dënohet publikisht ky njeri kaq ashpër? Mbi ç'bazë? Që t'ju dënojnë, t'ua marrin edhe juve erzin, imazhin, jetën, nesër, pas provokimit më të parë? Kush duhet dënuar pra?*

Mendoni sikur edhe me të dashurën, gruan a miken tuaj t'ju xhironin në dhomë, në shtëpinë tuaj, apo qoftë edhe lakuriq duke u larë a diçka tjetër dhe pastaj këtë xhirim ta shfaqnin (xhironin) dhjetëra, qindra, mijëra herë, ta shihnin me miliona shqiptarë në tërë Shqipërinë e jashtë saj, në të gjithë kanalet televizive, në you tube, në internet, në facebook. A do t'ju vinte turp? Sigurisht do t'ju vinte, jo se kishit bërë diçka të keqe, por se ju ishte përdhosur, shkelur, pështyrë intimiteti, imazhi, personaliteti. Se do t'ju tregonin të gjithë me gisht. Mendoni ç'është bërë. Mendoni ç'më është bërë! Turpërim publik si në mesjetë. Kujt i ka ndodhur kjo në botë?

Të nderuar zotërinj deputetë. Ka ndodhur një gjë e paprecedent në historinë botërore, e theksoj, botërore. Pas një periudhe të gjatë, rreth 20 vjeçare morali të dyshimtë, besimi e feje ende të

pakonsoliduar, pas një trandje të gjatë 50 vjeçare një pjesë e shqiptarëve, natyrisht jo të gjithë, atë natë të “gjëmës” së madhe, të “skandalit” Pango, po dilnin për herë të parë në shesh me pallën e moralit zhveshur. Ata e shpallnin kësisoj vendin e tyre pa dyshim si vendin më të moralshëm në botë, shoqërinë e moralit të kulluar.

Dhe kjo ndodh sot. Sot kur në një vend të madh të botës së madhe një burrë i madh shteti kërkoi dhe realizoi madje dhe raport seksi me nëpunësen e vet, në një situatë reale, në zyrë dhe u la i lirë të shprehej u hetua, u investigua, opinionioni publik ndoqi me qetësi deri në fund hetimin dhe përfundimin duke e lejuar më pas atë të ndiqte jetën e tij normale familjare e politike, madje duke e mbështetur në vijimësi edhe më pas. Pastaj vazhdoi karrierën. Në një vend tjetër të madh në Angli u krye seks në parlament, u filmua, doli nudo. Guxoi ta jepte vetëm një gazetë dhe sërish asgjë. Në një vend fqinjë ndodhi e njëjta gjë në zyrë dhe njeriu iku po asgjë nuk ju publikua së paku. Një tjetër i madh në vendin fqinj u xhirua shumë më keq mes nudosh e tha hapur: “Më kini cënuar jetën private. Akuza bie mbi ju”.

Këtu tek ne u provokua, nuk pati as seks as kërkesë për seks. Por u publikua, u gjëmua, u shkatërrua një jetë dhe jetë të tjera familjarësh të mi, u traumatizua dhe nuk mjaftoi kjo u kërkua dhe penalizmi, dënim. E paparë. A ka ligj që të më mbrojë, që t’ju mbrojë, sot, nesër.. E frikshme apo jo? Por së paku s’ka as apo ka pak njerëz që

të të mbrojnë në bazë të ligjit se kanë frikë nga mediat. Deri dhe disa avokatë tërhiqen nga frika se kushedi ç'u bën media e frikshme. Ju shkon me filmime, I kërcënon. E kam dëgjuar këtë nga avokatë. Edhe këtu jemi originalë e të paparë. Duhet menduar zotërinj, duhet vepruar, ndryshe e keqja ju përgjon tek dera.

Zotërinj ashtu, si në gjithë botën demokratike, deshën dhe mediet tona të kishim një skandal seksual, seksual të vërtetë, me seks, me zyrë, me tryezë, me nudo, me rënkim, po nuk doli gjë. Doli një "skandal" seksual pa seks. Me gjithë titujt e mëdhenj të gazetave e sado që regjia ishte e shkëlqyer dhe të gjithë u tronditën sikur çfarë ndodhi, në analizë të fundit nuk u pa gjë? Sa keq. Edhe këtu nuk e kapëm dot botën. Madje as skandalet me "gate" pas. Pangogate, siç e emërtoi "miku" ynë i vjetër Balla.

Siç ju thashë, pra në të gjithë rastet e mësipërme, por edhe në raste të ngjashme e shumë të rënda tek ne, nuk është bërë kjo zhurmë. Kurse për mua..! Hëm, për mua. Pa m'u dhënë mundësia më e vogël për shpjegime, pa u parë gjithë kasetat e sajuara, pa lidhje pune dhe me njohje personale të hershme me vajzën, në një situatë artificiale të sajuar e provuar pa sukses disa herë më parë (shpresohej në zyrë), *unë u dërrmova. Vetëm me një foto filmike normale dhe një dialog të stisur*.. Por nuk mjaftoi kjo, u linçua, u denigrua, u pështy, u mohua totalisht njeriu dhe puna e tij mbi 30 vjeçare

në administratën publike. Atij iu hoq pllaka ku shkruhej për punët e mira që kish bërë. U dëgjuan edhe thirrje për t'i djegur librat. E nuk mjaftoi kjo, por po nga mediet u kërkua edhe të procedohej, për një gjoja akt, në të vërtetë mosveprim në shtëpi të vet. Për ta ligjësuar u kërkuan edhe precedentë, u hetua. Media, gjithmonë media. Sigurisht, si mund të justifikohet gjithë ajo gjueti. Akt i paprecedent në botë. Do ta marrë historia zotërinj. Natyrisht edhe mua, si viktimë të paprecedent.

Fakti që një televizion ka futur një kamera në shtëpinë e një njeriu me imunitet, e një deputeti, e një ministri, në një kohë që kjo edhe për një njeri të thjeshtë përbën një shkelje të rëndë të privatësisë, dhunim banese, e shumë të tjera, është i paprecedent. Më pas ky televizion ka transmetuar vetëm një pjesë sekuencash duke nxitur një histeri të vërtetë mediatike e publike dhe po vazhdon ende duke shkatërruar jo vetëm jetën (nuk po llogarit njeri karrierën) e një njeriu, por duke tronditur e traumatizuar dhe mjaft jetë të tjera familjarësh të mi. Ky TV ka kryer një vepër të rëndë penale, sepse e theksoj rasti është i paprecedent, dhe po nuk ju vu fre, mbret i këtij vendi do të bëhet shantazhi, provokimi, skenarët, spiunimet, top kanali, fiksi dhe Filipi.

A nuk duhet menduar, zotërinj deputetë, se kjo media, këto medie, kanë shkuar tepër larg. A nuk duhet të kujtohem se nuk ka demokraci me liri të pakufizuar, pa fund, pa limit për askënd. Qoftë ky njeri, institucion, a çfarëdo qoftë.



Të gjithë u tremben këtyre medieve. Të gjithë kanë frikë madje deputetët edhe në sallën e parlamentit fshehin celularët kur shkruajnë ndonjë SMS intim se mos xhirohen nga spiunët mediatikë. Kjo ka ndodhur. Dikuj i kanë publikuar edhe sms-et me mikeshën e tij. Politikanët duan ta kenë mirë me mediat. Ekzekutivit prej vitesh disa nga këta mediatikë i kërkonin tendera. Fytyrat që nuk ju pëlqejnë goditen pa skrupull syresh. Ajo pjesë e tyre që u shërben bosëve të një krahu të politikës ndjek, përgjon e godet a mund të godasë nesër cilindo. Askush nuk është i sigurt.

Zotërinj! Lufta për vënien në vend të kësaj padrejtësie, krimi të rëndë kundër meje, mbetet motivi e qëllimi kryesor i jetës sime, dhe do ta ndjek me këmbëngulje. Por dhe ju duhet ta mbështesni këtë. Për hir të të drejtave jo vetëm të njeriut me imunitet por edhe më të thjeshtit syresh. Edhe ligjin duhet ta rishihni me urgjencë, qoftë ju qoftë parlamenti i ardhshëm

Zotërinj! Ju nuk duhet ta ligjëroni këtë akt të shëmtuar kundër meje, duke heshtur. Të pranosh në heshtje këtë është të ligjërosh që një media pati të drejtë të më hyjë në shtëpi, të provokojë me një dikur të njohurën time, tashmë të paguar si spiune, dhe pas kësaj të më poshtërojë mua publikisht, e si të mos mjaftojë kjo varrosje e jetës sime publike por edhe e asaj personale, e familjes sime, djalit tim, nënës time plakë.

*Zotërinj deputetë! Mos e lini të kalojë në heshtje këtë. Do ju vrasë ndërgjegjja për këtë. Mendohuni mirë.*

*Askush nuk fshihet dot prapa tjetrit. Bëjini vetes pyetjen:  
Po sikur nesër të më ndodhë mua?*

Zotërinj deputetë. Të pranosh këtë është të pranosh që kjo nesër të lejohet t'i ndodhë cilitdo nga ju. Duke heshtur, duke mos vepruar, kjo ligjërohet sot. Nëse lejojmë këtë ne i hapim rrugën e lirë kësaj. Gjithsesi ju e dini.

Gjithsesi “rëndësi ka që media është e lirë”. Pa çka se ne nuk jemi të lirë as në shtëpitë tona. Rroftë media e lirë dhe e pavarur!

Nuk do të dëshiroja që parlamentit shqiptar, t'i mbetj në histori që nuk mbrojt e nuk mbron anëtarin e vet, por e le të bluhet në gojë të peshkaqenëve të medias e politikës që e ushqen atë, mbi bazën e një ngjarje të provokuar. Nuk do të dëshiroja që kjo të kalonte kështu. Të zgjedhurit e kanë këtë të drejtë në çdo vend të botës demokratike. Vetëm ne nuk e kemi këtë. Ky rast mund të ishte një *casus* historik, për të mbrojtur përfaqësuesit e popullit po dhe njerëzit e thjeshtë nga çdo lloj linçimi i ardhshëm mediatik, për t'i vënë fre brenda rregullave të demokracisë, një pushteti mediatik arrogant e të pamëshirë që realisht ka dalë mbi të gjithë pushtetet dhe përdor mjete dhune, terrori e shantazhi që nuk i përdor një pushtet në botën demokratike.

Të nderuar zonja e zotërinj! Ndonëse kërkesa për vetëvrasje erdhi nga dy bosë-gazetarë nga më “të moralshmit” e medias shqiptare, unë, i ndodhur nën presionin mediatik vrastar, nën shokun emocional të paparë e pas një konsumi

fizik e moral të padëgjuar, për disa momente e kam menduar edhe vetëvrasjen.

Pastaj zoti më ndihmoi, më ringjalli, më dha forcë e logjikë të kuptoj se “ajo që kisha bërë” nuk ishte vërtet asgjë përpara saj që më kishin bërë; provokimit, dhunës, shkeljes, shkatërrimit të personalitetit, jetës, familjes time.

Zotërinj deputetë! Jemi përpara një shkelje të vazhdueshme të ligjit. Jemi përpara pranimit të paligjshmërisë si ligjshmëri, të të paligjshmes si e ligjshme. Jemi përpara një të keqeje që jemi mësuar të na hyjë në jetët tona, dhe e kemi lënë derisa ka hyrë së fundmi në shtëpinë e njeriut më me imunitet, te shtëpia e ministrit, e deputetit.

Të nderuar zotërinj deputetë! Nuk po ju adresohem as për mëshirë dhe as për të thyer standardet e lirisë së medias. Këtu jemi, siç thashë më sipër, jashtë çdo standardi.

Po ju drejtohem juve për t’ju propozuar që, me forcën e së drejtës suaj si ligjvënës, por sidomos me logjikën e qartë e të fortë të njeriut të lirë, të pengoni një precedent i cili nesër mund të bjerë mbi këdo nga ju.

Mendojeni mirë, zotërinj deputetë! Ky rast del jashtë çdo standardi. Cili është standardi këtu? Në emër të cilit standard është bërë kjo gjëmë? Të hajnisë? Të gjobave? Apo të politikës? Të konfliktit gjigant të interesit të një medie të pamëshirshme? Të rrënimit të jetës së tjetrit. Kush u dëmtua? Vajza apo unë? Apo morali publik?

Cili moral, ai i fshehuri me 1001 bëma apo ky i hapuri, i Ylli Pangos, pa dhunë, pa seks, pa nudo, ku nuk ndodhi asgjë, ku edhe një provokatore me moral të dyshimtë hyri e doli pa i hyrë gjemb në këmbë?

Ky është kazus, pra. Kjo duhet të jetë pikë kthese. Zotërinj deputetë, mendohuni mirë! Përpiquni të shlyhet e të harrohet sa më shpejt ky turp. Unë nuk do e harroj dot. Nuk më lënë as qentë e rrugës.

Edhe një herë, për herë të fundit: Mos harroni, të nderuar zotërinj deputetë, se duke ligjëruar këtë në një formë ose në një tjetër, pa dashur t'ju fyej, në një formë ose në një tjetër, ju ligjëroni që kjo mund t'i ndodhë dhe lejohet t'i ndodhë nesër, cilitdo prej jush. Ai ligj duhet ndryshuar. Ai nen që i jep gjithëfuqinë medias nuk mund të mbijetojë më.

Në rast të kundërt, Zoti qoftë me ju dhe jetën tuaj private zotërinj, deputetë! Zoti por jo media e hajnia politike.

Mos harroni, media është e lirë.

Rrofshin me(n)diat e lira e të pavarura!



## II

### Curriculum Vitae

e shkurtër e Prof. “Kriminel” Dr. Ylli Pangos



## **Prof. dr.Ylli Pango**

**Emri:**Ylli Pango

**Adresa:** Rr. “Ali Visha” Nr.60/1 Tel.376436,  
370690

**Datelindja:** 26 Mars 1952

**Vendlindja:** Tiranë, Shqipëri

### **Arsimimi:**

**Nga 1969-1974** ky “kriminel” kryen studimet në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, Dega Matematikë 5-vjeçar, Universiteti i Tiranës. Diplomohet Matematikan me rezultate shumë të mira e më pas kryen edhe kurs pasunivesitar në psikologji. Vazhdon me specializime në Itali, në fushën e Studimeve Psikologjike, për të vijuar më pas me studime pasuniversitare në Universitetin e Bostonit, Diplomë në fushën e Planifikim-Administrimit të Arsimit-Diplomë në studime pasuniversitare në psikoterapi me studime pasuniversitare në Universitetet e Montpellier, Francë, Universitetin e Granadës, Spanjë, Universitetin e Luvenit, Belgjikë, Studime pasuniversitare pranë Universitetit të Washingtonit, Seattle.



## **Grada dhe Tituj Shkencorë:**

**Më 1987** ky na merr gradën shkencore “Kandidat i Shkencave” e më pas në **1992** gradën shkencore “Doktor Shkencave e më **1994** merr titullin e “Profesor”

## **Ky “i poshtër” ka punuar:**

**1974-1976** Matematikan në Byro projektimi

**1976-1982** Mësues e drejtor në shkolla të mesme e tetëvjeçare

**1983-1992** Studiues e shef sektori ne Institutin e Studimeve Pedagogjike në Tiranë. Pedagog i matematikes dhe i psikologjise ne Universitetin e Tiranës.

**1992-1994** Zv. Minister i Arsimit.

**1992-1994** Nënkyetar i Komisionit të lartë të Kualifikimit Shkencor të Shqipërisë.

**1992-1994** Nënkyetar i Komitetit Shqiptar te UNICEF-it.

**1996** Drejtues-menaxher në Fondin Shqiptaro-amerikan të investimeve.

**1997-1998** Kryetar i Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar.

**1995** Pedagog pranë Fakultetit të shkencave sociale.

**1999** Dekan i fakultetit te Shkencave Sociale 2 herë.

Rindërton Fakultetin e Shkencave Sociale me auditorë modernë dhe amfiteatër 300 vendësh. Krijon degën e Shkencave Politike.

**2005** Deputet i Kuvendit të Shqipërisë e nënkryetar i Komisionit të Medias.

**2007-2009** Ministër i Turizmit, Kulturës, Rinisë e Sporteve.

**Ky “monstër” ka një sërë librash e teksteve të botuara:**

- 1- **“Metodat Statistike ne Studime Psikologjike”**  
(130 faqe, 1985)
- 2- **“Psikologjia e të menduarit të fëmijës”**  
(130 faqe, 1987)
- 3- **“Te fshehtat e kujtesës”** (210 faqe, 1990)
- 4- **“Rrënoja”** (130 faqe, 1994)
- 5- **“Amerika”** (200 faqe, 1996)
- 6- **“Psikologji Sociale”** (301 faqe, 1997)
- 7- **“Edukimi qytetar-Edukim për demokraci”**  
(1999, 120 faqe)
- 8- **“Krim”**
- 9- **“Psikoterapi”** (me rreth 900 faqe)
- 10- **“Prostitucioni , një plagë e hapur e shoqërisë shqiptare”**
- 11- **“Arsimi i mesëm në Evropë” (High education in Europe).** 1994. (Bashkautor si autor i kapitullit **“High Education in Albania”**), Botim i Këshillit të Evropës.

**Veç këtyre, qindra artikuj janë botuar edhe në shtypin periodik e atë divulgativ-shkencor mbi probleme sociale e psikologjike.**

Gjatë kohës që ky “armik i popullit” ishte ministër u bënë këto punë pa rëndësi për vendin dhe të mirën publike.

# *Arritjet e Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve: Viti 2007-2009*

*(vit kur drejtoi ky armik i kombit)*

## Në kulturë:

### Investime:

- U restaurua për 100 ditë **“Lidhja e Shkrimtarëve”** dhe u kthye në Ministri të Turizmit, Kulturës Rinisë dhe Sporteve, ku veç zyrave ka dhe Sallë Koncertesh, Sallë të artit figurativ, Salla për aktivitete artistike ne shërbim te artisteve.
- U rikonstrutua Instituti i Monumenteve të Kulturës **“Gani Strazimiri”** dhe u ndërtua **Shkolla e pare Shqiptare e Restaurimit**, bashkëpunim me Qeverinë Italiane.
- Në **“Rrugën e Elbasanit”** u ndërtua **Biblioteka e Librit të Huaj**, me pavijonet gjermane, italiane, franceze e angleze.
- Filluan punimet tek Piramida për kthimin e saj ne **Qendër të madhe Kulture**, investim me një vlerë 570 milion lekë (të reja), ku përfshihen **Galeri Kombëtare e arteve Figurative, Teatër i Madh Kombëtar, salla varieteje** dhe mjedise të tjera që do i shërbejnë kulturës dhe artit në vendin tonë. Është investimi më i madh në Kulture në njëzet vitet e fundit.

# Në trashëgiminë kulturore

## Viti 2008

- Vetëm për vitin 2008 u punua për restaurimin e **47 banesave karakteristike ne Berat**, me 3 herë me shume fond se gjate vitit 2007. **Më 10 Korrik 2008, qyteti i Beratit u pranua** si pjese e Trashëgimisë Kulturore Botërore në mbrojtjen e UNESCO - s.
- U krijua e para **Zyrë e Koordinimit dhe Administrimit, Gjirokastrë**, për administrimin e fondeve për restaurimin e qytetit.
- Një investim i rëndësishëm u krye gjate vitit 2007 në Gjirokastrë dhe po vazhdon edhe gjatë 2008 **(në total rreth 2 milionë euro)** ku përfshihet dhe **fondi prej 1.3 milionë dollarë** per Restaurimin e Qendres Historike, Qafen e Pazarit Gjirokastrë, restaurimi i **Hanit te Zagorise** me vlere 24 milion leke, restaurimi i **Shtëpisë se Çabejve**, restaurimi i **Shtëpisë së Kadaresë** për vitin 2008, restaurimi i **kalasë Gjirokastrë** .
- Pas negociatave me Ministrinë greke të Kulturës u realizua **kthimi i statujave nga Greqia, (shtatoret e Apollonit dhe Artemisës)**.
- Aplikohet dhe fitohet nga MTKRS pranë zyrës së Komunitetit Europian projekti me vlere **3 milion Euro** per restaurimin e kalave mesjetare: **Kalaja e Himarës, Kalaja e Tiranës, Kalaja e Krujës**.
- Aplikohet dhe fitohet nga MTKRS projekti i **fondit të Qeverisë Spanjolle** me vlere **3,26 milion Euro** i cili po përdoret për **Muzeun Kombëtar** dhe ne zhvillimin e mëtejshëm të Turizmit artizanal në vendin tonë.

- Fondi i fituar nga Komuniteti Evropian me vlerë 3 milionë Euro, Fondi i fituar pranë qeverisë Spanjolle me vlerë 3,26 milion Euro së bashku me vlerën totale të investimeve të buxhetit të shtetit (305 milion leke), ka rritur **10 here më shumë në krahasim me vitin 2007 fondin** për investime në fushën e Trashëgimisë Kulturore për vitin 2008.
- U krijua për **herë të parë** një strukturë në varësi të MTKRS, **Agjencia e Shërbimit Arkeologjik**, e cila kryen arkeologjinë e shpëtimit në rastet kur gjatë ndërtimeve e gërmimeve zbulohen vlera arkeologjike.

## Viti 2009

- Filloi zbatimi i projektit **3.26 milionë USD** nga qeveria spanjolle për rikonceptimin e Muzeut Historik Kombëtar, por edhe për parqet arkeologjike të Apollonisë e Antigonesë si dhe krijimin e strategjisë së marketingut të turizmit në Shqipëri.
- Fillon procesi i tenderimit ndërkombëtar për fillimin e punimeve në Kalanë e Tiranës, Krujës dhe Himarës me fondet e Komisionit Evropian (**rreth 3 milionë euro**). Pak kohë më parë janë konfirmuar edhe rreth **2 milionë euro të tjera** për Kalanë e Beratit dhe Lezhës.
- Vijon puna në restaurimet në **Qafën e Pazarit në Gjirokastër** me financimin e qeverisë Shqiptare dhënë UNESCO-s.
- **Hapet për herë të parë Zyra e Koordinimit të Qendrës Historike të Beratit** që do të lehtësojë procesin e marrjes së financimeve dhe projekteve ndërkombëtare në funksion të qendrës historike.

- Përfshihen në sistemin e MTKRS muzetë arkeologjikë të Butrintit, Apollonisë, Durrësit dhe Korçës, duke e rritur numrin e përgjithshëm të muzeve në varësi në **12**.

Te 12 muzetë e lartpërmendur janë tashme te vizitueshem online në disa gjuhe.

- MTKRS ka hapur procedurat për rijetezimet e kalave ne Shqipëri te cilat do te përmirësojnë ndjeshëm sistemin e mbrojtjes dhe vizitueshmërisë se tyre.
- Realizohet për 20 ditë **Ekspozita-Muze: 20 Shkurti “Dita në Nderim të Viktimave të Sistemit Komunist”**.
- Ndërtohet rruga Kol Idromeno, Shkodër, rrugë karakteristike me kalldrëm që rikthen imazhin e Shkodrës së vjetër.

## Në turizëm

Për vitin 2008 numri total i vizitorëve arriti në **2.7 milion**, duke u klasifikuar kështu si periudha e **“bumit turistik”** më të madh që ka njohur Shqipëria. Për këtë periudhë numri i vizitorëve ka pasur rritje 21% ne krahasim me 2007, me vitin 2006 ka rritje 44 % dhe krahasuar me 2005 rritja është 77%, dhe është **10 herë më i madh** se numri i vizitorëve në vitin 2004.

- Për herë të parë promovohet Turizmi Shqiptar në rrjetet televizive ndërkombëtare, nëpërmjet **spotit** i cili u shfaq në kanalin prestigjioz televiziv **CNN**.
- **Panairi i Turizmit në Berlin dhe Panairi i Turizmit në Londër** shënojnë një paraqitje të re dinjitoze të Shqipërisë turistike dhe rrisin mjaft numrin e vizitorëve.
- Janë hartuar paketat turistike **10 turet** e mëdha të

Shqipërisë dhe **11 itineraret kulturore dhe natyrore në bregdetin e jugut.**

- Shfaqet spoti rajonal i turizmit shqiptar “**Shqipëria, pasioni i ri mesdhetar**” në Kosovë dhe Maqedoni.
- Prezantohet **Albania Guide Turistike 2008** , (mbi 500 faqe).
- Shfaqet **spoti** i ri i turizmit shqiptar në rrjetin televiziv ndërkombëtar **EURONEËS** transmetuar 100 here deri me 7 prill, 2009.
- Publikohet dhe pasurohet faqja zyrtare e turizmit [www.albaniantourism.com](http://www.albaniantourism.com), me mbi 500 faqe.
- Realizohet projekti i **40 Haneve**: paketa turistike për turizmin malor dhe shtëpitë karakteristike në Theth, Valbonë, Kelmend, Pukë,etj. paketë promovuese për turistet e huaj dhe hartohet e aprovohet vendim i Këshillit të Ministrave për asistencë financiare për banorët e zonave malore që zhvillojnë turizmin malor.
- Përfundon sinjalistika turistike dhe ajo e trashëgimisë kulturore në pjesën më të madhe të vendit.
- Hartohet dhe aprovohet ligji i ri për turizmin me 19 aktet nënligjore.

Për të gjitha këto dhe për një provokim të ndyrë, natën vonë në shtëpinë e tij, kjo qenie pa vlerë është sharë, dërrmuar, linçuar nga mediat dhe analistët shqiptarë (në shumicën e tyre) gjatë muajit të mbarë të marsit 2009.

Zoti qoftë me ta.  
Amin!

### III

Pas mediave, më folën njerëzit





**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.06 / 10:54**

I nderuari zotni Yll Pango ju lutem mos u dorezoni perball armiqve tuaj qe duan tju fundosin. Tregojuni qe jeni qe burre me vlere e nuk dorezoheni kollaj. Me respekt te jashtzakonshem per ju nji qytetar nga shkodra.P.C me profesion Zjarrfikes

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.04.06 / 21:09**

Te pershendes dhe uroj te jesh mire

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.09 / 20:08**

Sinqerisht je ministri im.asnje sdo beje punen qe bete ju.

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.07 / 19:33**

Z PANGO.TE FALENDEROJ PER QETESINE, BURRERINE,DHE BESOJ SE SI MINJTE DO TE SBRAPSEN TE VENDET KU NGA KANE DALE. P PRIFTI.

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.06 / 18:41**

Mirmbrema.Do doja t'ju thoja qe: ZOTI thote-NESE NE NJE ANIJE KA 99 PJESTARE TE KEQINJ DHE 1 TE MIRE UNE ATE ANIJE SE MBYS" Une po ju them qe edhe sikrur te gjithë shqiptaret dhe e gjithë bota te mendojne keq une ta thash edhe mbreme.une te kuptoj drejte ajo mund ti ndodhe kujtdo.Ju e bete te tuajen mbreme.Ta them me gjithë zemer qe cfardo qe te ndodhe "JU MOS E MBYSNI ANIJEN TUAJ" sepse gjithmone e keni nje pjestar te mire ne bordin tuaj!"

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.22 / 19:59**

Te uroj nje nat te kendshme.Te perqafoj fort je nje person gjenial dhe i paaritshem...Zoti te bekoft dhe qoft me ty ne cdo hap te jetes..Naten

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.08 / 18:50**

Mirmbrema profesor jemi nje grup Sunash nga sauku donim te" thonim qe" mos ju nenshtro atyre qe" tA" duan te" keqen,se ato mostrat e fiksit shkojn me balerina 15 vjecare dhe dalin e flasin per moral,NATE^N

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.07 / 17:21**

Mos e caj koken per maskarenjt dhe sigurimsat tani.

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.06 / 14:58**

Fml , o rob zoti . Ta shtoft zoti jeten . Shume fml.

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.05 / 23:45**

Jam punonjese ne AKT.Besojme familjarisht tek ju dhe tek serioziteti juaj.Jini i forte jemi te gjithë prane jush

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.12 / 10:18**

Z TOPI,Z BERISHA.VEC AGJENTURA E POLICISE SEKRETE E CIAS,FBIS,K. K.G.B MUND TE KETE HAPESIRE TE HYJE NE SHTEPI ME LIGJ JO FIKSI O ZOTERINJ KOMBIN TANI DUHET TA ZERE TMERRI?

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.07 / 21:15**

Pershendetje z Pango, ju ndoqa sonte ne mbremje tek neës24 dhe do doja tju thoja ta mbani veten nga keta plera ,ku moralin e bejne imoralet. Mbae veten behu me i fort edhe qesh me te tere. Se ske vrare krishtin! Qe te diskutohet nje temë si kjo ne kaq pasion mes kaq hallesh e problemesh, eshte lluks! Mos u dorzo. Ju pershendes

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.07 / 08:31**

Te nderuar Profesor dhe miq. Gezuar Festen e 7 Marsit. Urimet me te mira. Nga P. Shehu.

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.06 / 10:54**

Jam me ca miq (Timka) dhe te mbeshtesim. Per cdo nevojë na thuaj. Avokati legen hiqe. Tani

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.04.01 / 22:09**

Mirmbrema,si kaluat sot. Nuk kam mundur tju tel sepse nuk e di ne ç'moment mund te ndodheni dhe nuk dua tju bezdis. Ju adhuroj,ju uroj naten e mire,artenisa.

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.09 / 20:02**

Un prap jam me ty.po sikur te thoje qe e dija dhe e kontrollova per mikrofon.per mua je ministri qe ndryshoi gjirokastren.por panvaresisht ketyre un vertet jam me ju.zoti ta befte mbare.

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.07 / 19:32**

Pershendetje Prof. Pango!Jam nje qytetar i thjesht,nje student i ri per tu sqaruar dhe doja tju thoja qe keni qenë, jeni dhe do te mbeteni profesor dhe njeri i nderuar.RESPEKTE!

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.06 18:39**

Jeta eshte komedi,jo tragjedi.,ti e di me mire se une.te perqafoj flora n.

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.06 / 00:07**

I dashur Ylli. Ne momentet e veshtira duken burrat, trimat dhe fisniket. Ti te gjitha keto i ke dhe ke shume me teper se kaq. Mos prit qe keto gjera t'i kuptojne servilet, hienat qe duan te perfitojne nga rrethanat, zemervegjlit. Ata jane shume larg botes tende. Prandaj tregojte dhe nje here kush eshte Ylli, ashtu si gjithmone duke perballuar veshtiresite qe jeta, ky vend i paqete me keta njerez te pavlere na vene perpara ne rrugen tone. Me respekt, te perqafoj Eva.

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.22 / 19:48**

Je i nderuar dhe i respektuar per mua do ishte kenaqesi te kisha njohje personale me nje njeri fisnik si ju..Ju uroj shendet ju dhe familjes tuaj..ciao profesor

**sms / deliver / 3.93E+11 / 2009.03.08 / 18:50**

Ylli uroj te jesh mire.Ne keto momente duhet te qendrosh dhe te ruash gjakftohtesine.Te fala Ladi nga Bari.

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.07 / 16:25**

Miqtë per dite te veshtira jane. Gjate javes nje dreke te Kar-Isberg.

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.06 / 14:57**

Pershendetje Z.Pango. Jam nje qytetare nga Tirana. Me erdhi shume keq per skenarin e pergatitur ne kurrizin tuaj. Mendoj se ata qe ju kritikojne do te silleshin shume me pahijshem ne rrethana te ngjashme. F.Jorgji

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.12 / 10:05**

Mirdita,z-Pango je njesh,kuptome njesh me te gjitha, nga XH L lagj'ja Ali-Demi.

**sms / deliver / 3.93E+11 / 2009.03.06 23:36**

Mirmbrema. ZOTI YLLI PANGO ne kete rast s'di se cfare te them. me vjen vertet keq per ate qe ndodhi.te te them te verteten me sa pashë une ishte vertet nje provokim i perkryer kunder teje.eshte normale te vij nje femer e veshur ne ate menyre dhe nga menyra se si fliste asnje mashkull s'do rezistonte dot nje provokimi te tille.gjith te mirat dhe suksese ne pun dhe jete.nga 1emigrant shqipetar ne itali.lindur ne ZALL HERR POR QE JETOI RRUGEVE TE BOTES.

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.06 / 10:53**

Mirmengjesi z.Ylli.Ju kerkoj ndjese 1000 here per kete mesazh.E kuptoj gjendjen ne te cilen ndodheni por nuk mund te rrija pa ju thene te mos shqetesoheshit fare fare.Ju keni jeten tuaj dhe keni te drejte ta jetoni sic ju pelqen juve. Aq me teper ju jeni mashkull dhe eshte mese normale qe nje vajze te bukur askush nuk mund ti rezistonte.Dje ju kam derguar shum sms te klani ne mbrojtjen tuaj te cilat Bledi nuk i ka lexuar pasi nuk i leverdiste.Ju qendroni shumë me lart se ata mos haroni.Uroj tju kaloj sa me shpejt kjo gjendje.Me respekt Artenisa nga gjirokastra.

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.31 / 22:40**

Mirmbrema.Kur te jesh i lire nese ke mundesi ose si te duash thjesht ne menyre shoqerore doja te pija një kafe me ju.me gjith respektin qe kam singqerisht.naten

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.09 / 19:19**

Miku im.Uroj te ruash qetesine dhe maturine sepse jeta ka dhe momente te veshtira qe duhen perballuar.Anesti

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.07 / 19:32**

Profesor ishe perfekt!

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.06 / 00:05**

Mirembrema Z.PANGO!Sh mire qe dolet sot te Fevziu,rregulluat imazhin,provokimet per njerzit jane cudi do ishte po mos te kishit rene ne keto provokime.Pac fat!

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.22 / 19:42**

Mirmbrema profesor Ylli..Uroj me gjith zemer te jeni mirë fizikisht dhe shpirterisht.Do me pelqente nje pergjigje nga ti por un te kuptoj dhe nuk merzitem.Ciao

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.08 / 18:27**

Miterani beri nje femije me te dashuren e tij...mediat jane nivel i ulet dhe hipokrit qe nga topi,vizion plus te gjith me disa dashnore...,por sic dihet me dashnore ketu vetem doktori nuk eshte.Njerzit thone se nga ty nuk pati dhune.,nuk pati akt.ti ishe i provokuar.nuk ishe ne zyre.E fundit, ku eshte e keqja qe ministri takon direkt nje femer?Ti apollgjine e bere.Jepi.

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.07 / 16:13**

Te besoj, por per mua nuk ka rendesi. Kemi punuar per te njeften gje ne role te ndryshme. Mos u merzit se kjo eshte dite e keqe per te gjith ne. Do ta kalojme. Nuk eshte halli yt por i joni. Mos u merzit. Do kaloje. Takohemi ne cdo moment se po nuk folem me njeri tjetrin cu pa. Ky eshte morali per mua. Çu pa nqs ka me shum moral 80 lekshi.

**sms / deliver / 3.82E+11 / 2009.03.06 / 14:57**

I dashur me" vjen keq per rastin, por une po te isha ne vend te saj nuk do ta kisha lshue rastin te jem me ty, jam selveti nga mitrovica, jam modele. Ju pe"rkrahu.

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.05 / 23:45**

Mirmroma jam ben s. a ke nevoje te jem diku afer

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.12 / 10:03**

Uroj te jeni mirë. Po ju shkruaj duke mar shkas ngarjen. Kam ditë qe diskutoj me avokatin e zyres. Ky, pretendon se e keni ceshtjen te fituar nese e ndiqni sa nga ana penale ashtu dhe civile. Nese deshironi nr i cel te tij eshte. 2027 204

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.07 / 20:53**

Vazhdim se nuk ma zuri me shpres se do te ndikoj sadopak ne ringritjen shpirterore dhe me ndjenjen e detyres per tu gjendur ne caste te veshtira se kemi rrufitur nga nje kafe bashk prej S. PONARI

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.06 / 22:52**

Zoti Pango duke marre cdo gje" parasysh, te" sugjeroj te" mos e cash koken fare.jam me ty!!nje" goce e thjeshte vlonjate.

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.06 / 10:35**

Prsh. Ylli. E vleresova nderhyrjen per te verteten tek klan mbreme. Te ka zene e keqja nga i keqi ( kurth diabolik i cakallit ) uroj te ruash qetesine tende. Gjerat do kalojne dhe koha do sheroje. E verteta eshte me ty, jo me cakallin. beni

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.30 / 14:29**

Pershendetje z.Ylli.Si jeni mire?Punet si po ju shkojne?Uroj sa me mire. Me falni nese ju bezdis ndonjeher me shkrimet e mia.Me respekt Artenisa.

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.08 / 11:54**

E ndoqa intervisten , e para me erdhi keq se ke bere goxha pune , Une ngul kembe per ardhjen e saj ne shtepine tende se te qeshte embelsisht e lepinte buzet ne menyren me eksituese. Kur dikush ka tendenca te te beje keq.

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.07 / 11:22**

Z.Pango, kam qene ne rastin e Akademise per nje zgjidhje te negociuar; mos e perjeto me shume emocion efektin e 'Fiksit'. Po te isha ne vend te Doktorit, do ti thoja me mosshkarkimin tend Cakulit: falmnd. qe na furnizon Qeverine me karburant pa para! Nuk eshte faji i gishtit qe shkon tek veshi kur i krruhet ktij te fundit. Don't ëorry, be happy! Nga A.CAKO.

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.06 / 12:24**

Prof Ylli akoma jam i shokuar e i tronditur nga maskarada pabesia intriga qe ju pergatiten dua te takoj me respekt dr E DAN!

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.05 / 23:37**

Mos u merzisni dite me te bukura do te vijne.Me respekt Endri.Vlore

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.10 / 12:00**

Fizikisht larg, por me mendje dhe shpirt tek ju ne cdo moment, cdo sinjal pozitiv i juaji pritet me padurim nga ne. Te perqafojme te gjithë Silva.

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.07 / 19:48**

Ty nuk te kane bere asgje cfare kane bere ja kane bere vetes dhe te jesh ai qe ke qene me perpara dhe mos e caj koken nga keta debila e injorante.Naten

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.06 / 19:59**

Mirmbrema do doja qe ta lexoje sms time jam nje qytetare e thjeshte. Per mua ata njerez qe ta bene kete jan kot u solle si te gjithë burrat per mua normale fare

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.06 / 08:12**

Te luftosh per veten,s'eshte egoizem

**sms / deliver / 3.94E+11 / 2009.03.26 / 08:13**

Gezuar datelindjen! Ne keto dite te veshtira te uroj te vazhdosh perpara me te njejten force dhe vendosmeri qe te karakterizojne. Do jem gjithnje krah teje...

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.07 / 19:26**

Urime per performancen ne emision! E verteta dhe puna e madhe do te dale ne shesh! Cojeni deri ne fund ceshtjen sepse puna juaj dhe shqiptaret nuk e meritojne nje manipulim te tille nga nje medja qartas e kapur! Ju uroj shume fat ne kete sfide! A.Shehaj student ne fakultetin e drejtesise

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.05 / 23:50**

Profesor per cfare te kesh nevojte mua me ke te gatshem.

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.13 / 19:02**

Mbrema njesh te pershendes Bori f.kruje. Nesor do kisha deshire te pinim nje kafe, nqs do ishte mundesia dhe po nuk e pate mundesine nesor. Kur ta kesh mundesine me bej nje sms.. Apo me ke harruar... Nga fansi yt Bori . F.kruje. Ja kalofsh Bukur.... Dhe na fal per shqetesimin. Respekt...

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.08 / 09:41**

Profesor,mos ta ndejeje per plehrat qe sajojne,mbahu se ordineret po te vune poshte te shkelin,mbahu! Nga nje djale student.

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.07 / 11:09**

Z Ylli.Ne kete 7 Mars ju dergoj urimet e mia bashke me 2 djemte e mi .Me respekt Drita B. Berat

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.06 / 12:23**

Mos u merzit se ata qe e kane bere kete pune do ta paguajne me respekt S. Allaraji

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.10 / 11:13**

Duhen kontrolluar femrat per kamerambajtje pa leje. Tani.

**sms / deliver / 4.48E+11 / 2009.03.07 / 19:47**

BRAVO TE QOFTE I DASHUR YLLI !! JAM KRENAR QE KAM NJE MIK SI TY QE EDHE NE KETO POZITA PO BEN REVOLUCION NE MENTALITETIN E MYKUR SHQIPTAR. O MIK, NUK KA DYSHIM QE TI SHUME SHPEJT DO RIKTHEHESH ME DINJITETIN QE PLEHRAT PO MUNDohen TE TA PERDHUNOJNE. DO DESHA SHUME TE ISHA ME AFER TEJE NE KETO MOMENTE TE VESHTIRA. MOS HARRO TI JE BERE TASHME PROFESORI QE PO EDUKON NJE KOMB! GJITHE TE MIRAT. LEANDER.

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.06 / 19:56**

Mirembrema! Mos u terhiqni! Keta maskarenjte e Top Channel e vecanerisht te Fix-it jane nga ata qe kane vendosur edhe gjoba! Shkaterroji ne gjyq! Paci fat!

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.06 / 08:09**

Te ndoqa mbreme te klani, eshte e rendesishme qe opinioni te degjoje edhe versionin tend te fakteve, te uroj qe ta kalosh kete moment. Te fala Adi

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.08 / 21:17**

Pushim sonte?Shyqyr se u rraskapitet.Mbreme ishit fantastik.kur te jepni intervist tjetër,nese keni dëshirë me drg sms.me pelqejne intervistt tuaja.ja kalofshi mire

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.07 / 19:25**

N.q.s mendon se mund te jem i dobishem dhe mund te ndihmoj ne ndonje gje, mos hezito te ma kerkosh. Taqo.

**sms / deliver / 4.92E+12 / 2009.03.06 / 16:26**

I nderuar Prof. Ylli!Shqiperia mbetet vendi i paradokseve dhe eshte tradite e shqiptareve qe te mencurit ti vrase ose me hir ose me pahir. Mos u gjunjezoni para atij llumi, sepse e verteta fiton gjithmone. Me respekt Manjola A.-E. dhe Familja

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.05 / 23:50**

Pango je njeri me bote“ mos u merr me plehrat e topit ata nuk nxoren as te“ dashuren e tanit. Me respekt

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.13 / 12:43**

Sot perurohet rruga e shkodres. Shume urime ishte merita jote. Shume te fala. Na mungon ne zyre. Qetesi e madhe ketu.

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.08 / 09:38**

Ylli kaloje me qetesi kete situatë e mos dil ne TV se duan te te rendojne me teper. Amoralet po te bejne moral ndaj ruaj qetesine. Berti.

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.07 / 11:08**

Z YLLI TE BERA SMS TANI JA COVA Z SALI ME BEJ SMS A E LEXOVE MOS U MERZIT TE FLAS SI VELLA PO I LUTEM ZOTIT TE KTHEHESH PERSERI NE PUNE AI BEN MREKULLI NE LUTJE

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.06 / 12:19**

Pershendetjeluroj te jesh mire dhe te mbahesh i forte.me ka ardhur sinqerisht shume keq per kete poshtersi qe sajuan keta plehra.mbreme u tregove burre dhe vazhdo te jesh i tille deri ne fund.ME RESPEKT

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.05 / 23:36**

Mund te kete gisht naci nga jerma jane bashke me filipin. me respekt shpetimi

**sms / deliver / 38269585044 / 2009.03.10 / 08:56**

KUR TE JESH I MERZITUR DHE JE VETEM ME SHKRUAJ PA PROBLEM  
JE SHUME I MIRE AS MOS E VRA MENDJEN JETA VAZHDON DHE ZOTI  
ESHTE ME NE.UN JAM LARG DHE PA FRIKE E NDROJTJE NGA UN TE  
ADHUROJ PA MASE.

**sms / deliver / 4.92E+11 / 2009.03.06 / 19:50**

Pasha besen burr mos ta nin maje koken nalt

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.06 / 07:44**

Pershendetje!Si jeni?Na erdhi me te vertete sh keq per cka ju ndodhi  
sinqerisht.Ju perqafojme miqesisht ANI&ANA

**sms / deliver / 15149616596 / 2009.03.25 / 21:40**

Gezuar Ditelindjen! Edhe 100! Te uroj nje jete te mbushur me sfida,  
fitore, moskokecarje, shendet, hare dhe miq... Te fala, Misheli

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.08 / 21:10**

Zot! Pango Jam nje qytetar nga Patosi Te uroj shendet dhe behu I forte  
Urime ngazemra

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.07 / 19:25**

Ju pershendes per nismen tuaj dhe ju lutem ta vazhdoni betejen deri  
ne fund ndaj ketij truku te paskrupullt e diabolik.

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.06 / 16:20**

Yllo...ajo,ata qe e kishin derguar,dhe ata qe perplasin duart,jane plehra  
te kategorise se fundit.Me shpirt -Duhej tjua kiske kthyer te ....M. Xhuli.  
Ciao

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.05 / 23:49**

E vleresojme shume guximin qe tregove sot pas asaj tronditje qe  
kaluam te gjithë.Jemi te sigurt qe ti do ta vendosesh ne vend emrin  
tend. Behu i forte jemi te gjithë me ty.FLORI.

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.13 / 11:53**

Profesor c'kemi?Jam me nje grup te madh shoqerie dhe te gjithë te  
pershendesin,dhe te kane shume xhan.DESANTILA

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.08 / 09:22**

Z. Ylli! Anila duhet te mbyllte dekolten e saj se eshte gazetare dhe  
kerkon moral me gjinje perjashta

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.07 / 10:56**

Z.Pango persh. Jam Iliri komshiu dhe shok i Mlshes ajo qe te  
ndodhi ty mund ti ndodh cdo mashkulli mos e caj koken te gjithë e  
kuptojne qe eshte puc Behu i forte Mos harro vlerat e tua

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.06 / 11:35**

Z. Pango me gjestet e tu qe publikoi media mos kujto se na ke  
cnderuar por vetem na ke dhene nderim dhe ta dine te gjithë qe ti

mbetesh nje nder liderat e pd. Une jam f. hajdini nga tropoja. Mbetsh me shendet o lider se populli i thjesht si un akoma te don.

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.05 / 23:36**

Profesor nese dun me t'zhyt, terhiqi t'gjith me vete! Jam me Redin, Arianin & sigurisht Paridin.

**sms / deliver / 38269585044 / 2009.03.10 / 08:46**

PROFESOR UROJ TE JENI MIR DHE TE KESH LUMTURINE E KREJT BOTES.JE SHUM I MREKULLUESHEM ME PELQEN SI NJERI JASHTE MASE.DO DESHIROJA ME GJITHE SHPIRT TE TE NJIHJA NGA AFER.

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.07 / 19:38**

Mirembrema Profesor!Ju mbeshtes plotesisht.Jemi te gjithe me ju.Me respekt D.Lundra

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.06 / 07:35**

Miremengjes dhe ju uroj te keni nje dite sa me te kendshme. Ju uroj te dilni triumfator perballe mafies se Tanit dhe mbi te gjitha; perballe histerise se turmes,beteje te cilen Krishti e humbi. Gjithe te mirat ! L. D,Sarande

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.08 / 20:59**

Te uroj shendet dhe mos u merzit Mbahu burra sic je me erdhi shume keq per kete qe te bene po mbahu i forte

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.07 / 19:25**

Je ashtu si e ke emrin,mos u neshstro e mos u dorzo se je vertet nje njeri me moral. A.Goci

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.06 / 16:19**

Te degjova. Me vjen shume keq per situaten dhe uroj t'ja dalesh. Agron

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.05 / 23:47**

Mos e ler te beje gjykatesin.

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.12 / 17:22**

Mirmrama Z Pango,une qe po te shkruaj kete sms jam nje qytetare e thjeshte.Mua me ka ardhur shume keq per kete pabesi Ka njerez te thjeshte qe jane me ty.Me respek Zj Alba

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.08 / 08:00**

Miremengjes Z. Pango, Emri im eshte Fiorentina L. Ju njoh vetem nga televizioni. Si njeri jam ndjere keq qe ndaj njeriut Ylli Pango ushtrohet kaq shume dhune psikologjike. Une uroj qe Ju te gjeni force brenda vetes tuaj per te mos u dorezuar, per te fituar mbi ata, qe me nje urrejtje biblike jane versulur ndaj nje njeriu te vetem. Ju duhet te kuptoni se te gjithe keta, jane te pakenaqr nga jeta, te dhunuar. Ne dhunen ndaj jush keta viktima jane shnderruar

ne xhelate. Une jam e bindur se kur gjerat te kthjellohen, Ju do ti shtoni vlera njerezore personalitetit tuaj akademik e politik, te pakontestueshem. Ju uroj gjithë te mirat.

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.06 / 11:26**

Z.Pango,niveli dhe figura juaj akademike s'mund te perdhosen nga provokimet e emisioneve pa moral.Kurajo.

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.09 / 22:52**

Profesor, ne kete histori ka shume mekatore, por ju nuk jeni nder ta. Eshte e frikshme, jetojme ende ne komunizem e gjyqi popullor gjen vend edhe ne Klan. Ervin N., gazetar.

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.07 / 19:35**

Urime edhe tani je shume i pergatitur dhe qendro vetvetja mos te mposhtin keta horra se ta kane bere me qellim.

**sms / deliver / 3.07E+11 / 2009.03.06 / 19:47**

motrat ku i kane kta kelyshat e m.,po njeriu nuk esht pederast mor ti haje mortja keta deshtaket.Z-Pango,po pse sja ...asaj kurves?Me fal per gjuhen..qendro i forte dhe kurajo.respektet e mia,nga nje emigrant i thjeshte.gjith te mirat dhe shendet.

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.06 / 07:13**

Mirmengjes jemi djemt e Dhiogjenit na vjen shume keq per gjithcka ndodhi.TI KE QENE DHE MBETESH I NDERUAR kete e tregove edhe dje.Ke mbeshtetjen tone.

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.25 / 19:01**

Profesor uroj qe te jeni gjithmone mire!Mos na harro!Te fala nga Shkodra.

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.08 / 20:43**

Pershendetje!Me falni per shqetesimin,por e di si ndiheni,pasi kemi nje dhimbje te perafert. Une jam nje vajze qe para disa vitesh hodha ne gjyq 3 gazeta per shpifje,dhe Fiksi megjithese i beri filmimet e fshehta dhe me dha te drejte,nuk e pa te arsyeshme t'i jepte se s'isha njeri aq publik sipas tyre.Shkurt,nuk i marrin parasysh ndjenjat e njerezve,por i japin publikut ate qe duan vete,duke shkaterruar jete njerezish e duke perfituar nga dhimbja e te tjereve. Sot jam vete gazetare dhe kam botuar 2 libra qe nga koha e asaj historie,(se njeriu mund dhe duhet t'ia dale mbane)por me besoni,smundem te harroj tronditjen dhe pasojat qe me la ai kurth qe me ngriten...Jua tregoj keto ,pasi edhe pse keni humbur shume gjera ne kete periudhe,ia kurseni stresin vetes ,se nuk do t'ju kuptojne edhe pse perpiqeni t'i sqaroni.Mgjs eshte e veshtire,uroj qe te kaloni kete problem.ARIOLA K./Dures



**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.07 / 19:25**

JO TE GJITH I BESOJN TOPIT TI JE ME I MIRI

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.05 / 23:47**

JAM I SIGURT QE Z, PANGO QE NJOH UNE NUK ESHTË AI QE PERFLITËT, SEPSE UNE SI KOREOGRAF NUK KAM KOSTATUAR AS DYSHIMIN ME TE VOGEL, 1-KUR TE GJITHE DYERT ME JANE MBYLLUR Z,PANGO ME HAPI KETE DERE, EDHE PSE MUNDESITE ISHIN TE PAKTA PER TE BERE PROVA NE TARACEN E MINISTRINE E KULTURES PER 25 A 30 VAJZA TOP MODELE, 2- DHE KY ZOTERI SME KA SHFAQUR KURRE INTERESA TE KESAJ NATYRE KUNDREJT KETYRE VAJZAVE, 3-PERKUNDRAZI KY ZOTERI ME KA NDIHMUAR MBI DHJETRA TAKIME QE KAM PASUR

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.12 / 16:25**

Pershendetje.Desha te thoja qe te mos e demoralizosh veten per ate qe ndodhi sepse ti nuk je rasti i pare.Sa per kritikate e hedhura ndaj teje ne forme ofeze mos i merr realisht te verteta pasi ata persona nuk jane shenjtoje.Te gjithë gabojm,nuk jemi perfektë ne cdo aspekt.Ia kalofsh mire.Olgena.

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.08 / 07:58**

ylli.Familjarisht te uroj force per te perballuar kete ushtri qelbesirash.- ..,mbreme u prezantove mire,pershendetje,b. b myftari

**sms / deliver / 33616785292 / 2009.03.07 / 10:30**

Mirdita Ylli. Si dukesh? Mos e caj koken nga puritanizmi i ketyre moralizatoreve zagare dhe pa karakter. Ty nuk te arrijne as tek kyçi e gjithë kjo hordhi hienash. Nepermjet kesaj forme monstruoze duan te sabotojne vepren tende dhe te Berishes. TCH e Edvin-Hoxhes e kompani duhet zhduk. I takon Berishes qe ta ktheje nderin ty me kurajo. Te perqafoj dhe mendoj per ty. Kisha deshire te shkruaja dicka ne pergjigje te korit te hienave me ndonje gazete shqiptare. Nuk e di si mendon ti...

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.06 / 11:18**

Te pershendes dhe uroj te jesh me i qete. Nuk kam ardhë te takoj se me duket sikur te bezdis. Te fala dhe nga te gjithë te shtepise. Nardi

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.05 / 23:36**

Bravo, dhe mos i ul krahet...! Kjo eshte kurajo...!

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.09 / 22:29**

Z BLENDI KY QE KURTH NUK DO FILOZOFI PO AMERIKA KA LIGJ QE DENON RRJETIN QE BERE KURTHIN JO VIKTIMEN "PO NA SHOKONI MBARE POPULLIN NUK KA LIGJ NE BOTE TE LEJOJE SURVEJIMIN"

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.07 / 19:34**

Yll nuk ka qene e lehte. Un me shum se kushdo tjetër te kuptoj Ke qene shum mire sonde. Me mire do te jete me pas..G.dibra

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.06 / 19:46**

Jam nga vlora.M vjen shum keq per kurthin qe te ngriten te degjeneruarit e fiksit.Mos e çaj koken se ka shume veta që të mbeshtesin Pershendetje nga vlora.

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.06 / 01:06**

Mirmbrema.Jam nje student.Ndoqa me vemendje sqarimin tuaj ne emisionin opinjon.Me preken dy momente njeri kur i thate monikes: edhe ti po ma thua kete. Dhe e dyta kur thate qe kjo video ose ky montazh na ka shkaterruar si familje. Shoqeria e soteme kur te sheh qe te rreshket kemba e rrezohesh nuk te jep doren por te shkel mbi trup deri sa te te marre frymen! Singqerisht ju them qe provokimi nga femrat eshte me i parezistueshmi ku njeriu e humbet kontrollin,ajo mund ti ndodhe gjithkujt,sic that dhe ju mos ta befte zoti kismet. Shpresoj me gjith zemer qe ne radhe te pare te afermit tuaj dhe me pas shoqeria te te kuptojne drejt. Do te deshiroja qe te takoja e te komunikoj disa gjera me ju. Nese e mer kete sms me dergo nje ok.me fal per shqetesimin por vura veten ne vendin tuaj dhe u deshperova shume.gjith te mirat

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.24 / 19:58**

Te prift e Mira . ZOTI te Bekofte , te Uroje me gjith Zemer ...Lale .

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.06 / 15:46**

Kjo eshte me e pakta,qe mund dhe duhet te beje per ju,cdo qytetar. Une jam gazetar ne nje media kombetare,jo TCH,natyrisht dhe i njoh mire palacot qe punojne ne Korce per Fiksin,te cilet investigojne duke vene gjoba. Ju pershendes! Daniela.

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.05 / 23:46**

Bere shume mire qe dhe versionin tend, kjo sqaroi shume pikpyetje per opinionin publik, mbro veten percka s'eshte e vertete ne kete histori,dhe denonco me kurajo autoret e ketij skenari te ndyre, musaj

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.12 / 15:04**

Vlerat e tua nuk mund ti shuajne me nje episod te kote.Per mua ka qene,e eshte nder te te kem mik.Te pershendes edhe une nga zemra.adidule

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.06 / 11:18**

Profesor, mos e vrit shume mendjen dhe mos u merzit. Per ne qe te njohim prej vitesh ngelesh njish. Eptan L.

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.09 / 22:13**

PROFESOR PO JUA MER HAKEN ED PALOKA TE KLANI.DOJA TJU THOJA QE JAM KRENARE QE KAM PASUR NDERIN TE JEM NJE

NGA NJERZIT QE KA PUNUAR PER JU DHE ME JU.ASHTU SI DHAME SHPIRTIN PER TE MARRE ZONEN 38 ASHTU DO TA JAPIM PER TI TREGUAR KUJTDO SE KUSH JENI:NJE NJERI ME VLERA TE MEDHA ME RESPEKT B.KOCALI

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.06 / 00:54**

I dashur Prof. PANGO..Te shpreh respektin dhe mirenjohjen time,per dinjitetin dhe personalitetin me vlere qe ke i dashur..Bere gjene me te cmuar , qe argumenteve sakte,me sinqeritet, me edukatë, maskaradat dhe prapaskenat për të të hequr qafe..Keto skenare prostitucioni, qe do ti imoralizoj figurat, i bejne vetem te dy cobejte e pa skrupullt edra,e filiprat....Mos i fal..Femrat e blera i perdorin e i fusin per te Rrembyer thelat e majme..Shtypua koken qenve..Kapedan,mos ja ki friken askujt..Te respektoj shume..Te fala LULIT me dashuri familjare. Andon K. (N.)...Me besim,e mirsjellje,goditi qelbesirat pa atdhe.

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.24 / 19:52**

Mbr ylli , te kame shqetesuar , kto kohe por ma bo hallall. Por e kisha fiksim qe te pinim nje kafe , jo per naj gjo vec per Burrnin qe ke Bo. Ty me Nere M.... Ta hengren ato K.... Shpresoje se po me kupton, dhe shpresoje qe nje dit te njihemi. Jo se te intereson por une kame kenaqesin te pi nje kafe me ty . Te pershendes.

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.08 / 20:30**

PER MUA PERSONALISHT JE POLITIKANI ME I NDERUAR.MALLKUAR QOFSHIN ATA QE TE NGRITEN KURTHIN.ME RESPEKT BEKI.JAM VAJZE SE DUKET SI EMER DJALI..

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.07 / 19:24**

KE TE DREJTE ZOTI PANGO BRAVO TE LUMTE.

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.06 / 15:42**

Ylli jam prane teje. Te fala. Nonda v.

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.05 / 23:46**

Bravo bone shume mire qe u cfaqe

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.12 / 14:50**

Po ben nje lufte te admirueshme,e mundohem cdo dite te mbeshtes sa mundem se bashku me rrethin tim.Adrian D.

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.07 / 10:09**

Profesor kam respekt qendro ifort top channel nuk ka ndryshim mga sigurimi i shtetit te monizmit te fala kujtimi nga vlora. Vlora eshte me .P.D.Jo me barbonet e .P.S

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.06 / 11:16**

Mirdita profesor.kam ndjekur te tere historin.e dua tju them qe eshte nje shpifje e neveritshme.ju mbeshtesim. shpresoj qe ata njerez te felliqur te marrin ate cka meritojm.suksese alk sh., julian l., jozel h.

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.05 / 18:54**

Te" ndoqa ne emision dergova dhe sms bravo te lumte".je me" i miri nder te gjithë ata plehurat qe mendojne se jane dikush dhe qe mundohen te te" injorojne. Per mua je njeri me vlera.

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.09 / 21:30**

Mirnbr. Prof. Ylli (n.q.s jeni ju) Me lejoni t'ju them se jeni me te vertet njeri i perkryer pavarsisht nga pallavrart qe u folen lart e posht per ju,por mos e vrisni mendjen sepse ju kane thjesht zili. Per mua mua ju jeni nje politikan dhe nje psikolog inteligjent! Te fala me respekt! Fatjoni nga FR.

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.07 / 19:34**

Profesor vazhdo te qendrosh i paepur e stoik. Moralitet tend kapacitetit tend akademik e intelektual,kontributit tend te pamate ,fuqis tende te perballjes as nuk u afrohen te gishti i vogel i kembes tende pseudomoralistet e inspiruar nga instrumenti politiko-mediatik tch i cili vertetoi ,me metodat e vjetra te sigurimit,perkatesine e vet komuniste. NJE ADMIRUES I BOTIMEVE TE TUA. A MANO

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.06 / 19:12**

Prof. cfare sna vret na ben me forte, ju na i keni mesuar ne .te uroj gjithë te mirat redona d.

**sms / deliver / 38649296294 / 2009.03.06 / 00:33**

Hic mos caj koken.Me sa me shume takt e gjakftohtesi.Me respekt. Eugerta Gj.

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.24 / 16:20**

Isha ne MTKRS sot per here te pare dhe ta ndjeva shume mungesen. Kujdesu per veten. Ata te mite s'jane ketej se mami eshte pa qejf e mund te beje nje nderhyrje prape. Shume te fala mamase.

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.08 20:23**

Faleminderit juve.dhe te jeni i sigurt se cdo gje do t'ju shkoje mbare e mire..

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.07 / 19:24**

SHTYPI ME KEMBE MONTUESIT,GENTI JAM

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.06 / 15:26**

Pershendetje Z. Pango. Me vjen sinqerisht shume keq per gjithë qe ju ndodhi. Asnje pisllek" nuk mund t'a njollosh emrin tuaj. Me respekt Anisa"

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.12 / 13:34**

Te kane bere si armiku popullit i uruar. Si nuk kane turp qe dalin flasin per moral palacot si rama, gjinushi, etj. Le pastaj m.. qe... Eshte koha

kur putanat hiqen si puritane dhe kodoshet e martuar si parimore. Pune palacosh. Merre me qetesi dhe qesendi. Te fala, abi

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.07 / 23:44**

Z PANGO,MIRMROMA E TE PERSH. JOM NJI DASHAMIRES I JUAJI NGA SHIJAKU.NUK HABITEM NGA FARA E KUQE ,QE I SHEF BURRAT PER CESHTJE NDERI.ATO NA SHOFIN NE DHE NUK SHOFIN KURVLLIKUN QE E KANE MRENA OBORRIT TE VET.DEGJENERIMIN MORAL QE KANE VETE KOMUNISTET,DUAN TE NA FATUROJNE NE.JEMI MOSHATARE,KJO QE NDODHI ME TY SOT,MUA MA ORGANIZUAN NE VITIN 84.MOS U MERZIT,TE UROJ NJI NOTE TE QETE.PLAZH,ISUF A.

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.07 / 09:39**

Z. PANGO! GEZUAR 7 MARSIN! MBETENI NJE NGA PEDAGOGET ME ME EMER. ME RESPEKT ANITA

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.06 / 11:10**

Pershendetje ylli. Jam mira sh. nga panorama. Me vjen keq qe u bere viktime e kafshes cakuli. Nese do, ma jep mua emrin e vajzes dhe e publikoj neses ne gazete. Uroj qe te behesh i forte e ti shkosh deri ne fund.

**sms / deliver / 33616785292 / 2009.03.05 / 14:01**

I dashur Ylli. Mora vesh ngjarjen dhe me vjen shume keq per ty. Kjo forme dhune e jetes private, nga me te ultat qe mund te ekzistojne, tregon qe shqypnia eshte akoma mesjete ne shume aspekte. Shpresoj qe ti kalosh keto momente te veshtira me sa me pak pasoja per ty e rrethin tend. Personalisht jam me ty deri ne fund mon cher ami. Jam i sigurt qe do ta kalosh kete prove te veshtire dhe do dalesh me i fort. Te perqafoj, Xhili

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.09 / 21:19**

Profesor PANGO mbahu fort e mos u tut. Ne emisionin Neës 24 dolet Ju i fituar. Ju sugjeroj te keshilloheni me avokat te huaj. Nga nje Jurist.

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.07 / 19:34**

Pergezime per intervisten!Cmojme inteligjencen dhe forcen tuaj te karakterit.

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.06 / 18:51**

Profesor me vjen keq per trillimet dhe ekzagjerimet qe jane bere nga ca alabake dhe prostituta(dhe nga nje media prostitute). kundrejt personit tuaj. Pavaresisht se ju nuk na njihni ne te shprehim mbeshtetjen tone.Me respekt NAPOLEON K.

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.06 / 00:31**

Mos u tut prej deshperimit ndonse lodhja te mundon,thuaj po atij trimit,Qeveria te shiqon.

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.08 / 19:53**

Z. Pango jam BRUNA shoqja e PAQIT, jemi takuar bashke shume vite para ne nje tavoline. Doja te te pershendetja, dhe te thoja, qe te gjithë kete ngjarje besoj qe mbas disa kohesh kam besim qe do te dish ta kthesh komplet ne favorin tend dhe do te dalesh edhe me mire se ke qene. Ke njohuri, bagazh, kulture. Mire eshte ta hedhesh ne gjygj fiksion se e fiton

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.07 / 17:55**

Kam qene jashte shteti dhe sot jam kthyer, mos e vrit mendjen.. Burrat kur ndodhen para te papriturave njihen per kurajon, ty nuk te mungon. Sulmeve, jo me sulm, por me diplomaci e injorim. Cudia me e madhe tre dite zgjat, futi nje jave pushim jashte. Te pershendes

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.06 / 15:22**

Pershendetje nga Korca,profesor! Zoti ju dhente force dhe durim per te perballuar,ata qe hiqen si te ndershem. Kete rradhe fituan horrat,por nuk mund te jete keshtu pergjithmone. Luftoni,se nuk jeni vetem.

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.05 / 23:46**

E vetmja gje qe do t'ju ndihmoje eshte sinqeriteti juaj qe ka nisur tashme por me kujdesin se mos e keqtrajtojne ujqerit. Respekt nga une arkitekti nga delvina.

**sms / deliver / 3.60E+11 / 2009.03.12 / 11:37**

Zoti Pango, uroj te kesh energji fizike dhe mendore per te qendruar fort. Sulmi kunder teje, ishte ne te vertete sulm kunder PD. Rama e ka fituar tashme nje deputet ne Tirane me eliminimin tend. Per moralin mos e vri mendjen se ai nuk ekziston per ata. Eshte thjesht maske... Pershendetje NGA SOFJA, MIKU I RISTOS

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.07 / 22:23**

Profesor Ylli gezuar 7 marsin.Per mua do jeni gjithmone nje profesor me dinjitet dhe qe e respektoj shume.Kjo pershendetje ju vjen dhe nga familja ime.ERA SH.

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.07 / 08:54**

O bobe jam 1 simpatizanti juaj nga Vlora,mos e vri mendjen fare,po erdhe ketej me merr te hame ndonje dreke.kurajo bobe kurajo,t jesh mire.

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.06 / 11:06**

Me vjen keq per cfar ka ngja. Te falenderoj per bashkpunimin dhe korrektesine ne maredheniet e perbashketa.

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.09 / 21:17**

Z.PANGO I LUMTE FRANGAJT.MOS U LIGSHTO SE PO GEZON HASMIN QE TE DON TE VDEKUR. RESPEKTE. DESTAN S. KUKES.

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.06 / 18:48**

Mirmbema , te dhente zoti forca per te perballuar tragjedite qe te krijojne njerezit e ligj ne shpirt, pa familje. te mbuluar me lek pa djerse , dhe pa fe ,Dod I.

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.06 / 00:08**

Meso dhe te tjeret ne rrojme per shkak te kuriozitetit dhe jo impotences.ndaj stop autodhunes.

**sms / deliver / 3.93E+11 / 2009.03.22 / 21:22**

YLLI HALLALL TA BAFT ZOTI JE 1-sh. JAM PREJ MILOTI E TE PERKRAH DERI NE FUND TE RUJT ZOTI.

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.08 / 18:57**

Mirmbrema z.Ylli.Me lejoni t'ju shpreh mbeshtetjen time ndaj jush. Une jam nje poete,ne lidhjen e shkrimtareve,PEGASI,Gjirokaster. dhe kete ngjarje e quaj,nje padrejtesi ndaj jush.Ju jeni nje njeri me vlera te medha dhe kjo gje i ndodh dikujt qe duan t'i ulen vlerat. Qendroni i pamposhtur!.Me respekt Alketa P.

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.07 / 17:49**

Gezuar festen Profesor, (je me i mire se shume prof , ministra apo deputete qe nuk kane dal te fiksi). Nje ish-student yti nga shkodra, Leonard H.]

**sms / deliver / 37744484850 / 2009.03.06 / 15:07**

Ju lutem shume, nese vjen ne kosove, dua te te takoj ashti dëshirë e madhe e imja, dot'bahem mikesh shum e mir e juaja, te lutem mos u dorzo, ju dua shum.

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.05 23:46**

Kerkojne te perbaltin figuren tende.Uroj ta fitosh kete beteje ndaj krimineleve te ish regjimit famekeq.

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.12 / 10:32**

Go on :)

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.07 / 22:06**

Ylli.Te urojte ruash qetesine dhe te mireadministrash situateten,pasi tani po kalon ne anen tende!Kujdes me daljet dhe provokimet ne TV! Te uroj fat!

**sms / deliver / 4.37E+11 / 2009.03.06 / 11:03**

Prsh nga Eëna Je tregu i madh dhe si Burrat mbreme ne Opinion. Trim . Respekte se si thonë cifutet ka 2 lloj pemesh nje me kokrra dhe tjetra pa.Po asaj me Kokrra i qellojn te gjithë ....tani i njej shoket e vertete

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.09 / 21:16**

Me fal dhe nje herë per shqetesimin.Nuk e kuptoj cfare kerkojn keta njerez nga ty?Po shoh opinionin tek klani dhe nuk me vjen mire qe te gjykojne,duan me te nxjerre moedomos me faj.Te lutem zoti Pango coje deri ne gjyq keta njerez dhe ate qe ka dasht me te fut ne gracke.Me vjen keq qe te gjykojne keshtu.

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.07 / 19:33**

Miku im, Te pershendes nga zemra, behu i forte! Xhelal T.

**sms / deliver / placeboeff / 2009.03.06 / 18:48**

S'do benit keq t'i bini Fiksit me gjobat qe vendosin...S'jeni i pari... Kane pika te dohta

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.06 / 00:08**

Profesor Ylli!RESPEKT DHE KONSIDERATE PER JU!PER VLERAT E LARTA TE INTELEKTIT DHE QYTETARISE QE KENI TREGUAR DHE TREGONI VAZHDIMISHT.TELEFONUESJA NGA SHKODRA.

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.08 / 18:55**

Z. Pango. Bej kurajo. Ajo qe ndodhi esht dicka e parendesishme. Ju qendroni shume me lart nga keta derra prandaj mos e ca koken fare. Bile urime per formen sportive. Uroj te jeni mire dhe mos te ndikoheni nga mendime turmash uleritese. Une jam nje njeri ashtu si mijra te tjere qe ju mbeshtesin. Qofsh mire.

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.07 / 17:33**

Mirembrema Profesor, megjithese njifemi shume pak e ndjej si detyrim moral t'Ju shpreh keqardhjen time per cfar ju ka ndodhur. Une jam nga Vlora dhe duke ju kerkuar ndjese per shprehjen time te ashper,Ju them, MOS E CAJ FARE! Me respekt Roland P.

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.06 / 15:03**

Pershendetje profesor do te mbetesh i vetmi per gjithshka qe i ke dhene ketij kombi e njohe me boten ne fushen e turizmit te artit e sportit. Profesor mos u shqeteseso per momentin. E di per nje kohe shume te shkurter me vlerat qe keni do te jeni e njejta figure kombi Ky vend ka nevojë per persona si ti.Intelektual dhe i guximshem. Mbetesh mik



**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.05 / 23:46**

Zoti Pango eshte nje kurth por mos u dorezoni Blendi Fevziu sillet si gjykates dhe jo si gazetar me respekt Drita B. intelektuale Berat

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.12 / 10:29**

Pershendetje dhe uroj te jeni mire dhe akoma me i forte nga sfidat qe u desh te perballni! Por, hijenat makiavele qe kane dale pas ikjes tuaj, nuk kane limit ne intrigat qe thurrin cdo dite. Me vjen keq per zgjedhjen e atyre njerezve qe duan vetem te te groposin. Me respekt Albana P.

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.07 21:20**

Mirmbrema.nuk duhet te lejosh kurre qe Gjinushi qe u akuzua hapur ne parlament ne '98 nga azem hajdari apo m.kryemadhi,apo blendi kloshi qe deshi te dhunonte studenten ne ambasaden shqiptare ne poloni.ti e din sh.mire se fatkeqsisht ne(shqiptaret,jo te gjithë)kemi supertalent per te persekutuar.Kujto c'kemi bere me kleriket ne '67. Zoti te ndihmoftë.Xhovani L.

**sms / deliver / 3.56E+11 / 2009.03.07 / 08:38**

MIREMENGJES Z PANGO. BEHUNI I FORTE DHE MOS U DOREZONI.

**sms / deliver / 0672012862 / 2009.04.20 / 15:07**

Te respektoj dhe te nderoj me shume. Me respekt M.Laze

**PS: sms-të janë shumë më tepër**

Autori i disponon sms-të me indikacionet e tyre e plota të dërguesve por, meqë ky libër bën fjalë për moralin dhe respektimin e privacisë, kur ajo dhunohet, në emër të respektimit të këtyre vlerave, po i paraqes këto sms vetëm me indikacione dhe duke i konsideruar private ato.

## Letër e hapur për Ylli Pango

Është hera e parë që shkruaj për një gazetë dhe ndoshta e fundit. Po shkruaj edhe unë për ty, Ylli Pango, miku im, unë që jam larg në këto momente të vështira. Po shkruaj pa pasur friken e “konfliktit të interesit”, sepse nuk më lidh asnjë lloj interesi, përveç atij të shprehjes së mendimit të lirë.

- Ke interes afektiv, - do të thotë dikush... Ashtu qoftë! Por, eksperiencia gati 19 vjeçare në Francë mendoj që më ka krijuar distancën e duhur për të pasur një sy kritik edhe ndaj miqve.

Për rastin *Pango Gate*, që unë dhe të gjithë miqtë e quajmë TCH Gate, nuk mund të rri pa shprehur mendimin tim në lidhje me kryqëzimin politiko-mediatik që po i behet Ylli Pangos.

Mollahët dhe moralizatorët filluan linçimin publik direkt pas transmetimit të imazheve. Media, Parlament-Kuvendi, e gjithë shoqëria.

Ne vend të akuzimit kundër TCH për dhunim flagrant të jetës private, dhunim ky i papare në një vend demokratik nga një media e ashtuquajtur demokratike, ndodhi e kundërta. Një nga artikujt më të pisët, të botuar kishte titullin “**Pango-Fornication**”. (P.Xhufi)

Pas leximit u fyeva personalisht, pasi në një nga frazat të cilën do ta shpjegoj më poshtë, autori me prekte indirekt edhe mua.

Mendova që duhet të jetë ndonjë qytetar i thjeshtë, por kur i lexova CV u surprizova që autori kishte mbaruar studimet në “La Sapienza”, në Romë, kish punuar ne RTSH, në ministri të jashtme, etj. E rilexova artikullin dhe CV dhe mendova: ky qe paska mbaruar studimet në Romë, vitet '72-'77, në një nga periudhat më të errëta të diktaturës në Shqipëri, ose duhet të ishte një gjeni ose një spiun e pjellë spiuni.

Për nga niveli ekstremist i ulët intelektual, i bie që të jete kjo e dyta.

Niveli ishte aq i ulet e poshtërues, ardhur nga një eminencë e diplomacisë dhe politikës shqiptare, pjesë e elitës që në presim të na ndriçojë, sa thashë me vete që Yll Pango duhet t'i ketë borxhe të renda këtij Profesor-Doctor- Honoris-Causa!

Po pse ore Profesor-Doktor? Ti qe je aq i kënduar, i diplomuar, i bredhur, goxha burrë i zgjuar, shenjë e të cilave është dhe konvertimi yt perfekt nga diktatura në demokraci pa u lagur fare, pse vjell kaq shumë vrer? Si është e mundur që ti dhe shume si ti e latë arsyen dhe u turret kundër një të pafajshmi (të paktën deri sa drejtësia e këtij vendi të kryejë punën e saj)?

Sinteze e artikullit ku Profesor-Doktor- Ajetollahu bën apologjinë e demokracisë shqiptare duke kryqëzuar simbolin e çdo të keqeje mishëruar nga Ylli Pango:

**“Skandali Pango duhet parë përtej moralit dhe patologjisë së autorit te tij. Te karriera politike e këtij njeriu karakteropat, narcis, arrogant, pa ideale, pa parime, pa parti, pa familje, pa miq e pa shokë fshihet një nga faqet më tragjike të demokracisë se sëmurë**

**shqiptare. E cila, nuk dihet pse, paska nevoje për njerëz të tillë.”**

Ky ishte fundi patetik ku autori gjeti formulën magjike për shërimin e demokracisë shqiptare, doli si shpëtimtar i Tempullit të Moralit. Megjithatë, ka një problem “të vockël”. Në enumeracionin e gjatë të “PA-ve”, i nderuar Professor-Doktor, ka nja-dy syresh që unë t’i kthej në “ME” absolute!

ME FAMILJE. Pavarësisht divorcit, Ylli i shërben me përkushtim nënë dhe djalit që ka edukatë të shkëlqyer. ME SHOKË. Unë dhe shume të tjerë bëjmë pjesë tek shokët dhe jemi krenarë...

Këto janë ato dy ME-të që ti nuk ke pushtet DIVIN për t’ia transformuar në PA!

Për ato PA-të e tjera, debati është i gjerë dhe nuk i intereson thelbit të temës.

Ti, si Profesor-Doktor, sigurisht më mund me argumente mua që kam mbaruar vetëm të mesmen natën. Pra, dueli është jo i barabartë, David kundër Goliatit.

Megjithatë po t’i them dy fjalë, sepse profesor Turdiu i nderuar që më jepte matematikë në tetëvjeçare, më mësoi në radhë të parë arsyetimin e zhveshur nga apriori e pasionet.

PA PARTI, thua ti për Ylli Pangon. Deri sa të vërtetohet e kundërta ai është pjesëtar i Partisë Demokratike, apo jo? Dhe në të kundërt, përse demokracisë i duhen absolutisht vetëm njerëz me parti? Partia, o Profesor-Doktor i Antishkencave, është një koncept relativisht i ri (shek.19) në sensin për te cilin ti bën fjalë. Dhe demokracia ka ekzistuar që në kohë të Platonit në

Athinë apo jo? PA IDEALE, PA PARIME, thua t'i për Ylli Pangon.

Po ku e di ti, o Profesor –Doktor? Ti ke lëvruar dhe filozofinë? A nuk është pak turp për ty që përfaqëson shqiptarët në shumë gjëra (funksionar i lartë në kohë të diktaturës, lider aktual i një partie politike, bashkautor i Historisë së Shqipërisë) të shkruash kështu? Ti duhet ta dish më mirë se kushdo që idealet dhe parimet janë koncepte komplekse dhe nuk mund të thuash me gjakftohtësi për një njeri, cilido qoftë ai, PA IDEALE, PA PARIME? Ti thoshe, në gjaknxehtësi të falej, se bën pjesë tek natyra e njeriut të shkretë, por ti shkruan me qëllim, ti shkruan për të kryqëzuar një të PAFAJSHEM! Turp, Profesor-Doktor!

Ty të mungon ndershmëria intelektuale. Ti abuzon me lexuesit e thjeshtë e të ndershëm ose me auditorët ku ligjëron. Ti manipulon për qëllime diabolike, me fraza të ngarkuara pa sens. Është pikërisht kjo lloj “imposture intelektuale” që përbën rrezik dhe dëmton demokracinë në atdheun tim. Ato që shkruan ti janë shumë më të turpshme se veprimi i Ylli Pangos. Sepse Ylli ishte në intimitet, në shtëpinë e tij dhe iu dhunua gjëja më e shtrenjtë që ekziston për një individ. Ti dhe shumë të tjerë si ty, shkruani publikisht, me gjakftohtësi, me kalkulime për qëllime politike.

Unë kam turp, Profesor-Doktor, që ti të më përfaqësosh mua dhe shqiptarët e tjerë. Sepse ti nuk je një qytetar i thjeshtë. Ti ke përgjegjësi për ato që thua.

Je ti i PA MORALSHËM, jo Ylli PANGO ! Këtë po ta thotë babai i një vajze 10 vjeçare për të cilin edukata dhe morali janë një pjese e sensit te jetës.

Po pse, Profesor-Doktor që njih dhe historinë e popullit shqiptar, nuk përdore atë armën e vyer që ky popull e quan flori, HESHTJEN? Të paktën sa të mbaronte e gjithë historia, te bëheshin hetimet nga organet kompetente dhe drejtësia?

Po tipat si ju fshinë prapanicën me popullin dhe urtësinë e tij. Tipat si ju nuk e p... ligjin dhe organet përkatëse, janë vetë kompetente dhe lehin direkt sa ngrihet perdja e shfaqjes makabre. Është turp për ju që villni vrer kundër Yll Pango, për ju që nuk doni ta kuptoni që nga gjerat më elementare në botën e qytetëruar është ajo që quhet « **la preemption d'innocence** ».

Pikërisht ty, nga pikëpamja deontologjike, nuk të takonte të kërkoje « **Heqjen nga nga puna te këtij horr-profesori** », që Ylli Pango as mësues mos të punoje. Dërgojeni në internim. Mezi ju mban vendi, o hiena. Thinjat, diplomat, zhvillimet nuk ua ndryshojnë natyrën, se natyra e thellë është më e fortë. Ti, o Profesor-Doktor, si intelektual që je, të takonte t'i paraprije klasës politike për të mbrojtur Ylli Pango, jo ta groposje.

Ta mbronit Yllin, se duke mbrojtur atë mbroni demokracinë. Por ju nuk e bëni sepse një pjesë nga ju janë organizatorët dhe orkestruesit e këtij “Big Brother” makabër. Pjesa tjetër janë të liq, mediokër dhe meskinë... Ju e keni kuptuar mbrapsht demokracinë.

Si është e mundur që një shoqëri të prodhojë një inkuizicion të cilin edhe në Kandahar ta kenë zili? Si është e mundur që edhe ata të cilët i lexoja me kënaqësi, humben kthjelltësinë dhe shkruan paçavure të tilla si Topi dhe Gopi?

- E ka Fajin Ylli,- thoni ju. Po ç'faj ka Ylli, O Popull!  
Më thoni! Ka faj se ishte qen i punës ?

Ka faj se copëtohej për të realizuar projektet e këtij vendi të mjerë ?.Ka faj se i hyri me përkushtim politikës dhe i qëndroi besnik Sali Berishes? Ka faj se adhuron atdheun dhe se sfida e tij ishte ta kthente Shqipërinë në qendër turistike? Ka faj se është i pashëm, me kulturë në sensin e gjerë të fjalës dhe xhelozonte mediokrit?

Ka faj se kur i hyra mik për dy ndere dhe nuk m'i realizoi, t'i bashkohem edhe unë korit për ta linçuar ?

Jo, ai nuk ka faj për të gjitha këto. Ai ka faj që EKZISTON! Ju moralizatorë talebanë doni që ai të zhduket. Vazhdoni...

**“Mbledhje nëpër shkolla për të dënuar Pangon”,**  
vijon shtypi i atdheut tim.

**“Skandali seksual i ministrit Ylli Pango ka tronditur thellë çdo qelizë të shoqërisë shqiptare. Skandali ka vënë në lëvizje stafet e disa shkollave në kryeqytet.”**

...Ruajna Natyrë, thoshte Shvejku... Pse jo dhe stafet e mbare Botës? Sepse morali është Universal dhe i takon shoqërisë puritane shqiptare t'u japë leksione te tjerëve.

E njëjta gazetë në artikullin me titull shkruante:  
**“Një ditë pas skandalit me punonjëset e turpëruara të Pangos”. Autorja flet për atmosferën: “Nëpunëseve të MTKRS ju lexohet një ndjenjë turpi në fytyrë. Ato e dinë se tani paragjykohej pse kanë punuar me Pangon”**

O gazetarë e famshme. Ku e ke mbaruar atë shkollë gazetarie vallë? Kush ta dha atë diplomë të shkretë? Turp duhet të të vij ty, se turpëron punën noble të

gazetarit. Ti, që lexuake turpin në fytyrat e njerëzve, duhet të ndërrosh zanat, sepse s'ka gjë më subjektive se sa pasqyrimi i ndjenjave nëpërmjet pamjes. Këtu s'flitet për një kronike "rozë" apo sfilatë mode ku ti mund ti lëshosh fre "lirizmit" tënd. Këtu është fjala për diçka tepër serioze, luhet jeta e një personazhi publik. Të jesh gazetar është komplet në kundërshtim me interpretimin tënd. Edhe unë e di që ABC-ja e gazetarisë që **"çdo gazetar, i denjë për të mbajtur këtë emër, duhet të respektojë objektivitetin, të ketë një distancë të mjaftueshme midis fakteve dhe interpretimit personal të tyre."**

Ti e ke shkelur me te dyja këmbët këtë parim. Turp për ty. Fotografon të rinjtë e Këshillit Studentor Rinor etj, duke manifestuar para MTKRS me parulla "Turp, Turp, Turp!"

Turp të keni ju, o aktorë të kësaj maskarade, të rinj të shitur e të plakur, që s'keni pikë heroizmi në gjestin tuaj. Unë kam mëshirë për ju, përzgjatje gjenetike e pjesës më të keqe dhe obskure të rinisë enveriste. Juve duhet t'ju vijë më turp akoma, se ju mungon "alibia" e kushteve, atmosferës dhe bombardimit ideologjik të asaj kohe.

Me dëshpëron imazhi i vendit tim, opinionistë, deputetë, intelektualë...danc morbid, linçim i mirëfilltë. Simfoni makabre...

"O Perëndi, fali të mjerët se ata as vetë nuk e dinë ç'po bëjnë... !"

Vazhdoni, kryqëzoheni.

Ylli i dashur. Dua të theksoj: tani të kam shok më shumë se kurrë.



Ti nuk je vetëm. Si unë ka plot të tjerë. Në qofte se drejtësia dhe mediet nuk janë në dorën e atyre që varen Havzi Nelën, ti do të fitosh.

Ti je i PAFAJSHËM, i dashur mik.

Xhelal Qello- Paris Mars 2009-04-26

*Ky shkrim ashtu si mjaft të tjerë alternativë, u refuzua të botohej në mediat e lira e të pavarura shqiptare.*

*Autori i tekstit, Xheladin Qello, është shqiptari i parë që hyri në ambasadat perëndimore. Ai u fut në ambasadën franceze në 16 qershor të vitit 1990 duke rrezikuar jetën. Ai sot punon në Paris, në kompaninë Fedex si drejtues menaxher dhe ka shtetësi franceze.*